

Përgatitja dhe botimi i këtij materiali u mundësua nga OSFA – *Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”*, në kuadër të projektit *‘Transparenca- një rrugë drejt besimit të publikut’*, zbatuar nga *“Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim”*, *“Skuadra 2000”* dhe *“Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”*.



Botuar nga: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”  
Kutia Postare 2418, Tiranë  
Tel/Fax: (+355) 4 22 555 14/5  
E-mail: qdi@gadc-al.org  
Web: www.gadc-al.org

Koordinatorë e Projektit: Irena Shtraza

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, Shqipëri, 2008

Shtëpia botuese & shtypshkronja: SHTËPIA BOTUESE  
**mediaprint**  
sh.p.k.

ISBN: 978-99956-18-25-4

Tiranë, 2008

## ■ ■ ■ TABELA E PËRMBAJTJES

### Hyrje

#### ■ ■ ■ **PJESA I:** Analizë e Nivelit të Transparencës së Shoqërisë Civile në Shqipëri

1. Metodologjia	7
2. Përshkrim i përgjithshëm	8
3. Procedurat e Brendshme të Organizatave	13

#### ■ ■ ■ **PJESA E DYTË:** Transparenca e Organizatave Jofitimprurëse

– Një rrugë drejt besimit të publikut...

1. Mirëqeverisja - Parakusht për Shoqëri Civile të Përgjegjshme dhe më Transparente <i>As.Prof.Dr. Mihallaq Qirjo</i>	23
2. Transparenca e OJF-ve Nëpërmjet Krijimit dhe Regjistrimit të tyre sipas Ligjit <i>Av. Vjollca Meçaj</i>	38
3.“Roli i Organizatave për Forcimin e Rendit Kushtetues në Shqipëri, Kushtetuta dhe Organizatat Jofitimprurëse”, <i>Prof. Dr. Aurela Anastasi</i>	54



4 .“Transparenca me Jashtë e OJF-ve dhe Praktika të Mira”,	
<i>Dr. Eglantina Gjermeni, Irena Shtraza, MA</i>	67
Paketa Fiskale dhe OJF-të	88
5. ”Procedurat praktike për të arritur transparencën financiare”,	
<i>Mirela Arqimandriti, MBA</i>	105
<b>■ PJESA E TRETË – ANEKS</b>	
Pyetësor për vlerësimin e nivelit të transparencës	
së Shoqërisë civile	124

## HYRJE

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Transparenca-një rrugë drejt besimit të publikut”, që synon të njohë nivelin e transparencës së Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri dhe të promovojë mekanizmat për rritjen e saj. Ky projekt mbështetet nga OSFA- Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe po zbatohet nga një konsorcium organizatash: “Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim”, “Skuadra 2000” dhe “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”.

Transparenca e organizatave joqeveritare është një kërkesë e domosdoshme e zhvillimit të këtij sektori në Shqipëri. Rritja e transparencës në aktivitetin e organizatave jofitimprurëse përmirëson marrëdhëniet e tyre me shtetin, donatorët, organizatat e tjera, e grupet e interesit dhe përcaktimi i një strategjie të qartë, si dhe vendosja e objektivave në zbatim të kësaj strategjie ndihmon organizatat të bëhen të njohura në publik dhe të rriten besimi në punën e tyre. Ky botim synon të stimulojë përdorimin nga Organizatat Jofitimprurëse të mekanizmave dhe mjeteve të mundshme me qëllim rritjen e nivelit të transparencës, që burojnë nga legjislacioni ekzistues, nga eksperiencat pozitive të Organizatave Jofitimprurëse brenda dhe jashtë vendit si dhe nga kërkesat e donatorëve që mbështesin aktivitetin e tyre.

Autorët që kanë kontribuar në këtë botim, përfaqësojnë fushën akademike shqiptare si dhe shoqërinë civile në Shqipëri, si: *Mihallaq Qirjo, Eglantina Gjermani, Aurela Anastasi, Vjollca Meçaj, Genta Tafa, Alken Myftiu, Aurela Bozo, Mirela Arqimandriti dhe Irena Shtraza*. Botimi “Transparenca-një rrugë drejt besimit të publikut” paraqet një analizë të situatës aktuale të nivelit të transparencës të OJF-ve në Shqipëri, bazuar mbi një anketim disa mujor në kuadër të këtij projekti. Përkrah analizës, do të gjeni një përmbledhje të disa artikujve, që prekin tematikën e Transparencës së OJF-ve, të parë nga këndvështrime të ndryshme.

Duke qenë transparente me publikun, shoqëria civile forcon besimin dhe siguron mbështetjen që i nevojitet për të ecur përpara. Me shpresën që ky udhëzues do t'i shërbejë Organizatave Jofitimprurëse për të arritur një nivel të ri komunikimi me Publikun, ju urojmë lexim të këndshëm.

*“Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim”,*

*“Skuadra 2000”*

*“Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”.*

## PJESA E PARË

# ANALIZË E NIVELIT TË TRANSPARENCËS SË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

*Alken Myftiu*

*Av. Aurela Bozo*

### Metodologjia

Vlerësimi dhe raporti i përgatitur janë produkte në kuadër të një projekti më të madh në lidhje me transparencën e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri, bashkëpunim i tre organizatave: *'Aleanca Gjimore për Zhvillim', 'Qendra për Nisma Ligjore Qytetare', 'Skuadra 2000'*.

Studimi i këtij vlerësimi mund të ketë disa rezultate praktike. Analiza e grafikëve dhe të dhënave nga pyetësi japin mundësi të vlerësohen gjendja aktuale, përpjekjet dhe sfidat e sektorit për të arritur një nivel transparence të kënaqshëm dhe që ndihmon në realizimin e misionit të organizatave në shoqërinë shqiptare. Nga ana tjetër, rezultatet e këtij studimi mund dhe duhet të shfrytëzohen nga strukturat dhe institucionet që mund të mbështesin sektorin e shoqërisë civile për të realizuar misionin e tyre, madje dhe për hartimin e programeve mbështetëse për OJF-të, për t'i përmirësuar dhe për t'i përshtatur më tej ato në përputhje me nevojat e sektorit.

Natyrisht, nuk pretendojmë që përgjigjet e grumbulluara të mbulojnë të gjitha grupet e shoqërisë civile, por sidoqoftë mund të themi se të dhënat e pyetësorëve përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të OJF-ve që janë aktive në vend. Është e pashmangshme që në një ndërmarrje të tillë, në një kohë kaq të shkurtër, mund të ketë gabime në të dhënat e grumbulluara.

Sidoqoftë nuk besojmë që gabime të tilla të mund të kenë ndryshuar panoramën e përgjithshme të sektorit dhe përfundimet e arritura.

Për mbledhjen e të dhënave u përgatit paraprakisht një pyetësor i detajuar, të cilin e gjeni të bashkangjitur në Aneksin e këtij botimi. Ky raport është përgatitur në bazë të pyetësorëve të plotësuar nga përfaqësues të OJF-ve nga i gjithë vendi. Pyetësori i përgatitur është shpërndarë fillimisht në afro 180 adresa elektronike të OJF-ve të ndryshme në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe gjatë aktiviteteve të kryera në kuadër të projektit (kryesisht trajnime). Na duhet të falënderojmë që të gjithë ata aktiviste e aktivistë dhe drejtuese e drejtues të OJF-ve, që, duke vlerësuar këtë ndërmarrje, gjetën kohë për të plotësuar pyetësorin e për të na ofruar informacione të vlefshme, pa të cilat natyrisht kjo punë nuk do të ishte e plotë.

Pyetësori është ndërtuar në dy pjesë:

- *Pjesa A: të dhëna të përgjithshme mbi organizatën*
- *Pjesa B: Procedurat e brendshme të organizatës*

Informacioni i siguruar në pjesën A të pyetësorit jep një panoramë të llojit të organizatave, statusit të tyre ligjor, burimeve financiare dhe llojeve të aktiviteteve që kryejnë ato. Ndërsa në pjesën B, të dhënat na ofrojnë një panoramë e mundësi për të nxjerrë përfundime për nivelin e disa treguesve për transparencën e OJF-ve, mekanizmave që përdorin për ta ushtruar, si dhe forcat që i shtyjnë organizatat për ta kryer këtë proces brenda organizatës, me struktura apo organizime të tjera, me partnerë e me publikun e gjerë.


## PËRSHKRIM I PËRSGJITHSHËM

*Pyetësorë të plotësuar e të grumbulluar: 75*


Po t'i referohemi *Grafikëve 1 dhe 2*, do të vëmë re se, të gjitha OJF-të, përfaqësuesit e të cilave kanë plotësuar pyetësorët, rezultojnë të regjistruara, megjithëse nga koha e tyre e krijimit dhe viti i regjistrimit ka një periudhë kohore në mes. Kjo mund të ketë ardhur edhe si rezultat i kërkesave ligjore në fuqi, në periudha të ndryshme. Nga *Grafiku 1* shihet se ka pasur një numër

të madh Organizatash Jofitimprurëse të krijuara në vitet 1992, 1996, dhe 2001, ndërkohë që regjistrimi i tyre është bërë në periudhën 1996-1997 dhe 2001-2002. Periudha e dytë e regjistrimit të OJF-ve korrespondon me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për OJF-të, që rregullon, mes të tjerash, regjistrimin dhe formën juridike të organizimit të OJF-ve.

■ Grafiku 1



■ Grafiku 2






**TABELA 1**

Lloji i OJF-së sipas formës ligjore

Shoqatë	59%
Qendër	25%
Fondacion	12%

Në *Tabelën 1* paraqiten llojet e OJF-ve sipas përcaktimit të formës së tyre në kuadrin ligjor përkatës. Vihet re se më shumë se gjysma e tyre janë shoqata me anëtarësi, ndërkohë që të paktën 3% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje dhe 1% deklarojnë se kanë një lloj tjetër organizimi, megjithëse nuk e përcaktojnë më tej këtë. Pavarësisht se është një përqindje e vogël, mund të themi se personat që kanë plotësuar pyetësorët nuk kanë pasur informacion mbi llojin e organizatës së tyre, duke vënë në diskutim njohuritë e tyre mbi këtë temë dhe, ndoshta, vetë transparencën e OJF-ve në të cilat janë të angazhuar.

**Grafiku 3**



Në *Grafikun 3* është paraqitur niveli i aktivitetit të OJF-ve. Vërehet se një pjesë e mirë e organizatave pjesëmarrëse në këtë mini-studim, punojnë në të gjitha nivelet brenda vendit, ndërkohë që vetëm një e treta e tyre ushtron aktivitete edhe në nivel ndërkombëtar. Një rezultat i tillë është mëse i

natyrshëm por, siç do ta shohim më poshtë kur flitet për burimet që janë në dispozicion të OJF-ve, vihet re një zhvendosje: ndërkohë që burimet financiare janë kryesisht nga jashtë vendit, puna e OJF-ve orientohet kryesisht në komunitetet vendore e rajonale.

Interesante janë të dhënat që flasin për buxhetin vjetor të organizatave, paraqitur në *Tabelat 2 dhe 3*. Nga pyetësorët e grumbulluar vihet re se pjesa më e madhe e OJF-ve pjesëmarrëse në anketim, kanë buxhet mesatarisht deri në 100.000 EUR. Pothuajse një e pesta e OJF-ve janë në intervalin me shumë pak buxhet, ndërkohë që afro 30% e tyre kanë buxhet mbi 100.000 EUR. Afërsisht 16% e tyre nuk kanë dashur të japin përgjigje ose nuk e dinë nivelin e buxhetit të organizatës së tyre, duke na shtyrë të mendojmë se nuk kanë shumë informacion për këtë tregues të performancës së OJF-ve.

**TABELA 2**

Shpërndarja e buxhetit të OJF-ve

Pa buxhet ose me fare pak	18%
Deri në 100000 EUR	38%
Mbi 100000 EUR	28%

**TABELA 3**

Buxheti vjetor aktual i organizatës

nuk ka buxhet	10
mbi 500 EUR	2
5001 – 1000 EUR	0
1001 – 5000 EUR	3
5001 – 10,000 EUR	4
10,001 – 50,000 EUR	11
50,000 – 100,000 EUR	8
më shumë se 100,000 EUR	19
nuk e di	7
pa përgjigje	4



Pavarësisht vlerave të buxhetit që ka në dispozicion një organizatë, duhet të theksojmë se pjesa më e madhe e tyre varet ende nga burimet e huaja (më shumë se 90%). Një burim i rëndësishëm duket se janë dhe kuotat e anëtarësisë, megjithëse për nga madhësia e fondit, të ardhurat që mund të sigurohen nga to janë relativisht të vogla dhe natyrisht nuk mund të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare të OJF-ve. Një e pesta e OJF-ve ofrojnë shërbime kundrejt pagesave për të siguruar të ardhura. Ndërkohë që burimet vendore mundësojnë mbështetje financiare për afro 18% të organizatave që kanë plotësuar pyetësorët.

Duke patur parasysh që burimet e huaja financiare do të pakësohen gjithnjë e më shumë në vitet në vijim, OJF-të duhet të gjejnë rrugë e mundësi të tjera për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë e tyre duke shfrytëzuar burime të brendshme.

Për sa i përket fushave kryesore në të cilat punojnë grupimet shqiptare të shoqërisë civile, ka një shpërndarje mjaft të madhe në të gjithë sektorët e veprimtarisë së OJF-ve. Megjithatë, mund të themi se të drejtat e njeriut, të drejtat e grave apo interesat e grupeve të veçanta, si fëmijë, moshë e tretë, pakica kombëtare, shëndetësia, etj, janë fushat e veprimit me numrin më të madh të OJF-ve në vendin tonë.

**TABELA 4**

Burimet kryesore të financimeve për OJF

donacione/grante nga fondacione ndërkombëtare/ të huaja	64%
kuota anëtarësimi	29,33%
grante apo donacione të sektorit publik ndërkombëtar/qeveri të huaja	28%
pagesa prej shërbime të kryera (aktivitet ekonomik)	20%
donacione/grante nga fondacione vendore	17,33%

**TABELA 5**

## Aktivitetet Kryesore të OJF-ve

përhapje informacioni	74,67%
fushata ndërgjegjësimi	73,33%
punë në terren dhe trajnime/rritje kapacitetesh	66,67%
konferenca, takime dhe edukim	62,67%
shërbime këshillimi dhe botime	58,67%


Pavarësisht fushës së veprimtarisë së tyre, OJF-të kanë disa lloje aktiviteteve si më të preferuarat e tyre (Tabela 5). Duket qartë se pjesa më e madhe e tyre punon për përhapjen e informacionit, ndërgjegjësimin e komunitetit dhe grupeve përkatëse të synuara. Vlen për t'u përmendur se pothuaj të gjithë llojet e aktiviteteve përdoren nga OJF-të, me shumë pak përjashtime. Kjo tregon një kapacitet të madh të sektorit të tretë për realizimin e aktiviteteve të ndryshme, por dhe aftësitë përshtatëse të organizatave në një mjedis pune në ndryshim të vazhdueshëm.

## PROCEDURAT E BRENDSHME TË ORGANIZATAVE


Në këtë kuadër, pothuajse të gjitha OJF-të që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se ekzistojnë procedura të brendshme në organizatat e tyre. Në pjesën më të madhe të tyre ata kanë rregullore e manuale të ndryshme që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të organizatës. Siç vihet re nga pyetësorët, më së shumti, përgjigje të tilla japin organizatat që kanë aktivitet të vazhdueshëm. Me sa duket kjo është një nevojë që lind nga praktika e përditshme e një ngarkese të caktuar në punë, se sa një vendim i ndërgjegjshëm i një grupi njerëzish që punojnë së bashku. Pavarësisht se ekzistenca e këtyre dokumenteve pune nëpër OJF është në shkallë të lartë, është e nevojshme të shqyrtohet e vlerësohet përdorimi i tyre në praktikën e përditshme.

Madje një pjesë e mirë e organizatave (pak më pak se gjysma e tyre) theksojnë se kanë programe kualifikimi për drejtuesit dhe anëtarët e tyre. Ky është një fakt për t'u përshëndetur, por nëse do t'i rikthehemi faktit tjetër të varësisë nga fondet e huaja për aktivitetet e tyre, atëherë duhet të mendojmë që në rastin më të parë të mungesës së këtyre fondeve, këto programe do të pësojnë një reduktim të ndjeshëm.

Për sa i përket *komunikimit të brendshëm* dhe *shkëmbimit të informacionit* pjesa më e madhe e atyre që kanë plotësuar pyetësorët janë të kënaqur me nivelin e tyre në organizatat përkatëse. Janë vetëm pak organizata, në të cilat tregohet se ka mungesë komunikimi dhe nuk shkëmbet informacion.



Mes mjeteve që përdoren për të siguruar shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin e brendshëm duket se ka një larmi mjeteve që përdoren nga OJF-të për këtë qëllim. Vlen të përmendet se më shumë se gjysma e OJF-ve përdorin mjetet elektronike të komunikimit, ndërkohë që ende mjaft prej tyre bazohen shumë në mënyrat tradicionale të informimit dhe shkëmbimit të tij: takime periodike dhe botime (periodike ose jo). Kjo duket se është një element pozitiv që do të mund të sigurojë qëndrueshmëri të këtij fakti dhe në mungesë të burimeve të mjaftueshme, që mund të ndikojnë në përzgjedhjen e mjeteve të komunikimit të brendshëm nëpër organizata.




Transparenca e organizatave kushtëzohet fuqishëm edhe nga kuadri ligjor në të cilin ato punojnë. Njohuritë për këtë kuadër ligjor janë një detyrim dhe kusht për mirëfunksionimin e organizatave, sidomos kundrejt përfituesve dhe publikut në përgjithësi. Edhe organizatat duket se e vlerësojnë një element të tillë, për sa kohë që shumica dërrmuese e tyre i ndjekin me kujdes ndryshimet në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre. Sidoqoftë, pavarësisht nga kjo vëmendje e OJF-ve në këtë drejtim, informacioni i dobishëm që mund të sigurohet është i kufizuar, sidomos për OJF-të në rrethe. Për të shmangur këtë lloj vështirësie për OJF-të e rretheve, është e nevojshme që të ngrihen e të funksionojnë rrjete informimi aktive brenda sektorit. Gjithashtu, kjo pjesë, por natyrisht jo vetëm, mund të jetë dhe pjesë e mbështetjes nga aktorë të tjerë. Zëri më i dobishëm në këto përpjekje, është përfshirja e OJF-ve dhe publikut të gjerë në proceset e përmirësimit të kuadrit ligjor, një e drejtë kjo tashmë e sanksionuar me ligj në Shqipëri.

Nëse të gjitha organizatat përgatisin raporte të aktiviteteve dhe raporte financiare, arsyeja që i shtynjë ato duket se janë të ndryshme për pothuajse të gjitha OJF-të e intervistuar. Arsyeja më e fuqishme rezulton të jetë detyrimi i organizatave kundrejt donatorëve, ndërsa në një shkallë më të ulët e shohin këtë detyrim si rrjedhojë e kuadrit ligjor në fuqi. Nga rezultatet e pyetësorit duket se ka një ndryshim të lehtë ndërmjet raporteve të aktiviteteve dhe raporteve financiare, në arsyet për përgatitjen e tyre. Raportet financiare përgatiten më shumë për arsye të detyrimit ligjor sesa raportet e aktiviteteve, ndërsa këto të fundit shihen në shumë raste si


detyrime të kontratës me të tretë (kryesisht donatorët). Në fakt, të dy raportimet janë detyrime kontraktuale nga donatorët dhe ndryshimi i vlerësimit për ta, ndoshta mund të shpjegohet me ndryshimin e nivelit të rëndësisë që u japin organizatat këtyre raporteve si mjete informacioni për brenda dhe jashtë organizatës.



Gati 80% e OJF-ve pjesëmarrëse në anketim raportojnë se ato kryejnë kontroll financiar të pavarur për veprimtarinë e tyre. Duke patur parasysh që një shërbim i tillë ka kosto financiare të konsiderueshme dhe ka një numër mjaft të madh organizatash jofitimprurëse që e kryejnë, ia vlen të vlerësojmë arsyet për se kryhet një veprim i tillë.




Arsyet kryesore për të kryer kontroll të pavarur financiar rezultojnë se janë: rregullat e brendshme të organizatës dhe kërkesat e donatorëve. Gjithashtu, një veprimi të tillë i jepen vlera dhe për ndihmesën që mund të japë në sigurimin e fondeve të ardhshme nga organizatat. Gjithashtu, një kontroll i këtij lloji shihet dhe si burim informacioni për anëtarët, ç’ka tregon se ka disa mekanizma që funksionojnë për informimin e anëtarëve apo dhe të interesuarve të tjerë.




Në rastet kur nuk kryhen kontrollet financiare të pavarura, shumica e përfaqësuesve të organizatave nuk ka ditur të japë arsye për këtë. Ndërkohë që vetëm shumë pak prej tyre janë përgjigjur se mund të jenë të mjaftueshme raportet financiare të brendshme, apo që kontrolle të tilla kushtojnë shumë. Megjithatë duhet të vlerësohet fakti që janë gjetur më shumë arsye për ta kryer kontrollin financiar të pavarur dhe, në mes tyre, janë dhe ato që i përdorin këto mekanizma si burime të dhënash dhe informacioni.








Efikasiteti organizativ i OJF-ve ka disa tregues për t'u vlerësuar. Ndërmjet të tjerash, në pyetësor është grumbulluar informacion mbi ekzistencën dhe përdorimin e disa dokumenteve strategjike, manualesh e rregulloresh që kanë të bëjnë me procedurat e zakonshme të punës në një organizatë. Nga shqyrtimi i informacionit të grumbulluar rezulton se, shumica e OJF-ve të intervistuar e vlerësojnë si shumë të rëndësishme dhe shumë të përdorshme një strategji komunikimi ose të marrëdhënieve me publikun. Nga ky përfundim duket se OJF-të përpiqen që të arrijnë publikun dhe të interesuar të tjerë me informacionet që ata kanë. Megjithatë, nga një vlerësim i përgjithshëm i situatës, duket se ka ende një diferencë ndërmjet përpjekjeve të sektorit për të ofruar informacion dhe të tjerëve për ta marrë dhe për të krijuar një imazh të qartë për sektorin e shoqërisë civile. Natyrisht, ky hendek dhe shkaqet që e krijojnë mund të dalin jashtë mundësive të këtij studimi. Megjithatë, është e rëndësishme të shihet nga këto rezultate që për OJF-të, kontakti dhe informimi i publikut përbën një prioritet mjaft të lartë.



Nga rezultatet e pyetësorit, siç shihet dhe nga grafiku, të gjitha elementët e përmendur janë vlerësuar si të rëndësishëm nga shumica e organizatave pjesëmarrëse në anketim. Një e dhënë interesante është se, afro 20% e të intervistuarve e kanë lënë pa përgjigje këtë pyetje, duke treguar se prania dhe përdorimi i këtyre dokumenteve të menaxhimit të punës në organizatë nuk është e njohur për ta. Pavarësisht sa e vogël mund të quhet kjo shifër, në këndvështrimin e transparencës së organizatave, sidomos me anëtarët e tyre, është një tregues që duhet të merret në konsideratë dhe të shërbejë për planifikimin e masave të nevojshme.



Për sa i përket shkallës së përdorimit të sistemeve të menaxhimit, vlerësimi për përdorimin e tyre duket se është mjaft i mirë. Gati 80% janë të kënaqur nga përdorimi dhe efektiviteti i këtyre mekanizmave, ndërkohë që pjesa tjetër pothuaj 20% kanë vlerësim mesatar dhe të ulët për to, ose nuk dinë të japin një përgjigje. Edhe kjo përqindje është një tregues që duhet të nxisë marrjen e masave për përmirësimin e punës në këtë drejtim, qoftë nëpër OJF si njësi, qoftë në të gjithë sektorin e shoqërisë civile.

Pothuaj të gjithë të intervistuarit i vlerësojnë OJF-të e tyre si transparente dhe si institucione që gëzojnë besimin e publikut. Ky është një përfundim që jep disa indikacione: vetëvlerësimi për sektorin duket se është mjaft i lartë, sidomos kur bëhet fjalë për OJF-të përkatëse të personave pjesëmarrës në anketim. Megjithatë, jemi të mendimit se perceptimi i përgjithshëm i shoqërisë për OJF-të është shumë më i balancuar. OJF-të kanë transparencë, por kjo duhet të arrijë në nivele më të larta, të thellohet e të ofrojë më shumë mundësi njohjeje.

### Gjetje kryesore:

- Krijimi i OJF-ve ka arritur nivele të larta në tre periudha: vitet 1992, 1996 dhe 2001;
- Regjistrimi i OJF-ve ka ndodhur i zhvendosur në kohë nga krijimi i tyre, për shkak të kërkesave të ndryshme ligjore;
- Lloji më i zakonshëm i OJF-ve është “shoqata”, ndërkohë që mund të vihet re një tendencë në rritje për “qendrat”;
- Niveli i veprimtarisë së OJF-ve është kryesisht lokal dhe brenda vendit, ndërkohë që një pjesë shumë e vogël e OJF-ve shqiptare e shtrijnë veprimtarinë e tyre në nivel ndërkombëtar;
- Megjithëse pjesa më e madhe e OJF-ve veprojnë me një buxhet mesatar deri në 100.000 EUR, ka ende një pjesë të konsiderueshme që nuk ka pothuajse fare buxhet;
- Ndërkohë në disa nga OJF-të pjesëmarrëse në anketim, ka një mungesë informacioni mbi buxhetin në dispozicion, çka tregon mangësi për transparencën e këtyre OJF-ve;
- Pavarësisht vlerave të buxhetit, fakti është se OJF-të në

përgjithësi, janë shumë të varura nga fondet e huaja, kryesisht grante;

- Ka disa përpjekje për diversifikimin e burimeve financiare, sidomos ofrimin e shërbimeve për sigurimin e të ardhurave, por ende nuk janë të tilla që mund të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare për OJF-të;
- OJF-të kryejnë një shumëllojshmëri aktiviteteve, duke provuar kapacitet të madh të sektorit dhe aftësitë përshtatëse të tij;
- OJF-të që kanë veprimtari të vazhdueshme, kanë dhe procedurë të brendshme në fuqi;
- Shumica e OJF-ve të intervistuar vlerësojnë si të kënaqshme informacionin e brendshëm që shkëmbehet në organizatë;
- Kuadri ligjor në fuqi ka kërkesa të shumta që rregullojnë veprimtarinë e OJF-ve;
- Njohuritë e sektorit në këtë pikë janë të kënaqshme, por ka dallime të rëndësishme mes OJF-ve në Tiranë dhe atyre në rrethe;
- OJF-të përgatisin raporte të ndryshme, por në shumicën e rasteve, për shkak se kanë detyrime ndaj të tretëve, (donatorë, etj.) Për të njëjtat arsye, OJF-të kryejnë dhe kontrolle të pavarura financiare;
- OJF-të e vlerësojnë si shumë të rëndësishme dhe shumë të përdorshme një strategji komunikimi ose të marrëdhënieve me publikun;
- Me gjithë rëndësinë që u jepet këtyre dokumenteve, për një pjesë të anëtarëve të tyre nuk janë të njohura, çka paraqet nevojën për marrjen e masave të duhura;
- OJF-të shihen “nga brenda” si transparente dhe të suksesshme në fitimin e besimit të publikut, duke treguar një shkallë të lartë vetëbesimi, që mund të mos jetë plotësisht i njëjtë me mendimin e opinionit të gjerë publik;



## Rreth autorëve...

**Alken Myftiu** ka përfunduar studimet e larta për Inxhinieri Mekanike, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në 1996. Ka kryer trajnime të shumta brenda dhe jashtë vendit dhe ka eksperiencë të ndryshme pune në Shqipëri dhe Kosovë. Aktualisht punon si menaxher projekti tek 'Qendra Rajonale e Mjedisit'. Gjithashtu është vazhdimisht i angazhuar si trajner në fusha të ndryshme si, menaxhim projektesh, ngritje fondesh, planifikim strategjik, komunikim, etj, që prej vitit 1998.

**Aurela Bozo** punon si avokate pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare prej vitit 2004. Ajo është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Ajo mban titullin Master në Sociologji. Aurela Bozo është lektore e lëndës "Barazia gjinore dhe ligji" pranë UFO University.

## PJESA E DYTË

### MIRËQEVERISJA - PARAKUSHT PËR SHOQËRI CIVILE TË PËRGJEGJSHME DHE MË TRANSPARENTE

*As.Prof.Dr. Mihallaq Qirjo*

#### **Përgjegjshmëria sociale si normë funksionimi e OJF-ve**

Organizatat jofitimprurëse kanë pësuar ndryshime të dukshme përgjatë viteve të fundit. Ato konsiderohen ndër aktorët kryesorë të shoqërisë, të afta për të formëzuar procese të ndryshimit social, madje edhe politik. Ndonëse i mirëpranuar në nivel global, për shoqërinë shqiptare ky rol ende mbetet çështje e debatit brenda dhe jashtë sektorit. Paralelisht me rolin më të dukshëm në shoqëri, vetë OJF-të kanë përshkuar dhe vijojnë të ecin përmes një procesi maturimi, që duket në rritjen e shkallës së aktiviteteve, tipologjinë e tyre si dhe në vetë kompleksitetin e madh të OJF-ve. Këto ndryshime positive kanë çuar në forcimin e lidhjeve edhe me aktorët dhe institucionet e tjera të shoqërisë shqiptare, kryesisht të atyre përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të caktuara, por jo vetëm kaq.

Në këtë magnitudë të gjerë ndryshimi, shumica e OJF-ve të institucionalizuara në strukturë dhe funksionim kanë filluar të kërkojnë dhe vlerësojnë shkallën e përgjegjshmërisë institucionale.

“Ne duhet të flasim më shumë për shoqëri të përgjegjshme se sa për përgjegjshmëri sociale. Nuk mund të ketë shoqëri të përgjegjshme nëse qytetarët, shoqatat, OJF-të, partitë politike, institucionet dhe bizneset nuk janë të përgjegjshme.”

*Angel Castiñeira dhe Josep M. Lozano. “Bizneset e përgjegjshme”, La Vanguardia 24/11/05*

Përgjegjshmëria sociale mat shkallën se sa organizatat bazohen tek vlerat për të cilat janë themeluar. Ajo shprehet përmes ekzistencës së mjeteve të menaxhimit që ndihmojnë organizatat në procesin e tyre të transformimit të vazhdueshëm dhe të vlerësimit të rezultateve të arritura. Pa informacionin e grumbulluar nga brenda organizatës është e vështirë të garantohet sukcesi i dëshiruar, për rrjedhojë bëhet e pamundur lidhja mes vlerave të organizatës dhe mënyrës së funksionimit të saj.

Përgjegjshmëria sociale ka ndikimin e saj mbi të gjitha sjelljet dhe veprimet në një organizatë. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të përmirësohet me veprime të pjesshme të tipit kozmetik apo “arnime përmirësuese” të procedurave të funksionimit.

*Vlerësimi i një organizatë nëse është e përgjegjshme dhe e shëndetshme në aspektin funksional duhet kryer në dy drejtime kryesore:*

1. Në mënyrën e menaxhimit të OJF-së përmes kryerjes së analizës së fushave kryesore funksionale të saj (ngritja e fondeve dhe marketingu, menaxhimi financiar, menaxhimi i burimeve njerëzore, etj) dhe analizimi i çështjeve transversale si proceset e planifikimit, strategjive, etj.
2. Marrëdhëniet e organizatës me mjedisin rrethues: përfituesit, partnerët dhe bashkëpunëtorët, transparenca, komunikimi në nivele të ndryshme me publikun, donatorët, etj.

Ndonëse pavarësia në krijimin e organizatave jofitimprurëse ka favorizuar edhe krijimin e shumë modeleve të menaxhimit dhe mirëqeverisjes së këtij sektori, në thelb ato kanë shumë ngjashmëri mes tyre. Ndër dy drejtimet e përmendura më sipër, disa i japim më shumë rëndësi drejtimit të parë dhe

organizata të tjera atij të dytë. Në këtë material po trajtojmë më në thellësi dhe detaje çështje që lidhen kryesisht me drejtimin e parë, i cili shpesh referohet si “mirëqeverisje”.

## **Qeverisja e mirë në sistemin jofitimprurës**

Qeverisja e mirë nënkupton menaxhimin efektiv të burimeve që disponojnë OJF-të, në mënyrë të hapur, transparente, të besueshme, cilësore dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit. Zbatimi i ligjit, transparenca, besueshmëria dhe efektshmëria e menaxhimit janë elemente thelbësore të qeverisjes së mirë.

Në ditët e sotme, mirëqeverisja adresohet gjerësisht si një nga përbërësit kyç që ndihmojnë në zhvillimin e shoqërisë civile. Si e tillë, qeverisja duhet të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të OJF-ve. Si kudo gjatë, edhe në shoqërinë dhe OJF-të shqiptare vihen re mangësi në mirëqeverisjen dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile.

Shumica e OJF-ve synojnë të bëhen organizata të qëndrueshme, e për pasojë çështja e qeverisjes së mirë kthehet në një aspekt jetësor për ekzistencën e tyre. Qasja sipas parimeve që bazohen në proceset pjesëmarrëse, ose ndryshe menaxhimi me pjesëmarrje, është thelbësor në demokratizimin e shoqërisë, sepse ndihmon transparencën dhe vendimmarrjen demokratike, llogaridhënien e mirë dhe efektshmërinë e funksionimit të organizatës. OJF-të shqiptare shfaqin shpesh mangësi në burimet dhe kapacitetet e tyre institucionale, si dhe në menaxhimin e fondeve të ofruara nga organizata të ndryshme donatore. Më qëllim që këto të fundit të sigurojnë menaxhimin e duhur të burimeve, duhet që aspektet e qeverisjes së mirë të konsiderohen si prioritare dhe të marrin rëndësi të veçantë për çdo OJF.

OJF-të e përgjegjshme japin llogari për veprimtarinë e tyre dhe mënyrën e zbatimit të saj. Pa këtë lloj llogaridhënieje, OJF-të nuk arrijnë të ballafaqohen me presionin që ndihmon në arritjen e standardeve të qeverisjes dhe sigurojnë menaxhimin efektiv të burimeve të ndryshme njerëzore, financiare dhe materiale sipas kërkesave dhe modeleve të një organizate të qëndrueshme dhe demokratike.

Transparenca, pjesëmarrja dhe ngritja e institucioneve efektive nuk janë aspak





objektiva të lehta për t'u arritur. Ato kërkojnë nivel të konsiderueshëm të ekspertizës teknike, aftësi praktike dhe angazhim burimesh. Mungesa e parakushteve të sipër-përmendura, e bën më të vështirë qeverisjen e mirë, por sidoqoftë mbi të gjitha qëndron dëshira dhe vullneti i mirë për ta kryer, si dhe njohja e principeve të qeverisjes së mirë të organizatës. Nëse problemi nuk merr seriozitetin e duhur, atëherë ai mund të dëmtojë vlerat dhe ekzistencën afatgjatë të organizatës, duke humbur anëtarët e për rrjedhojë duke çuar në zvogëlimin e anëtarësisë dhe duke krijuar organizatat pa anëtarësi të ashtuquajtura **MONGO** (nga anglishtja “*My Own NGO*”, e përkthyer në shqip “Organizata me një anëtar”), ose “**shoqatat valixhe**”, të cilat nuk arrijnë kurrë të bëhen institucione të vërteta me stafin e tyre përkatës, hapësirat e punës dhe sistemet e instaluar.

## Monitorimi i OJF-ve, rregullorja dhe qeverisja

Sigurimi i transparencës së OJF-ve, nënkupton krijimin e kushteve për shprehjen e hapur të mendimeve dhe ideve, shpërndarjen e lirë të informacionit dhe zbatimin e ligjit, i cili është thelbësor për funksionimin efektiv të çdo OJF-je. Pyetjet kyçe që shtrohen për përgjigje janë: Ndaj kujt japin llogari OJF-të? Kë ose çfarë përfaqësojnë ato?

Debati mbi këto argumente është rritur shumë, ndërsa OJF-të kanë zgjeruar më tej qëllimet dhe dimensionin e punës së tyre. Në të njëjtën kohë, strukturat e tyre kanë kuptuar se efektiviteti i punës është më i lartë kur bashkëpunimi dhe përfshirja e aktorëve të ndryshëm është më e madhe, prandaj punojnë për të nxitur përfshirjen e shumë partnerëve të ndryshëm të shoqërisë. Përgjigja e pyetjes së parë vlen për anëtarët që vendosin të krijojnë një OJF, të cilët dëshirojnë të japin kontributin e tyre në të mirë të komunitetit.

### Dimensionet e një OJF-je të qëndrueshme.

- Mjedisi;
- Aftësia organizative;
- Kapaciteti financiar;
- Marrja në mbrojtje dhe përfaqësimi i politikave;
- Aftësia për të dhënë shërbime;
- Infrastruktura e OJF-së;
- Imazhi publik.

Më gjerësisht, OJF-të e realizojnë procesin e transparencës ndaj publi-kut të gjerë, përmes procesit të regjistrimit dhe rregullores së funksionimit, shpërndarjes së informacionit të rregullt mbi aktivitetet dhe funksionimit dhe realizimit të kontakteve me grupin të cilit i shërbejnë. Nga ana tjetër, OJF-të e ushtrojnë llogaridhënien ndaj donatorëve përmes dorëzimit të raporteve dhe zbatimit të planit të miratuar të aktiviteteve.

OJF-të që punojnë me grupet pa përkrahje dhe të marginalizuar të shoqërisë, e shohin veten e tyre si përfaqësues të interesave të këtyre njerëzve. Ndërsa, OJF-të që janë më të përfshira në aspekte të veçanta të grupeve pa përkrahje ose me çështje që ndikojnë në mirëqënien e shoqërisë si e tërë, e shohin veten më tepër si përfaqësues të një çështjeje, sesa të një grupi të veçantë njerëzish. Në të dyja rastet, përfaqësimi është më i fortë dhe dominues, nëse struktura e OJF-së nuk është e centralizuar, por demokratike dhe e bazuar në parimet pjesëmarrëse.

*Çdo organizatë ka nevojë që të mbështesë punën e saj në një grup vlerash thelbësore mes të cilave mund të përmendim:*

- respektin ndaj anëtarëve dhe komunitetit që i shërben;
- punën në skuadër;
- bashkëpunimin;
- drejtimin ndaj rezultateve;
- fuqizimin;
- dhe rregullshmërinë.

Këto vlera sinergjike thelbësore varen nga njëra-tjetra. Duke u mbështetur në to, OJF-ja do të ketë rezultate dhe performancë të suksesshme dhe në të njëjtën kohë i krijon mundësi stafit të saj që të japë maksimumin e aftësive personale.

Për të patur një OJF funksionale, transparente dhe efikase në punën e saj, rëndësi të dorës së parë kanë elementë kyç të mëposhtëm:

**Vizioni:** i cili përfaqëson shprehjen e qartë të një qëllimi të thellë për të cilën organizata është ngritur dhe funksionon. Vizioni krijohet dhe komunikohet nga drejtuesit e organizatës, të cilët janë tërësisht të përkushtuar për realizimin e tij.

**Pjesëmarrja personale dhe fuqizimi;** është një element kyç i cili vë theksin dhe siguron një mjedis ku individit i sigurohen të gjithë kushtet e nevojshme për rendiment personal të suksesshëm dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje. Mes kësaj rruge drejtuesit fuqizojnë vetveten dhe japin mundësinë që me prezencën e tyre të fuqizohen edhe të tjerët.

**Integriteti strukturor;** Drejtuesit duhet ta shohin organizatën si një sistem kompleks ku struktura institucionale mund ta ndihmojë apo pengojë realizimin e vizionit.

**Të qenurit krijues;** përfshin aftësinë për të integruar të menduarin e llogjikshëm me arsyen dhe intuitën. Në një organizatë njerëzit duhet të besojnë se mund të krijojnë atë që duan, të arrijnë atë për të cilën besojnë dhe të marrin përsipër përgjegjësi. OJF-ja duhet të udhëhiqet drejt produkteve dhe rezultateve të dukshme cilësore e sasiore, sipas standardeve të OJF-së dhe në shërbim të vizionit të saj.

#### **Aftësia organizative e një OJF-je**

Për të marrë informacion mbi aftësinë organizative të një OJF-je mund të drejtojmë disa pyetje:

- A ka përpjekje OJF-ja për të ndërtuar një vazhdimësi në nismat e saj?
- A ka një mision të mirëpërcaktuar për të cilin punon?
- A përdor një plan strategjik për vendimmarrje?
- A ekzistojnë struktura menaxhuese brenda OJF-së, përfshirë këtu edhe ndarjen e detyrave?

## **Përfshirja dhe pjesëmarrja – mjet për transparencën e brendshme**

Qeverisja e mirë varet nga vendimmarrja e mençur. Për të arritur këtë vendimmarrje dhe integritet kuptimi, rëndësi të veçantë merr pjesëmarrja dhe përfshirja e të gjitha niveleve të organizatës. Anëtarët e OJF-ve duhet të njohin statusin e organizatës dhe duhet të dinë nëse ata janë pjesë e vendimmarrjes dhe nëse parashikohet kjo në misionin e saj. Informimi është kusht thelbësor

për një pjesëmarrje efektive. Por shpesh, anëtarët dhe bordi thonë se informacioni që ata marrin, më shumë e pengon se sa e lehtëson qeverisjen e mirë dhe udhëheqjen e drejtë. *Vlerësimet më të shpeshta dhënë prej tyre, janë se:*

- informacioni që ata marrin në shumicën e rasteve është i shumtë, i papërzgjedhur dhe i padobishëm;
- nuk marrin informacion të mjaftueshëm për një vendimmarrje të caktuar apo planifikim të saktë;
- marrin materialet e nevojshme me vonesë.

Në një OJF efektive, sistemi i informacionit duhet të fokusohet në *procesin e vendimmarrjes, stimulimin e pjesëmarrjes, dhe mbështetjen e balancave të përshtatshme të përgjegjësive midis bordit dhe stafit.*

Në shumicën e testeve, informacioni për OJF-të është kryesisht i rastësishëm. Pavarësisht nga paaftësia që krijon një informacion i tillë për të parashikuar se kur mund të shpërndahet dhe në çfarë mase, materiale të tilla janë të dobishme për të krijuar një përshtypje të përgjithshme në lidhje me aktivitetin e organizatës. Vlen të theksohet se informacioni i rastësishëm nuk është i mjaftueshëm për të ndihmuar bordin dhe anëtarët të marrin pjesë, të marrin vendime apo të vlerësojnë suksesin e organizatës.

## **Zhvillimi i manualeve administrativë dhe financiarë**

“Sektori jofitimprurës joqeveritar”, sikundërse edhe sektorët e tjerë duhet të ngrihet dhe funksionojë mbi bazën e një sërë parimesh të menaxhimit të përditshëm. Hartimi dhe përdorimi i tyre është jo vetëm një kusht për një transparencë të plotë ndaj Bordit drejtues, stafit dhe mbështetësve, por edhe ndaj organeve shtetërore ndaj të cilave OJF-ja është e detyruar të raportojë mbi veprimtarinë e saj financiare dhe fuqinë punëtore.

Shumë organizata ende funksionojnë pa një sistem të tillë menaxhimi. Ndonëse shumë prej tyre mund të thonë se nuk e ndjejnë nevojën apo nuk kanë patur probleme nga mospasja e një manuali administrativ, ato mund të jenë përballur me situata kur duhet të justifikonin një veprim të bërë, apo

duhet të gjenin zgjidhje për një veprim tjetër duke mos qenë të sigurtë nëse kjo zgjidhje ishte ajo e duhura. Në shumicën e rasteve mungesa e një dokumenti të tillë çon në konflikte mes stafit për çështje si pagesat dhe mënyrën e kryerjes së tyre, menaxhimin e burimeve të organizatës nga anëtarë të ndryshëm, etj.

Manualet administrative përmbledhin rregullat dhe mënyrën e funksionimit të OJF-së. Ata përshkruajnë në mënyrë të detajuar funksionimin administrativ të organizatës (nga hierarkia e përgjegjësive deri tek orari i punës dhe menaxhimi i burimeve) dhe menaxhimin financiar (përdorimin e burimeve financiare, llogarive bankare dhe parasë *cash*, dietat dhe mënyrën e pagesës së punonjësve, etj.). Në organizata të ndryshme, manualët administrative quhen edhe rregullore e brendshme e organizatës, por në këto raste zakonisht përfshihen vetën çështje të menaxhimit të kohës dhe burimeve, duke lënë mënjanë menaxhimin financiar apo atë të burimeve njerëzore të organizatës.

Manualet administrative janë të rëndësishëm për të paraqitur mënyrën e funksionimit të OJF-së në rastet e mëposhtme:

- a) për mbështetjen në rregullore të çdo veprimi të kryer nga stafi ekzekutiv;
- b) për justifikimin e duhur në rast të auditimeve të brendshme dhe atyre të jashtme të organizatës;
- c) në rastin e punësimit të anëtarëve të rinj apo zëvendësimit të drejtuesit të OJF-së, manuali administrativ lejon vazhdimësinë e punës sipas sistemit të miratuar më parë. Në rastin e punonjësve të rinj manuali administrativ është një mjet që ju tregon atyre sesi duhet të veprojnë në kuadër të punës në organizatë, çfarë të drejtash dhe detyrash ka çdo punonjës dhe është një garanci se organizata funksionon me të njëjtin sistem për të gjithë punonjësit e saj.

Manualet administrative duhet të përshtaten në bazë të kushteve në të cilat punon organizata. Për këtë arsye, manuali administrativ duhet të rishikohet të paktën çdo vit duke përshtatur ato pjesë të tij, të cilat gjatë një viti kanë ndryshuar, për shembull, hapja e një dege të re të organizatës apo blerja e një makine, kërkojnë përshtatje edhe në manualin administrativ. Ndryshimet mund të bëhen edhe për nivelin e pagesës së dietës apo mënyrës sesi kompensohen

shpenzime të caktuara të stafit. Nëse përshtatjet dhe ndryshimet nuk janë shumë të mëdha, atëherë mund të bëhen vetëm ndryshime të vogla të paraqitura në trajtën e shtojcave që vendosen brenda manualit të mëparshëm, duke nënkuptuar se shtojca e re nxjerr jashtë funksionit atë pjesë të manualit që ishte më e vjetër. Nëse ndryshimet janë të mëdha, apo pas disa vitesh, manuali është mbushur me shumë shtojca, mund të ngrihet një grup pune, i cili të hartojë apo rifreskojë manualin ekzistues në një manual të ri.

Në çdo rast, procesi i ndryshimeve në manualin administrativ drejtohet nga Drejtuesi Ekzekutiv i organizatës dhe miratohet nga Bordi në një mbledhje të veçantë të tij. Vetëm në këtë rast ndryshimi kthehet në një “ligj” për organizatën.

### Zhvillimi i sistemit të informacionit dhe korrespondencës

Sistemi i informacionit në një organizatë është një ndër elementët më të rëndësishme të mirë-funksionimit të saj. *Ai garanton që informacioni që vjen apo del jashtë organizatës:*

- a) të shkojë tek personi ose grupi i duhur i personave;
- b) të përdoret në mënyrë sa më efektive;
- c) të garantojë vazhdimësinë e rrjedhës së informacionit edhe në rastet kur ka ndryshime në stafin apo në drejtimin ekzekutiv të organizatës.

Në shumicën e organizatave me një sistem të dobët dhe të paorganizuar të informacionit vërehen probleme të tilla si: mangësi në përçimin e informacionit më të fundit nga drejtuesi deri tek njësia vepruese, e për rrjedhojë: rendimenti është më i ulët; pushteti centralizohet tek ato hallka ku mbërrin informacioni, mbështetësit largohen; lindin pakënaqësi të stafit për shkak të mungesës së informimit; etj.

Në ditët e sotme, menaxhimi i informacionit brenda një organizate është akoma më kompleks sesa 10 vjet më parë. Futja e teknikës dhe mjeteve të komunikimit elektronik (postës elektronike dhe internetit) bën që një pjesë shumë e madhe e informacionit të shkëmbehet lehtësisht në mënyrë elektronike brenda kohës reale. Kjo krijon mundësi të pafundme në komunikimin brenda organizatës, por edhe në komunikimin me mbështetësit e saj duke dërguar jo vetëm informacione të kufizuara, por edhe fotografi, prezantime nga çdo vend në glob (nëse ti je i lidhur me internet).

Nga ana tjetër, kjo sasi e madhe informacioni e bën më të vështirë menaxhimin e tij. Shumë njerëz ende nuk kanë përgatitjen dhe kualifikimin e duhur për të përpunuar dhe shpërndarë informacionin elektronik në sasinë, kohën dhe formatin e duhur, në mënyrë që ai të jetë efektiv. Dërgesat shumë të gjata shpesh përbëjnë shqetësim për njerëzit që i marrin, e për rrjedhojë, mund të mos lexohen dhe përdoren. Menaxhimi brenda organizatës i informacionit elektronik është një çështje më vehte. Shumë organizata shtypin në letër shumë prej mesazheve të ardhura elektronikisht. Kjo mund të çojë në volume të tëra korrespondence që është harxhim kohe dhe materiale. Organizatat duhet të arshivojnë vetëm atë pjesë të informacionit elektronik, i cili është i rëndësishëm për vendimmarrjen, për progresin e një aktiviteti, përmban informacione të vlefshme për organizatën apo partnerë të tjerë, etj. Lidhur me këtë çështje, organizata duhet të marrë kohë pas kohe, kurse kualifikimi mbi mënyrat e reja të menaxhimit të informacionit elektronik, të cilat do ta ndihmojnë për një menaxhim sa më efektiv të këtij informacioni.

Korrespondenca tradicionale mbetet ende një ndër mënyrat më të përhapura të komunikimit midis anëtarëve dhe partnerëve, mbështetësve, etj. Sistemi i arshivimit të këtij informacioni është më i thjeshtë dhe shumë prej nesh kanë një përvojë nga e shkuara mbi mënyrën e regjistrimit dhe ruajtjes së këtij informacioni. Kujdesi që tregohet në këtë drejtim ndihmon në “shkrimin e historisë së OJF-së”. Pavarësisht nga ndryshimet në stafin apo drejtuesit e OJF-së, korrespondenca jep informacion të plotë mbi kontaktet dhe ecurinë e marrëdhënieve me partnerë të ndryshëm nëse ajo është mbajtur siç duhet.

Përmes korrespondencës së shkruar, OJF-ja paraqet fytyrën e saj specifike. Miratimi i stemës së organizatës dhe i formatit zyrtar të shkresave të dërguara, ndihmon që të krijohet asociacioni i duhur me OJF-në tuaj, menjëherë sapo marrësi të hapë dhe fillojë leximin e saj. Disa organizata kanë arritur progresin e duhur në këtë drejtim duke qenë shumë strikte në mënyrën sesi mbajnë korrespondencën me partnerët e tyre brenda apo jashtë vendit dhe duke përgatitur e botuar materiale të ndryshme që ndihmojnë zgjerimin mbi baza profesionale të marrëdhënieve me publikun.

## Mjetet e transparencës përmes informacionit

Zakonisht burimi më i mirë i informacionit është vetë organizata. Informacioni mund të jetë i përgjithshëm (rreth misionit, fushës së veprimit, funksionimit të OJF-së, etj) ose specifik (rreth aktiviteteve të një projekti të veçantë, botime specifike, etj).

Shumica e OJF-ve botojnë *raporte vjetore* të cilat i shpërndajnë tek mbështetësit, anëtarët si dhe aktorët e tjerë kyç. Në përgjithësi raporti vjetor përfshin misionin e OJF-së si dhe një përmbledhje të programeve të saj, një listë të anëtarëve të bordit dhe stafit, informacion financiar (shpesh bilancin vjetor financiar). Shumë OJF kanë faqe interneti, revista dhe fletëpalosje të përgjithshme apo specifike rreth aktiviteteve të veçanta.

*Në përmbledhje, mund të themi se transparenca në një OJF realizohet në këto drejtime:*

### 1. Qeverisja

- Një OJF duhet të qeveriset në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe me përgjegjësi nga Bordi Drejtues.
- OJF-të duhet të kenë Bord Drejtues të pavarur, aktiv dhe të mirë-informuar. Bordi duhet të ketë politika të cilat specifikojnë kohën dhe dendësinë e mbledhjeve, takimeve të Bordit dhe pjesëmarrjen e mjaftueshme të tij.  
Bordi duhet të adaptojë një politikë, e cila ndalon konfliktet direkte dhe indirekte të interesave nga anëtarët e Bordit, të punësuarit dhe vullnetarët.
- Bordi duhet të pranojë përgjegjësitë përfundimtare për qeverisjen, në të gjithë aspektet e organizatës.
- Bordi duhet të miratojë buxhetin vjetor, të caktojë një revizor të pavarur dhe të marrë për shqyrtim deklaratat financiare vjetore të kontrollit financiar dhe revizionit.
- Bordi duhet të aplikojë politika pjesëmarrëse për të gjithë në organizatë.

### 2. Integriteti

- Aktivitetet e Organizatës duhet të jenë të hapura që të mund të hetohen



nga donatorët dhe të interesuarit.

- OJF-të duhet t'u sigurojnë të punësuarve ruajtjen e informacionit.
- OJF-të duhet të kundërshtojnë dhe pengojnë çdo akt rryshfeti, korrupsioni, mospërpikmërie financiare apo akte joligjore në veprimtarinë e tyre. Standardet etike duhet të ruhen me fanatizëm pavarësisht nga praktikat e gabuara, të kundraligjshme dhe të pamoralshme që mund të ndeshen jo rrallë në shoqërinë e sotme shqiptare.
- OJF-ja duhet të respektojë dinjitetin, vlerat, besimin, kulturën dhe historinë e komunitetit që përfaqëson.
- OJF-të duhet të mbajnë parasysh që aktivitetet e tyre janë parësore në formimin e perceptimit publik për to.

### **3. Menaxhimi Financiar**

- Financat e një OJF-je duhet të organizohen dhe drejtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë përdorimin efikas e të saktë të fondeve, si dhe dhënien e llogarisë para donatorëve, anëtarëve dhe mbështetësve.
- Çdo vit, OJF-ja duhet të publikojë deklaratën e transparencës financiare, bazuar në auditimin vjetor.
- Bilanci financiar duhet t'i vihet në dispozicion çdo të interesuari, bazuar në një kërkesë të arsyeshme me shkrim.
- Raporti vjetor duhet të përfshijë qëllimin e organizatës, bilancin financiar përmbledhës, objektivat vjetore, përmbledhjen e aktiviteteve të programuara, rezultatet e punës dhe informacion rreth anëtarëve të Bordit. Raporti është dokument publik, i vënë në dispozicion të çdo institucioni dhe/ose individi të interesuar.
- OJF-të duhet të veprojnë sipas një buxheti të miratuar nga Bordi dhe duhet të raportojnë vazhdimisht për shpenzimet.

### **4. Komunikimi me Publikun**

- OJF-ja duhet të bëjë transparencë të plotë, të drejtë dhe të saktë lidhur me objektivat, programet, financën dhe drejtimin e saj.
- Kërkesat për grumbullimin e fondeve duhet të jenë sa më realiste

dhe të përshkruajnë saktësisht identitetin e organizatës, qëllimin, programet dhe nevojat e saj. Organizata nuk duhet të përfshihet në fushata publicitare negative apo qëndrime kritikizmi ndaj organizatave të tjera për të përfituar për vete.

- Komunikimi në një organizatë duhet të respektojë dinjitetin, vlerat, historinë, besimin dhe kulturën e personave që janë përfituesit e programeve të saj.
- Në rast se një organizatë angazhohet në grumbullimin e fondeve apo marketingut, sasia e fondeve duhet të përcaktohet qartë dhe kontrollohet për të gjithë aktivitetet që kryhen në emër të organizatës. Të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e sigurimit të fondeve sado të vogla qofshin, duhet të dokumentohen me shkrim.

## **5. Praktikrat Menaxhuese të Burimeve Njerëzore.**

- OJF-ja duhet të rivlerësojë vazhdimisht dhe periodikisht misionin dhe veprimtarinë e vet në kuadrin e ndryshimeve të vazhdueshme të mjedisit të jashtëm, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm planifikimi strategjik.
- OJF-ja duhet të hartojë politika dhe procedura të shkruara, të cilat duhet të përcaktojnë qartë detyrat dhe të drejtat e stafit të punësuar.
- Përfitimet e të punësuarve duhet të përshkruhen dhe të komunikohen qartë.
- OJF-ja duhet të ketë procedura dhe politika që përkrahin barazinë gjinore, minoritetet, pluralizmin dhe shumëllojshmërinë në rekrutim, punësim, trajnim si dhe në zhvillimin e përparimin profesional të punonjësve.

## **6. Programi i veprimtarive**

- Programi i OJF-së duhet të promovojë dhe lehtësojë mbështetjen në forcat e veta, ndihmën, pjesëmarrjen e publikut, përfshirjen e komunitetit, etj.
- Anëtarët e OJF-së duhet të jenë përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve dhe të programeve.



- OJF-ja në programin e saj duhet t'i japë prioritet punës me institucionet dhe grupet lokale e kombëtare.
- Aktivitetet e programuara duhet të respektojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin, vlerat, besimin, kulturën, historinë e komunitetit të cilit OJF-ja i shërben.
- Në programin e tyre OJF-të duhet të kujdesen për forcimin e kapaciteteve të grupeve më të pambrojtura si gratë, fëmijët, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara dhe të varfërit.
- Programi i veprimtarive duhet të përfshijë procedura transparente të monitorimit dhe vlerësimit.
- Programi i veprimtarive duhet të krijojë vend dhe hapësirë të mjaftueshme për ndarjen e njohurive dhe të përvojës me të tjerët.
- Programi duhet të ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe standardeve profesionale të fushës së aktivitetit të OJF-së.
- Programi duhet të sigurojë që ndihmat nga ana e OJF-ve të jepen mbi baza jo diskriminuese.
- OJF-ja duhet të sigurojë bashkëpunim me organizatat e tjera dhe shpërndarje efektive të burimeve.

## 7. Politikat publike

- Një OJF duhet të hartojë politika të qarta lidhur me çështjet ku duhet të përfshihet në marrjen në mbrojtje dhe përfaqësimit të çështjeve, politikave publike dhe kërkimit të të drejtave.
- OJF-ja duhet të jetë transparente dhe duhet të ndjekë linjën e përcaktuar nga strukturat vendimmarrëse të saj, në qëndrimin ndaj politikave të ndryshme publike.

## BIBLIOGRAFIA

Allison, M.; Kaye, J. (1997) "Strategic planning for nonprofit organizations. A practical guide and workbook", Nonprofit Series, Ed. John Wiley & Sons, Inc.

Bobo, K; Kendall, J.; Max, S. (1991) "Organizing for social change", Seven Locks Press, Washington, USA.

Qirjo, M. (2005) "Çështje të Organizimit dhe Mirëqeverisjes së OJQ-ve Kosovare", Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile, Prishtinë, Kosovë.

Vidal, P. (2005) "Social responsibility of non-profit organizations. A conceptual approach and development of the SRO model" Observatori del Tercer Sector

Caroline 10, 08012 – Barcelona, Spain.

### Rreth Autorit...

**Mihallaq Qirjo** është pedagog në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe ai i Shkencave Sociale. Diplomuar në Biologji në 1990, mban titujt "Doktor i Shkencave" (1996) dhe "Profesor i Asociuar" (2004). Prej vitit 1992, ka qenë i angazhuar aktivisht në sektorin e shoqërisë civile në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal përmes përfshirjes në aktivitete të ndryshme trajnuese dhe kualifikuese, në fushat e organizimit dhe menaxhimit të sektorit jofitimprurës. Ai është autor i shumë materialeve dhe artikujve për zhvillimin dhe fuqizimin e këtij sektori.



## TRANSPARENCA E OJF-VE NËPËRMJET KRIJIMIT DHE REGJISTRIMIT TË TYRE SIPAS LIGJIT

*Av. Vjollca Meçaj*

Organizatat jofitimprurëse si manifestim i ushtrimit të së drejtës kushtetuese për organizim kolektiv.

E drejta për t'u organizuar kolektivisht është një e drejtë njerëzore dhe bën pjesë në grupin e të drejtave dhe lirive politike të shtetasve. Ajo sanksionohet nga neni 46/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 11/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe, së bashku me ligje e akte të tjera nënligjore në fuqi, përbëjnë bazën ligjore për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturave që përfaqësojnë një organizim kolektiv, midis të cilave dhe organizatat jofitimprurëse.

Dëshira e shtetasve për t'u organizuar kolektivisht, apo për të krijuar dhe për të marrë pjesë aktive në organizata jofitimprurëse është, së pari, një manifestim i karakterit shoqëror i qenies njerëzore, i dëshirës për të zhvilluar marrëdhënie ndërnjerëzore, si dhe për të ndikuar pozitivisht në jetën e gjithsecilit, ose të komunitetit në përgjithësi. Në mënyrë të veçantë, në shoqërinë demokratike, për vetë filozofinë e këtij sistemi shoqëror, organizatat jofitimprurëse janë jo vetëm konkretizimi i një të drejte themelore të shtetasve<sup>1</sup>, por dhe një domosdoshmëri, pasi ato kanë rolin e një prej strukturave të ndërmjetme, që veprojnë në “hapësirën” midis qytetarit dhe shtetit dhe shërbejnë për t'i lidhur e harmonizuar ato.

Vendosja në këtë pozicion, brenda skemës së shoqërisë, u mundëson

<sup>1</sup> Bëhet fjalë për të drejtën e organizimit kolektiv, të sanksionuar nga neni 46/1 i Kushtetutës dhe neni 11/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

organizatave jofitimprurëse të vepronë në të dyja kahet. Ato, sipas formës organizative ose qëllimeve dhe objektivave që kanë përcaktuar, ndërhyjnë me veprimtarinë e tyre tek shtetas të veçantë ose grupe shtetasish, të cilëve u ofrojnë mbështetjen dhe shërbimet që kërkohen prej tyre, ose ndërhyjnë pranë strukturave të shtetit për të mbështetur ose kundërshtuar mënyrën se si u japin zgjidhje çështjeve që i paraqesin interesit shoqëror ose grupeve të veçanta të tij. Organizatat jofitimprurëse, sipas rastit, mund të shndërrohen në oponentë, opozitë ose bashkëpunëtore të strukturave të shtetit, në procesin e hartimit të politikave dhe strategjive lidhur me çështje të interesit publik, si dhe gjatë procesit vendimmarrës lidhur me to.

Zhvillimi i bashkëveprimit trepalësh, midis shtetasve nga njëra anë, organizatave jofitimprurëse dhe shtetit nga ana tjetër, nuk mund të kryhet veçse në kushtet e transparencës së plotë, e cila shërben si mjet për njohjen e qëllimit të secilës palë bashkëpunuese, si garanci për mosçënimin e të drejtave të palëve në bashkëveprim, si mjet që mundëson zbatimin e lirë e të plotë të kompetencave nga secila palë.

Në fakt, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar të drejtën e organizimit kolektiv, ka nënvizuar dukshëm një kusht themelor për ushtrimin e saj. E drejta e organizimit kolektiv mund të ushtrohet vetëm për qëllime të ligjshme. Nga ky standard kushtetues kuptojmë se objektivat dhe qëllimet, që përcakton dhe shpall si të vetat çdo organizatë jofitimprurëse, si dhe mjetet që do të përdorë për t'i realizuar ato, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nga sa u tha më sipër, rezulton e qartë se, "legjislacioni në fuqi" është jo vetëm pika e referimit me të cilën bëhet krahasimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse por, nga ana tjetër është mjeti që mundëson bërjen e transparencës së tyre në raport me anëtarët e saj, me publikun e gjerë dhe shtetin.

Në këtë mënyrë legjislatori ka garantuar që ushtrimi i të drejtës së organizimit kolektiv, nëpërmjet krijimit të një organizate jofitimprurëse nga një grup shtetasish, nuk do të çënojë interesat e mbrojtura me ligj të shtetasve të tjerë dhe as kompetencat e organeve shtetërore.

## ***Organizatave jofitimprurëse si subjekte të së drejtës private dhe Transparenca ndaj palëve me të cilët lidh marrëdhënie.***

Organizatave jofitimprurëse janë subjekte të së drejtës private. Legjislacioni në fuqi u garanton atyre të drejtën për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti. Ato dalin si palë në marrëdhëniet juridiko-civile, fitojnë të drejta e marrin përsipër detyrime në emër të vet, me qëllim që të mundësojnë zhvillimin e veprimtarisë së tyre dhe realizimin e objektivave që i kanë vënë vetes, gjithmonë në të mirë të interesit të publikut.

Duke u shprehur lidhur me rëndësinë e organizatave jofitimprurëse në shoqërinë demokratike, Z. Leon E. Irish, president i Qendrës Ndërkombëtare për Ligjet e Sektorit pa Qëllim Fitimi, ka nënvizuar se këto organizma, për shkak të mospasjes së qëllimit të fitimit, shquhen për efikasitetin e tyre, për shkak të kostos më të ulët, të njohjes më të mirë të nevojave të publikut, si dhe për plotësimin e tyre me cilësi më të mirë se sa ajo që do të ofronin strukturat e mëdha të shtetit.

Është e qartë se, të vepruarit pa patur qëllime fitimi përbën elementin që i dallon organizatat jofitimprurëse në raport me subjektet e tjerë privatë, që veprojnë në qarkullimin civil. Kjo përbën një tjetër arsye që imponon transparencën e duhur nga organizatat jofitimprurëse, me qëllim që të parandalohet cënimi i konkurrencës së lirë midis subjekteve privatë në veprim. Mungesa e transparencës do t'u mundësonte subjekteve privatë fitimprurës, të fshiheshin prapa ndonjëres nga format e organizatave jofitimprurëse dhe, jo vetëm të zhvillojnë konkurrencë të paligjshme dhe evazion fiskal<sup>2</sup>, por dhe të krijojnë konfuzion e mosbesim në gjirin e shoqërisë civile.

Në kuadër të veprimtarisë së gjerë e të rëndësishme që zhvillojnë organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga forma organizative që kanë zgjedhur (shoqatë, qendër ose fondacion), kanë nevojë të domosdoshme të përfshihen në marrëdhëniet juridiko-civile. Ato kanë nevojë të sigurojnë fonde për të mbuluar shpenzimet e aktiviteteve që do të kryejnë; të blejnë ose marrin me qira mjediset në të cilat do të zhvillojnë veprimtarinë dhe do të instalojnë selinë e

<sup>2</sup> Sipas ligjit organizatat jofitimprurëse përfitojnë lehtësi fiskale, që nuk i gëzojnë subjektet me veprimtari fitimprurëse.

tyre administrative; kanë nevojë të sigurojnë mjetet e nevojshme të punës; të kontraktjnë me punonjës, që krahas vullnetarëve të mundshëm do të punojnë për përmbushjen e detyrave dhe programit të miratuar, etj. Kjo pjesëmarrje në marrëdhëniet juridiko-civile i ngarkon organizatat jofitimprurëse si të gjithë subjektet e tjerë, me detyrimin për të qenë transparente me të gjitha palët, me të cilat do të lidhë marrëveshje (kontrata).

Për të gjitha arsyet e përmendura më lart, por jo vetëm për to, organizatave jofitimprurëse u nevojitet personaliteti juridik, ose e thënë ndryshe, aftësia që të veprojnë si palë në marrëdhëniet juridiko-civile dhe që me veprimet e tyre të fitojnë të drejta e të marrin përsipër detyrime. Pikërisht për këtë arsye legjislatori është kujdesur të miratojë një kuadër ligjor, në të cilin përcaktohen rregullat për themelimin, organizimin, funksionimin dhe regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Ato janë të lira ta përcaktojnë vetë formën organizative, duke zgjedhur njërën prej atyre që ligji i përcakton dhe konkretisht midis shoqatës, qendrës ose fondacionit. Vetëm pasi të jenë regjistruar si të tilla organizatat jofitimprurëse do të fitojnë personalitet juridik.

Normat ligjore kryesore lidhur me sa më sipër, i gjejmë në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", si dhe në ligjin nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".

Zhvillimi i disa veprimtarive të caktuara, që nga natyra e tyre janë më pranë rrezikut të cënimit të të drejtave të shtetasve, kushtëzohet me marrjen e licensës përkatëse, detyrim që i nënshtrohen edhe organizatat jofitimprurëse, ashtu sikundër të gjithë subjektet e tjerë që dëshirojnë të veprojnë në atë fushë. Procedura e pajisjes me licensë është një mundësi tjetër për bërjen e transparencës nga ana e organizatave jofitimprurëse, pasi ato duhet të depozitojnë pranë organit licensues gjithë informacionin e tyre kryesor, sipas ligjit.

Përveç sa më sipër, meqenëse organizatat jofitimprurëse zhvillojnë veprimtari që lidhet me plotësimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave që u përkasin grupeve shoqërore të caktuara ose komunitetit në përgjithësi, për të gëzuar besimin e tyre, duhet të ofrojnë garanci ligjore dhe transparencë të mjaftueshme edhe në raport me ta.





Komuniteti ka nevojë t'i njohë organizatat jofitimprurëse, të njohë kapacitetet e tyre organizative dhe vepruese, organet drejtuese, personat që veprojnë në emër të organizatës, mjetet financiare e materiale të tyre, sepse vetëm në këto kushte mund t'u japë atyre besimin e duhur dhe mbështetje për veprimtarinë që zhvillojnë. Një organizatë jofitimprurëse që ka objektiva të mëdha, që premtion shërbime, mbështetje sociale dhe iniciativa të gjëra qytetare por, që nuk ka organe drejtuese të qarta e të zgjedhura në mënyrë demokratike, që nuk ka funksionim të brendshëm, që nuk tregon se nga i vijnë mjetet financiare e materiale që disponon e përdor, nuk mund të gëzojë besimin e publikut dhe të mbështetet prej tij.

### ***Karakteristikat e transparencës së organizatave jofitimprurëse***

E drejta e organizatave jofitimprurëse për të vepruar e ndërhyrë në politika me interes publik e privat, sjell domosdoshmërisht nevojën për transparencë, ligjshmëri dhe korrektësi nga ana e saj. Sa më sipër është pjesë e balancës midis të drejtave e detyrimeve në një shoqëri demokratike. Çdokush, qoftë ai subjekt publik apo privat, që mbart një të drejtë mbi persona të tjerë ose mbi komunitetin në përgjithësi, mbart në të njëjtën kohë dhe detyrimin, në favor të personave me të cilët punon e vepron, për t'u mundësuar atyre transparencën mbi organizimin e funksionimin e vet.

Natyrshëm lind pyetja, deri ku shtrihet detyrimi për transparencë i organizatave jofitimprurëse? Cilat janë ato çështje që u përkasin organizatave jofitimprurëse, për të cilat publiku i gjerë dhe strukturat e shtetit duhet të kenë njohuri të plota e të sakta, me qëllim që të mund të mbrojnë të drejtat e tyre? Cili është organi që e garanton këtë transparencë? Përgjigjet e këtyre pyetjeve i gjejmë, kryesisht, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në ligjin nr.8788, datë 07.05.2001 "**Për organizatat jofitimprurëse**", si dhe në ligjin nr.8789, datë 07.05.2001 "**Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse**".

Dispozitat ligjore të cituara më sipër, përcaktojnë se organizatat jofitimprurëse duhet të jenë transparente lidhur me aspektin e tyre organizativ, programor dhe financiar. Këto tre drejtime kryesore të transparencës nënkuptojnë nevojën e bërjes publike të llojit të organizatës jofitimprurëse (shoqatë, qendër ose

fondacion); organet drejtuese të saj, mënyrën e funksionimit të tyre, personat që do të bëjnë pjesë në to dhe mënyrën e zgjedhjes së tyre; identitetin e plotë të personave që do të veprojnë në emër të organizatës jofitimprurëse, me të tretë; burimet e financimit dhe të pasurive që organizata ka në dispozicion, si dhe rregullat dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Po kush mund t'i verifikojë të dhënat e mësipërme dhe si duhet ta bëjë këtë verifikim pa çënuar pavarësinë e organizatave jofitimprurëse? Informacioni që lidhet me transparencën e organizatave jofitimprurëse, duhet të jetë i verifikueshëm dhe i kontrollueshëm, në rradhë të parë nga anëtarët e organizatës, si dhe personat që marrin shërbime prej tyre, ose hyjnë në marrëdhënie me to. Por veprimtaria e organizatave jofitimprurëse nuk është thjesht çështje private, ajo lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me interesat e publikut të gjerë dhe nganjëherë dhe të të gjithë vendit, prandaj transparenca e tyre është dhe çështje e interesit publik.

Për këtë transparencë është i interesuar edhe shteti me strukturat e tij përbërëse, pasi ai<sup>3</sup> ka përgjegjësinë kushtetuese të garantojnë ligjshmëri<sup>4</sup> në jetën e vendit dhe gëzim të plotë të të drejtave nga shtetasit dhe subjektet e tjera të krijuara sipas Kushtetutës e ligjeve. Gjithsesi, strukturat e shtetit do të mbikëqyrin organizatat jofitimprurëse vetëm për ato çështje dhe në atë masë që ligji u ka përcaktuar, pa i diskriminuar organizatat jofitimprurëse në raport me subjektet e tjera dhe pa u çënuar pavarësinë e krijimit dhe të veprimit.

Në këndvështrimin e mësipërm, paraqesin interes të veçantë dy momente të historisë së ekzistencës së organizatës jofitimprurëse. Momenti i parë është ai i lindjes së organizatës jofitimprurëse si një subjekt me zotësi për të vepruar, ose ndryshe, lindjen si subjekt në formën e personit juridik. Ligji "Për organizatat jofitimprurëse", në nenin 3, në paragrafin e tretë të tij, përcakton se: "Çdokush ka të drejtën e organizimit, pa pasur nevojë për ta regjistruar këtë si një organizatë jofitimprurëse" por, në momentin që ai organizim kërkon të jetë palë në marrëdhëniet juridiko-civile duhet të regjistrohet, sepse vetëm kështu do të mund të fitonte statusin e personit juridik. Gjatë procedurës së

<sup>3</sup> Nënkuptohe shteti

<sup>4</sup> Me këtë term duhet të kuptojmë miratimin e ligjeve në përputhje me Kushtetutën dhe në përshtatje me nevojën e zhvillimit të vendit, si dhe zbatimin e drejtë të tyre nga çdo subjekt.



regjistrimit realizohet kontrolli i pajtueshmërisë me ligjin të aktit të themelimit dhe akteve të tjera bazë të organizatës jofitimprurëse, si dhe mundësohet bërja publike e informacionit kryesor lidhur me atë organizatë.

Ku duhet të regjistrohen organizatat jofitimprurëse për të fituar personalitetin juridik? Në ligjin nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" dhe në ligjin nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" është përcaktuar se regjistrimi do të bëhet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Në fakt, ky përcaktim ligjor ka qenë dhe vazhdon të jetë çështje e kontestueshme nga komuniteti i organizatave jofitimprurëse, vendase dhe të huaja. Ato, pa kundërshtuar juridiksionin gjyqësor për këtë çështje të rëndësishme, nuk janë dakort me përqendrimin e kompetencës vetëm pranë gjykatës së Tiranës, duke e konsideruar këtë një faktor që rrit koston e regjistrimit për organizatat jofitimprurëse dhe në mënyrë indirekte kufizon të drejtën e organizimit kolektiv. Lidhur me këtë çështje, së shpejti mund të ndërmerret një iniciativë ligjbërëse nga shoqëria civile shqiptare.

Moment tjetër i rëndësishëm për një organizatë jofitimprurëse është dhe ai kur midis saj dhe një subjekti tjetër lind një konflikt, që vë në diskutim bazueshmërinë në ligj të krijimit të organizatës, të veprimtarisë që ajo zhvillon, ose vendimmarrjen e organeve drejtuese të saj. Edhe zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve është në juridiksion të sistemit gjyqësor. Parimi kushtetues i ndarjes së pushteteve parashikon se, pushteti gjyqësor është ai që në mënyrë të pavarur dhe duke u bazuar në ligj do të zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet, kur palët nuk arrijnë mirëkuptimin.

Në këtë mënyrë, legjislacioni ka mundësuar garancitë e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e pavarur të organizatave jofitimprurëse dhe nga ana tjetër respektimin e të drejtave dhe lirive të subjekteve të tjerë që do të bashkëveprojnë me to, duke i kryer proceset e mësipërme nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor, që siç dihet, është i hapur për publikun dhe me transparencë të plotë.

Rregullimi ligjor lidhur me krijimin, regjistrimin, si dhe parimet kryesore lidhur me funksionimin e organizatave jofitimprurëse, nuk kanë për qëllim të pengojnë apo kufizojnë këto veprimtari, përkundrazi, dispozitat ligjore përbëjnë një garanci për zhvillimin dhe ushtrimin normal të tyre, duke ofruar transparencën

e nevojshme, si dhe pa dëmtuar interesat e subjekteve të tjerë publikë e privatë.

***Transparenca e organizatave jofitimprurëse gjatë procesit të themelimit të tyre.***

Transparenca e organizatave jofitimprurëse është e domosdoshme që në momentin e themelimit të tyre. Ligji parashikon se të drejtën për themelimin e organizatave jofitimprurëse e kanë pa kufizim, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj. Ligji sanksionon gjithashtu se, organizatat jofitimprurëse e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore dhe se shteti duhet të mbështesë dhe të nxisë veprimtarinë e tyre.

Sa në sipër, nuk mohon të drejtën e publikut dhe institucioneve shtetërore apo private, të marrin informacion mbi organizatat jofitimprurëse, ashtu sikundër e kanë këtë të drejtë, nëse janë të interesuar, edhe ndaj çdo subjekti tjetër që ushtron veprimtari në publik.

Legjislatori është kujdesur, gjithashtu, të shpjegojë se çfarë përfaqëson secila nga këto forma organizative dhe dallimet midis tyre, duke lënë të lirë subjektet themelues të zgjedhin formën më të përshtatshme në funksion të qëllimeve që kërkojnë të realizojnë, fondeve dhe pasurive që kanë në dispozicion, si dhe veprimtarive që kërkojnë të kryejnë.

Duke zgjedhur njërin nga format organizative të sipërpërmendura për themelimin e organizatës së tyre jofitimprurëse, subjektet themelues kanë parapërcaktuar natyrën e organizatës së tyre. Ata nuk mund të themelojnë një “shoqatë” e më pas të veprojnë si “fondacion” apo si “qendër” dhe anasjelltas. Një veprim i tillë jo vetëm do të vinte në kundërshtim me ligjin, por dhe do të krijonte konfuzion tek palët që do të hynin në marrëdhënie juridikocivile me këtë organizatë, ose do të merrnin shërbime prej saj.

Për ta bërë më të kuptueshme atë që shprehet më sipër, le të shohim në mënyrë të përmbledhur se çfarë përfaqëson secila nga këto forma organizative.

- *Shoqata* është një organizatë jofitimprurëse, *me anëtarësi*, që themelohet me vullnetin e lirë të *jo më pak se 5 personave fizikë, ose 2 personave juridikë*, që vepron për realizimin e një qëllimi të ligjshëm,

në të mirë dhe interes të publikut, ose anëtarëve të saj, duke përdorur fonde apo *pasuri në pronësi të saj, apo të fituara sipas ligjit*.

- *Fondacioni* është një organizatë jofitimprurëse, pa anëtarësi, që themelohet me vullnetin e lirë *të një ose më shumë* personave fizikë, ose juridikë, me anë të një *akti noterial ose testament*, që vepron për realizimin e një qëllimi të ligjshëm, *me anë të destinimit të pasurive që disponon*, në të mirë dhe në interes të publikut.
- *Qendra* është një organizatë jofitimprurëse, pa anëtarësi, që themelohet me vullnetin e lirë *të një ose më shumë* personave fizikë, ose juridikë, me anë të një *akti noterial ose testament*, që vepron duke patur si objekt të veprimtarisë së saj *kryerjen e shërbimeve dhe realizimin e projekteve* për qëllime në të mirë dhe në interes të publikut, me *fonde dhe të ardhura, të siguruara sipas ligjit*.

Nënvizimet e bëra në paragrafët e mësipërm tregojnë qartë dallimet që ekzistojnë midis formave të ndryshme të organizatave jofitimprurëse.

Sicë e dimë tashmë, organizatat jofitimprurëse, pasi janë themeluar mund të regjistrohen me qëllim që të fitojnë personalitetin juridik. Pikërisht, gjatë procesit të regjistrimit, transparencës së bërë në mënyrë vullnetare nga themeluesit e organizatës jofitimprurëse i shtohet konfirmimi lidhur me bazueshmërinë në ligj të akteve bazë të saj.

### ***Transparenca e organizatave jofitimprurëse nëpërmjet regjistrimit të tyre.***

Sicë është theksuar edhe më sipër, organizatat jofitimprurëse për të fituar personalitet juridik, duhet t'i nënshtrohen verifikimit gjyqësor. Në këtë rast gjykata verifikon dokumentacionin e krijuar për themelimin e organizatës, si përsa i përket ligjshmërisë së themelimit, të bazueshmërisë në ligj të qëllimit dhe objektivave që do të ndiqen, si dhe të burimeve të financimit që do të përdoren nga organizata.

Gjykatat, si organe të specializuara dhe pjesë të një pushteti të pavarur, duke u bazuar në standardet ligjore për krijimin, regjistrimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse, i ndihmojnë këto të fundit të pozicionohen, që në fillim të jetës së tyre, në përputhje me ligjin. Për këtë qëllim, legjislacioni në fuqi parashikon se kërkesa drejtuar gjykatës për miratimin dhe regjistrimin e një

organizate duhet të shoqërohet me aktin e themelimit dhe statutin e organizatës. Këto dy dokumente, që quhen dhe dokumentet bazë të organizatës jofitimprurëse, përmbajnë informacionin më të rëndësishëm lidhur me të.

Vendimi përkatës i gjykatës që bën konfirmimin e ligjshmërisë së organizatës së themeluar dhe të qëllimit/meve e objektivave të saj, së bashku me një kopje të statutit e të aktit të themelimit duhet të depozitohen për t'u regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të organizatave jofitimprurëse. Në këtë mënyrë, mundësohet bërja e transparencës lidhur me të dhënat kryesore të organizatave jofitimprurëse sepse i gjithë informacioni kryesor rreth organizatës së regjistruar është i hapur për publikun dhe kushdo mund të kërkojë e të marrë një kopje, kundrejt pagesës së tarifës. Tani le të shohim më në detaje se cili është informacioni që duhet të përmbajnë dokumentet bazë të një organizatë jofitimprurëse.

Akti i themelimit duhet të përmbajë, detyrimisht, informacion të qartë e të plotë lidhur me: llojin e organizatës; emërtimin e saj; adresën e saktë të selisë; identitetin e plotë të themeluesve; qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së organizatës; kohëzgjatjen; përfaqësuesin/sit ligjorë të saj; emrin e personit të ngarkuar për të ndjekur procedurat e regjistrimit.

Një informacion i saktë dhe i plotë lidhur me organizatën duhet përfshirë dhe në statutin e saj. Në mënyrë të veçantë, në të përfshihen rregullat e organizimit dhe funksionimit të organizatës. *Lidhur me këtë aspekt, legjislacioni nënvizon veçanërisht se në statut duhet të përfshihet:* ndalimi i shpërndarjes së fondeve ose pasurive të organizatës në favor të themeluesve të saj, personave që mbulojnë postet drejtuese apo punonjësve të tjerë; informacioni i nevojshëm për kompetencat e organeve drejtuese dhe mënyrën e zgjedhjes/emërimit, ndryshimit dhe funksionimit të tyre; kuoromet e nevojshme dhe mënyrën e votimit për marrjen e vendimeve; kriteret e administrimit të pasurisë dhe fondeve të organizatës; mënyrën e miratimit dhe të ndryshimit të statutit dhe të rregullave të brendshme; rregullat për bashkimin me një organizatë tjetër, të ndarjes, transformimit në një formë tjetër dhe shpërndarjes së organizatës; rastet e konfliktit të interesave midis organizatës dhe anëtarëve, organeve drejtuese apo punonjësve të tjerë; rregullat për likuidimin dhe destinimin e pasurive të organizatës.



Përveç sa më sipër, për shoqatat, statuti duhet të përmbajë dhe rregullat e pranimit të anëtarëve ose të përjashtimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, si dhe rregullat lidhur me kuotizacionin. Ndërsa përsa u përket fondacioneve dhe qendrave, ato duhet të përfshijnë në statut dhe informacion lidhur me burimet materiale e financiare, të siguruara nga themeluesit, si dhe rregullat për mënyrën e përdorimit të tyre.

Ky informacion është i detyrueshëm dhe i nevojshëm sepse mundëson marrjen në dijeni dhe bën transparencën e duhur lidhur me organizatën për subjektet themelues, për anëtarët dhe organet e saj, si dhe për publikun e gjerë. Informacioni i mësipërm mundëson të kuptohet se çfarë përfaqëson secila organizatë jofitimprurëse, çfarë synon të realizojë ajo dhe me çfarë mjetesh. Nëpërmjet këtij informacioni realizohet transparenca, si për anëtarët ose punonjësit e organizatës, ashtu dhe për subjektet e tjerë që do të hyjnë në marrëdhënie me organizatën jofitimprurëse, si dhe për publikun e gjerë.

### ***Transparenca e organizatave jofitimprurëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përditshme.***

Forma, emërtimi, akti i themelimit, statuti dhe, në mënyrë të veçantë, përbërja e organeve drejtuese të organizatës jofitimprurëse nuk janë të përherëshme. Nevojat për zhvillimin e organizatës, si dhe nevoja për t'u përshtatur gjithnjë e më mirë me problemet e komunitetit të cilit ajo i shërben, imponojnë ndryshime të vazhdueshme në strukturën e mësipërme.

Në mënyrë të veçantë, ndryshimet janë më të pranishme në organizatat jofitimprurëse që kanë formën e shoqatës, në të cilën vendimmarrjen më të rëndësishme e ka në kompetencë asambleja ose mbledhja e përgjithshme e anëtarëve. I takon këtij organi të vendosë lidhur me personat që do të zgjidhen në postet drejtuese të organizatës, të ndryshojë ose zgjerojë qëllimin dhe objektivat e saj, të ndryshojë statutin ose aktin e themelimit, e të tjera si këto. Në këto rrethana është e natyrshme që numri i madh i anëtarëve (e parë kjo gjithmonë në raport me numrin e personave që janë themelues në një fondacion ose qendër) rrit probabilitetin e ndryshimeve që do të ndodhin gjatë jetëgjatësisë së shoqatës.

Çështja e rikonfirmimit në mënyrë periodike, të mandatit të personave që mbajnë postet drejtuese në organizatat jofitimprurëse, si dhe shqyrtimi i

veprimtarisë së tyre nga organet më të larta në hierarkinë organizative, lidhet me zbatimin e parimit të demokracisë në jetën e brendshme të organizatave jofitimprurëse.

Këto organizata nuk janë “pronë” e personave që i kanë themeluar apo familjeve të tyre, ato nuk janë biznes privat, dhe qëllimi e objektivat që promovojnë nuk janë e nuk mund të jenë sipas ligjit, çështje private e personale. Siç është nënvizuar disa herë më lart, organizatat jofitimprurëse prodhojnë, nxisin e zbatojnë politika dhe veprimtari në të mirë e në interes të publikut, prandaj drejtimi i tyre nuk mund të mbetet përjetësisht në duart e një ose disa individëve. Kjo do të vinte ndesh me parimet e shoqërisë demokratike, do të kufizonte të drejtën e zgjedhjes brenda organizatës dhe konkurrimin e ideve dhe të vlerave që shërbejnë për ta zhvilluar atë.

Çështja e demokracisë së brendshme organizative nuk është vetëm çështje morale e parimore. Ajo është, gjithashtu, një çështje ligjore. Duke iu referuar *Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë*, ligjit “*Për organizatat jofitimprurëse*”, si dhe ligjit “*Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse*” konstatojmë se organet drejtuese të organizatës jofitimprurëse janë të rinovueshme. Ky rregull vlen, si për organet që përcaktohen në aktin e themelimit ose në statutin e organizatës, ashtu dhe për organe të tjera që mund të krijohen me rregulla të brendshme.

Jo vetëm statusi fillestar i organizatës jofitimprurëse, i miratuar me vendimin gjyqësor përkatës, por dhe të gjitha ndryshimet e mëpasme që kanë pësuar organet drejtuese të organizatës, ndryshimet që pësojnë aktet bazë të saj, duhet të regjistrohen pranë Zyrës së Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse. Në këtë mënyrë, transparenca e organizatës jofitimprurëse bëhet e plotë e në vazhdimësi dhe gjithkush që është i interesuar, mund të verifikojë jo vetëm momentin fillestar organizativ të saj, por dhe të konstatojë se si ka funksionuar në kohë jeta organizative dhe demokracia në atë organizatë.

Organizatave jofitimprurëse mund të kërkojnë e marrin prej Zyrës së Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse, vërtetime lidhur me regjistrimet e kryera pranë saj dhe në këtë mënyrë, mund t’i provojnë publikut dhe



donatorëve seriozitetin, korrektësinë dhe demokracinë që mbizotëron në jetën e tyre të brendshme. Kjo i bën organizatat jofitimprurëse më të besueshme e më të legjitimuara për t'u angazhuar në çështje të interesit dhe të të mirës publike.

### ***Transparenca e organizatave jofitimprurëse përpara anëtarëve, organeve drejtuese dhe donatorëve.***

Transparenca e organizatave jofitimprurëse ka rëndësi të madhe edhe në aspektin e jetës së brendshme të saj. Organet e ndryshme të organizatës janë të detyruara të bëjnë publike veprimtarinë e tyre, në radhë të parë, brenda organizatës. Kështu, legjislacioni në fuqi përcakton si të detyrueshme, të paktën një herë në vit, mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve të shoqatës, si dhe detyrimin e organeve të tjera për t'i raportuar asaj asambleje.

Një çështje shumë e rëndësishme, që lidhet me transparencën e brendshme të organizatave jofitimprurëse, është mbrojtja nga konflikti i interesave midis organizatës dhe organeve ose anëtarëve të saj. Për të evituar këtë konflikt, në nenet 26 e 27 të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse” janë përcaktuar disa norma ndaluese, si dhe rrugët e zgjidhjes së konfliktit të interesit të vërtetuar në fakt.

Dispozitat e mësipërme ligjore përcaktojnë se anëtari i organit drejtues që ka konflikt interesi me organizatën, lidhur me një çështje që organi drejtues ka në shqyrtim, nuk mund të marrë pjesë në votim. Po kështu, është me shumë rëndësi sanksionimi tjetër ligjor, sipas të cilit, punonjësit e paguar të organizatës jofitimprurëse nuk mund të jenë njëkohësisht dhe anëtarë të organit vendimmarrës të saj (shih paragrafin e fundit të nenit 27 të ligjit në fjalë). Nëse do të ndodhte e kundërta, pra bashkimi i organeve vendimmarrëse me ato ekzekutive, do të krijoheshin kushte për shpërdorim të mjeteve materiale e financiare të organizatës dhe do të eliminohej kontrolli i brendshëm i strukturave të saj, sipas hierarkisë.

Dispozitat ligjore të cituara më sipër orientojnë organizatat jofitimprurëse, që në përshtatje me natyrën e qëllimet e tyre, të parashikojnë në aktet e tyre bazë,

si dhe në akte të tjera të brendshme, edhe norma të tjera veç atyre të fiksuara në ligj, për parandalimin dhe mbylljen e çdo shtegu për manifestimin e konfliktit të interesit. Zbatimi i këtyre normave është një garanci për funksionimin e rregullt dhe të jetëgjatësisë së veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse, për suksesin e tyre dhe besueshmërinë e mbështetjen e publikut.



## BIBLIOGRAFIA

### Dispozita ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”

Ligji nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”

## LITERATURË

“Problemet ligjore parësore për ndërhyrje në legjisllacionin që rregullon veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse” (Prill 2007), përgatitur e paraqitur nga një grup pune i shoqërisë civile shqiptare, në kuadër të një projekti të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur, bërë publik, Tiranë.

Instituti për Studime Publike & Ligjore (2003), “Ligjet për organizatat jofitimprurëse” Komentar, Tiranë.

Leon E. Irish, (2000) “Roli dhe synimi i sektorit pa qëllim fitimi”, Tiranë.

Meçaj, V. (2003), “Çështje të zbatimit të ligjit ‘Për organizatat jofitimprurëse’ prezantim mbajtur në një forum me shoqërinë civile, Tiranë,

Rutzen, D. (2001), “Vëzhgime e sugjerime mbi legjisllacionin që rregullon regjistrimin, funksionimin dhe mbarimin e organizatave jofitimprurëse”, Prezantim, Tiranë,.

## **Rreth Autores...**

**Vjollca Meçaj** ka përfunduar studimet e larta universitare për Drejtësi në Universitetin e Tiranës në vitin 1973. Në vitin 1992 ka mbrojtur titullin e Avokatit dhe në vitin 1997 titullin e Noterit. Gjatë karrierës së saj profesionale ka punuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit të Beratit, në administratën e lartë shtetërore dhe ka ushtruar profesionet e lira të Avokatit dhe Noterit. Nga viti 2004, deri në vitin 2007, ka qenë anëtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Është aktiviste në lëvizjen e gruas në shoqëri që nga fillimet e saj dhe është aktivizuar me Shoqatat 'Refleksione', 'Aleanca Gjimore për Zhvillim', 'Qendra për Nisma Ligjore Qytetare', 'Koalicioni kundër Korrupsionit', etj. Është autore e teksteve dhe artikujve të ndryshëm shkencorë në fushën e të drejtës, e të drejtave të njeriut dhe të barazisë gjimore. Është aktualisht e aktivizuar në mësim-dhënie pranë shkollës së Magjistraturës në Tiranë dhe Universitetit 'Luarasi'.



# ROLI I ORGANIZATAVE PËR FORCIMIN E RENDIT KUSHTETUES NË SHQIPËRI

## Kushtetuta dhe Organizatat Jofitimprurëse

*Prof. Dr. Aurela Anastasi*

Është e rëndësishme të vëmë në dukje se organizatat dhe shoqatat janë subjekte që zënë një vend të posaçëm në nivel kushtetues, ku rregullohen aspekte themelore në lidhje me statusin dhe veprimtarinë e tyre. Kjo ndodh për shkak të rolit që ato kanë në zhvillimin demokratik të vendit.

Pa mënjanuar rëndësinë që kanë dispozitat e Kushtetutës që i pozicionojnë organizatat si subjekte të të drejtave dhe lirive themelore me cilësinë e personave juridikë<sup>5</sup>, një vlerë të dukshme marrin rregullimet e hollësishme për organizimin, regjistrimin dhe funksionimin e tyre. Gjithashtu, mjaft interes paraqesin mjetet dhe instrumentet që Kushtetuta u njeh organizatave dhe shoqatave, për mbrojtjen e interesave të tyre.

### 1. E drejta për t'u organizuar dhe kufijtë kushtetues e ligjorë të programit dhe veprimtarisë së organizatave

*“Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm”* (neni 46 i Kushtetutës). Në këtë mënyrë, afirmohet e drejta për t'u organizuar, si një e drejtë që u përket të gjithë qytetarëve. Kushdo mund të anëtarësohet në organizata dhe këto të fundit, mund të krijohen për qëllime nga më të ndryshmet, mjaft që ky qëllim të mos vijë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Kështu, është bërë e mundur të kemi kategori të larmishme organizatash, të cilat në bazë të Kushtetutës, mund të përmbliidhen në parti politike, shoqata dhe organizata të tjera.

<sup>5</sup> Neni 16/2 i Kushtetutës sanksionon: “Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve”.

Kushtetuta e ndalon shprehimisht, krijimin e organizatave që ndjekin qëllime antikushtetuese. Në nenin 9/2 ajo sanksionon: *“Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si dhe ato me karakter të fshehtë, janë të ndaluara sipas ligjit”*.

Për sa më sipër gjykojmë se, Kushtetuta e RSh-së, duke pasur në vëmendje rolin veprimtar të organizatave për mbarëvajtjen e demokracisë në vend dhe për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, ka përcaktuar shprehimisht, rastet kur mund të ndalohet veprimtaria e organizatave. Ajo i është referuar ligjit për të përcaktuar mënyrën se si do të ndalohet kjo veprimtari, ndërkohë që ligji do të mbajë parasysh shkaqet e parashikuara nga Kushtetuta. Këtë sanksionim kushtetues mund ta lidhim edhe me nenin 46/3 të saj, i cili vendos se, *“Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit”*. Pra, qëllimet që përbëjnë shkak për antikushtetutshmëri dhe për ndalimin e veprimtarisë së organizatave, janë përcaktuar shprehimisht nga vetë Kushtetuta (neni 9), sipas rasteve që vijojnë:

- kur programi dhe veprimtaria e organizatave mbështeten në metoda totalitariste;
- kur organizatat nxisin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike;
- kur organizatat përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore;
- kur organizatat kanë karakter të fshehtë.

Sidoqoftë, përveç sa më sipër, mund të themi se organizatat ose shoqatat ndjekin qëllime antikushtetuese në çdo rast që çënohen ose shkelen të drejtat dhe liritë themelore të individit, apo nenet e Kushtetutës.

Në lidhje me shkaqet për antikushtetutshmëri, Kushtetuta i referohet ligjit për të përcaktuar më hollësisht mënyrën për ndalimin e krijimit të organizatave të tilla dhe për mbylljen e veprimtarisë së tyre. Në këtë kuadër, ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (OJF-të) ka përcaktuar detyra të posaçme për këto organizata. Në nenin 7 të tij ai sanksionon parimin e

pavarësisë së OJF-ve dhe të mos-ndërhyrjes së shtetit në këtë veprimtari, duke theksuar se, “...*Organet shtetërore nuk ndërhyjnë në veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse. Ndalimi ose kufizimi i veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse bëhet vetëm në rastet dhe mënyrën e përcaktuar në ligj*”.

Në të vërtetë, ky ligj nuk ka parashikuar asnjë rast për ndalimin ose kufizimin e veprimtarisë së OJF-ve, ndërsa duhet të përcaktonte shkaqe ligjore. Ai mbetet sërish në rrethana referuese duke mos qartësuar se cilëve nga ligjet u referohet konkretisht dhe, cilat do të ishin këto ligje të tjera, që mund të përcaktonin rastet për antiligjshmëri të OJF-ve. Kjo nuk bëhet shumë e qartë as nga Komentari përkatës mbi ligjet për organizatat jofitimprurëse<sup>6</sup>.

Në fakt, një përcaktim i tillë do të ishte mjaft i rëndësishëm për të mos lejuar abuzime dhe për të mos lënë shkas për ekuivok. Sidoqoftë, është e qartë se mund të legjitimohen qëllime dhe programe organizatash, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me ligjet ekzistuese. Vetë kushtetuta e lejon organizimin për çfarëdo qëllimi të ligjshëm (neni 46 i Kushtetutës), gjë që përjashton organizimin për qëllime të paligjshme. Qëllimi, programi dhe veprimtaria e organizatave nuk mund t'i kundërvihen ligjit apo të ndjekin qëllime antiligjore. Kështu, p.sh., një shoqatë e krijuar për të mbrojtur të drejtën e shtetasve për jetë private, nuk mund të kërkojë mbrojtjen e interesave të këtyre subjekteve, duke ndërhyrë me çdo mjet, për ndalimin e të gjitha rasteve të përgjimit të mjeteve të komunikimit, apo të kontrollit të tij vetjak. Ajo mund të ketë për qëllim vetëm ndalimin e praktikave të paligjshme që e cënojnë në mënyrë të paligjshme të drejtën e shtetasit për një jetë private të qetë.

Për më tepër, ligji “Për organizatat jofitimprurëse”, përcakton qartë se *organizatat jofitimprurëse e bazojnë veprimtarinë e tyre në parimin e respektimit, të mbrojtjes dhe të zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj*. Kjo komizë ligjore kushtëzon mjaft veprimtarinë e organizatave, të cilat mund të krijohen

<sup>6</sup> Shih: Komentari “Ligjet për organizatat jofitimprurëse” Instituti i Studimeve Publike dhe ligjore, Tiranë, 2003, fq. 34-35

<sup>7</sup> Për më gjerë, shih: Komentari “Ligjet për organizatat jofitimprurëse” Instituti i Studimeve Publike dhe ligjore, Tiranë, 2003, fq. 29-31

vetëm për qëllime të ligjshme. Moszbatimi i saj sjell pasoja të rënda ligjore për vetë organizatën<sup>8</sup>.

Gjithashtu, nuk duhet të ngatërrohet qëllimi i ligjshëm i krijimit të organizatës me qëllimin e veprimtarisë të saj për të ndryshuar dhe përmirësuar ligjet. Kjo, sepse, veprimtaria e organizatave apo e shoqatave për të ndërmarrë nisma të reja ligjore është plotësisht kushtetuese dhe një veprimtari e ligjshme, gjë që do të thotë se organizatat e shoqatat i respektojnë dhe nuk i kundërvihen me mjete të paligjshme ligjit objekt ndryshimesh, sa kohë që ai është në fuqi.

### Rast për diskutim 1:

Qendra e pronarëve është krijuar në Tiranë këtë vit dhe midis të tjerave, ka objekt të veprimtarisë së saj “*....mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe ndalimin e të gjitha llojeve të shpronësimeve*”. Ajo ka paraqitur kërkesën dhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji në Gjykatën e Rrethit Tiranë, për t’u regjistruar në regjistrin përkatës.

Por, gjyqtari i vetëm e rrëzon këtë kërkesë me argumentin se objekti i veprimtarisë së shoqatës është i kundërligjshëm.

Përfaqësuesi i Qendrës i drejtohet Gjykatës së Apelit me ankim, duke ngritur pretendimin se nuk ka asnjë shkak antikushtetues nga ato që Kushtetuta ka parashikuar në nenin 9 të saj, ndërkohë që asnjë ligj nuk ka parashikuar shprehimisht shkaqe ligjore në lidhje me ligjshmërinë e objektit të veprimtarisë dhe qëllimit të organizatave ose të shoqatave.

#### DISKUTONI:

1. A është i drejtë qëndrimi i Gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së I-rë? Pse?
2. A është i drejtë ankimi?
3. A është kompetent gjyqtari të mos lejojë regjistrimin e një organizate të themeluar?
4. Çfarë pasojash ka ky mosregjistrim për organizatën?

<sup>8</sup>Po aty.



## 1. Çështje kushtetuese për regjistrimin e organizatave dhe të shoqatave

Në bazë të Kushtetutës, regjistrimi i organizatave ose i shoqatave bëhet në gjykatë, sipas procedurës të parashikuar me ligj. Pra, fakti se organizatat dhe shoqatat duhet të regjistrohen në Gjykatë domosdoshmërisht, buron nga vetë Kushtetuta<sup>9</sup>. Ky sanksionim ka një logjikë kushtetuese. Kushtetutvënësi, kur ka hartuar këtë dispozitë, ka pasur parasysh faktin se, regjistrimi në gjykatë, lidhet më mirë me garantimin e pavarësisë së organizatave dhe kontrollin e objektit të veprimtarisë së tyre. Ky i fundit paraqitet mjaft i lamishëm nga një organizatë në tjetrën. Verifikimi i ligjshmërisë së objektit të veprimtarisë i është lënë gjyqtarit si organ më i përshtatshëm për të kontrolluar atë dhe mekanizmat që do të përdorë organizata në lidhje me zbatimin e tij. Në këtë kuadër është mjaft i rëndësishëm edhe kontrolli i mekanizmave që do të përdoren në raportet me anëtarësinë, pasi duhet të garantohet respektimi i të drejtave dhe lirive të anëtarëve të saj dhe të personave të tjerë. Në këtë aspekt, ndërsa verifikimi i qëllimit të organizimeve të biznesit është më i thjeshtë dhe i unifikuar, për organizatat e shoqatat që nuk krijohen thjesht për qëllime biznesi, nevojitet një kontroll më i specializuar. Këtë e garanton gjykata, e cila luan vetëm rolin e regjistruesit pasi nuk mund të ndalojë një organizatë të krijuar në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Mjafton fakti që organizatat ose shoqatat të paraqesin përpara gjyqtarit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Gjykata nuk ka ndonjë diskrecion për të ndërhyrë në llojin e veprimtarisë së zgjedhur nga organizata apo në mënyrën e organizimit të përzgjedhur prej saj. Por, nuk duhet të mohohet aspekti kontrollues që ka instituti i regjistrimit në Gjykatë i organizatave, gjë që është sqaruar qartë edhe në Komentarin “Ligjet për organizatat jofitimprurëse”: *“...instituti i regjistrimit, krahas aspektit konstitutiv me rëndësi të padiskutueshme, ka për qëllim edhe mundësimin e një kontrolli sa më efikas të veprimtarisë së organizatave, në funksion të eliminimit të konflikteve të kësaj veprimtarie me rendin publik”*<sup>10</sup>.

<sup>9</sup> Neni 46/2 i Kushtetutës: “Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj”.

<sup>10</sup> Komentar “Ligjet për organizatat jofitimprurëse” Instituti i Studimeve Publike dhe ligjore, Tiranë, 2003, fq. 32

Regjistrimi në Gjykatë i OJF-ve lidhet drejtpërdrejt me personalitetin e tyre juridik. Konkretisht, organizata jofitimprurëse njihet si person juridik ditën që vendimi i gjykatës për regjistrimin e saj, ka marrë formë të prerë.

Pra, çështja e regjistrimit të organizatave ose shoqatave në Gjykatë është një çështje kushtetuese, prandaj nuk mund të ndryshohet përmes ligjit. Ajo mund të vendoset vetëm përmes amendamenteve kushtetuese.

■ **Rast për diskutim 2:**

Projektligji “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”, iu paraqit Kuvendit për miratim, me iniciativën e Këshillit të Ministrave. Ky projektligj krijon “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si institucion publik qendror në varësi të ministrit që mbulon çështjet e tregtisë, e cila do të ishte organi kompetent për mbajtjen e regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të OJF-ve. Kjo qendër kishte detyrimin të kryente regjistrimet përkatëse. Gjatë shqyrtimit nga Këshilli i Ministrave, një sërë organizatash jofitimprurëse iu drejtuan me letër të hapur Kuvendit, duke kërkuar që disa dispozita të këtij projektligji që parashikonin procedurën e regjistrimit të OJF-ve pranë Qendrës Kombëtare, procedurat për të dhënë raporte periodike pranë ministrit kompetent nga OJF-të, si dhe procedurat për mbajtjen e regjistrimit të OJF-ve nga kjo Qendër, vinin në kundërshtim me Kushtetutën. Gjithashtu, letra theksonte se nëse nuk do të mbahej parasysh ky fakt, organizatat do t’i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese, sapo ligji të hynte në fuqi.

**Pyetje:**

1. A është i drejtë kundërshtimi i organizatave në lidhje me dispozitat e ligjit që rregullojnë regjistrimin e OJF-ve? Pse?
2. A kanë mundësi ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese këto organizata, nëse projektligji do të miratohej pa u marrë parasysh ndryshimet e kërkuara prej tyre?
3. Përse organizatat nuk mund t’i drejtoheshin menjëherë Gjykatës Kushtetuese?
4. Sipas mendimit tuaj, çfarë do të vendoste Gjykata Kushtetuese?

### 3. Instrumentet juridiko-kushtetuese për mbrojtjen e interesave të organizatave e të shoqatave

Kushtetuta ka njohur disa garanci procedurale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të cilat shërbejnë edhe për mbrojtjen e interesave dhe qëllimeve të organizatave e shoqatave. Këto garanci janë parashikuar në Kushtetutë, jo vetëm në dimensionin kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar. Përveç Avokatit të Popullit dhe sistemit tri-shkallësh të gjykatave të zakonshme, është Gjykata Kushtetuese ajo që bën gjykimin përfundimtar të kërkesave të individëve, kur është fjala për cënimin e të drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor (neni 131/f, 134/1/ë). Organizatat mund ta vënë në lëvizje këtë Gjykatë me kërkesë, për çështje që lidhen me interesat e tyre<sup>11</sup>. Në këtë kuadër, garancitë që ofrohen nga gjykata në përgjithësi dhe nga Gjykata Kushtetuese në veçanti, janë shumë të rëndësishme në përmbushjen e objektit të veprimtarisë së organizatave apo shoqatave.

***Organizatrat janë një nga subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese***, jo vetëm për çështjet individuale të organizatës, por edhe për një kontroll abstrakt të normës juridike, për çështje që lidhen me interesat e tyre. Pyetja që shtrohet është: çfarë do të kuptojmë me interesat e tyre?

<sup>11</sup> Në nenin 134 të Kushtetutës sanksionohet:

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

- a) Presidentit të Republikës;
- b) Kryeministrit;
- c) jo më pak se një së pestës së deputetëve;
- ç) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- d) çdo gjykate sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;
- dh) Avokatit të Popullit;
- e) organeve të qeverisjes vendore;
- ë) organeve të bashkësive fetare;
- f) partive politike dhe organizatave të tjera;
- g) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët dh, e, ë, f dhe g të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

Në rastin kur interesi i tyre nuk konceptohet si një interes fare i ngushtë i lidhur vetëm me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të organizatës, ato mund të shndërrohen në avokate të vërteta të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tyre. Kështu, organizatat mund të përfaqësojnë në Gjykatën Kushtetuese, interesat e qytetarëve dhe të komunitetit. Praktika e Gjykatës Kushtetuese shqiptare e ka lejuar këtë, përmes legjitimitit të organizatave kur ato e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, jo thjesht për interesat e tyre të ngushta, por edhe për interesa publike, madje edhe për interesa të tretëve, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut dhe të vetë Kushtetutës.

#### **Përvoja dhe raste të vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese nga OJF**

Nga dy organizata jofitimprurëse, Komiteti Shqiptar të Helsinkit dhe Grupi Shqiptar të të Drejtave të Njeriut, si dhe nga Avokati i Popullit, është paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kërkesa me objekt: *Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve të KM, nr.43, dt. 27.01.06 "Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike"*, etj. Gjykata e ka konsideruar legjitime kërkesën që i është drejtuar asaj nga disa organizata shqiptare me objekt shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave, gjatë vitit 2006, për shkak se këto vendime kanë kufizuar pa ligj të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë<sup>12</sup>.

Qëndrim të ngjashëm ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në rastet kur shoqata apo organizata të tjera shqiptare kanë vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të goditur si antikushtetues artikuj të veçantë të ligjeve të ndryshme. Edhe pse shpesh, ligjet që janë bërë objekt shqyrtimi kanë pasur të bëjnë me fushën dhe objektin e veprimtarisë së shoqatave dhe jo drejtpërdrejt me interesat e ngushta të veprimtarisë së tyre, Gjykata Kushtetuese i ka legjitimuar ato si subjekte kërkuuese në gjykim, për një

<sup>12</sup> Shih: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, dt. 11.07.2006.

kontroll abstrakt mbi ligjet. Ky fakt, mund të shndërrohet më shumë, në një mjet të fuqishëm në duart e organizatave për realizimin e veprimtarisë së tyre në mbrojtje të Kushtetutës dhe të të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut. Megjithatë, krahasuar me numrin e madh të organizatave dhe të shoqatave që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare, duhet pranuar se ky mjet kushtetues është përdorur rrallë prej tyre.

### **Studim i shkurtër mbi vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese nga organizatat**

Gjatë vitit 2005, nga 256 vendime të dhëna gjithsej në Gjykatën Kushtetuese, vetëm 5 prej tyre janë dhënë mbi bazën e vënies në lëvizje të Gjykatës nga Partitë politike dhe organizatat; vetëm dy prej vendimeve janë dhënë mbi bazën e kërkesave të "Shoqatës së qiramarrësve në shtëpitë shtetërore ish-pronë private" dhe Shoqatës Kombëtare të të shpronësuarve "Pronësi me drejtësi". Tri rastet e tjera janë vënë në lëvizje nga Partitë Politike.

Gjatë vitit 2006, nga 251 vendime të dhëna gjithsej nga Gjykata Kushtetuese, vetëm tre prej tyre janë dhënë mbi bazën e inicimit nga Partitë politike dhe organizatat e tjera. Prej tyre, një çështje është iniciuar nga dy shoqata për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut si kontroll abstrakt i normës, kurse tjetra është iniciuar në kuadrin e kontrollit konkret nga një organizatë; e treta është iniciuar nga njëra prej partive politike.

### **Rasti për diskutim 3:**

"Organizata A versus Ligji Zeta"

Organizata A, një OJF shqiptare ka paraqitur pranë Gjykatës Kushtetuese një kërkesë, përmes së cilës i kërkon asaj të shpallë antikushtetues dy nene të ligjit Zeta, pasi ato vijnë në kundërshtim me nenin 22 të Kushtetutës, pra me lirinë e shprehjes. Kërkesa është adresuar pranë kësaj gjykate e firmosur nga Drejtori Ekzekutiv i organizatës. Por, sapo filloi shqyrtimi pranë Gjykatës

Kushtetuese, çështja u bë e njohur në media dhe një grup OJF-sh të tjera reagues, duke kritikuar kërkesën e A-së. Si rezultat, dy prej anëtarëve të Asamblesë së organizatës A, kërkuan mbledhje të jashtëzakonshme të saj dhe parashtruan kërkesat e tyre si më poshtë:

1. Të tërhiqet kërkesa nga Gjykata Kushtetuese.
2. Të shkarkohet Drejtori Ekzekutiv i organizatës, pasi nuk ka marrë mendimin e Asamblesë për paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Asambleja u mbledh dhe vendosi të mos e tërheqë kërkesën për shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Pezulloi nga detyra Drejtorin Ekzekutiv deri në shpalljen e vendimit nga kjo Gjykatë.

**Pyetje:**

1. Gjeni statusin e organizatës A?
2. A ka vepruar drejt Drejtori Ekzekutiv i organizatës?
3. A duhet të mblidhej asambleja në këtë rast?
4. A janë të drejta vendimet e Asamblesë? Si paraqitet dobia e tyre në raport me punën e organizatës?

Diskutoni rreth këtyre pyetjeve duke mbajtur parasysh statutin e organizatës suaj.

Në procesin gjyqësor të zakonshëm është e vështirë që një organizatë të ndërhyjë pa prokurë. Kjo mund të ndodhë vetëm në rastin kur një subjekt palë në proces, i jep organizatës të drejtën që ta përfaqësojë atë. Në fakt, gjithmonë e më tepër po shtrohet nevoja e parashikimeve ligjore që do ta legjitimonin një organizatë për ndërhyrje si palë e tretë në gjykim, ose për vënien në lëvizje të gjykimit. Vetëm në këtë mënyrë, ajo mund të shndërrohet në një avokate të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive dhe të synojë mbrojtjen e të drejtave që kanë rëndësi jo vetëm për personin palë, por edhe për publikun në tërësi. Parashikimi, së paku në raste të veçanta, i organizatave ose shoqatave që mund të ndërhyjnë si palë e tretë në gjykim, ndihmon në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të viktimave të trafikimit, të viktimave të dhunës në familje, apo të viktimave të diskriminimit për shkaqe të ndryshme.

Një rëndësi të veçantë marrin edhe garancitë ndërkombëtare, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Garancitë ndërkombëtare mund të përfshijnë jo vetëm Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjë që buron drejtpërdrejt nga Kushtetuta, por edhe Komitetet e ndryshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara nga konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është pjesë. Një sërë aktesh ndërkombëtare kanë krijuar Komitete me kompetenca për të shqyrtuar ankesa të paraqitura nga qytetarë ose grupe të qytetarëve nga shtetet anëtare. Këto janë mjete dhe instrumente shumë të rëndësishme që mund të përdoren nga organizatat për të arritur qëllimet e veprimtarisë së tyre. Sidoqoftë, në të dyja rastet mbetet disi e paqartë pozita procedurale e organizatave apo shoqatave për të ndërhyrë në këto procese. Ndoshta është e vështirë që ato të ndërhyjnë në çdo rast që kanë interes, pasi nuk e gëzojnë statusin e palës së tretë, por mund të shfrytëzojnë vullnetin e palëve për t'i lejuar ato që t'i përfaqësojnë në këto instanca ndërkombëtare. Gjithashtu, ato mund të argumentojnë përpara këtyre instancave interesin ligjor që çështja paraqet për objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së tyre, të pasqyruar në Statutin e organizatës. Sidoqoftë, deri më sot nuk kemi ndërhyrje pranë mjeteve të tilla nga ndonjë organizatë shqiptare.

#### Rast për diskutim 4:

##### **OJF-të versus Këshillit të Bashkisë**

Një grup organizatash jofitimprurëse, në emër të një grupi qytetarësh, kanë paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Shkallës së I-rë, Tiranë, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit Nr. 10, të Këshillit Bashkiak, përmes të cilit vendoset që, të mos shërbehet asnjë qytetar me certifikata, sa kohë që nuk ka paguar taksat vendore.

OJF-të kanë arsyetuar kërkesën e tyre me faktin se, në kuadër të zbatimit të këtij vendimi kanë mbetur pa shkollë qindra fëmijë, pasi prindërit nuk janë pajisur me certifikatat e tyre të lindjes. Kështu, sipas tyre është shkelur e drejta për t'u arsimuar, si e drejtë themelore e parashikuar në Kushtetutë. Kjo, edhe për faktin se fëmijët nuk janë subjekte që duhet të paguajnë taksë, kështu ata vetë nuk kanë asnjë detyrim për të paguar, prandaj duhet të pajisen

me certifikatë. Për më tepër, organizatat argumentuan se nuk është kjo mënyra ligjore për të mbledhur taksat e tatimet.

Por, përfaqësuesit e Bashkisë prapësuan këto argumente përpara Gjykatës, duke theksuar se ata nuk mund të kryenin shërbime për qytetarët, nëse këta të fundit nuk paguanin taksat përkatëse, për të cilat ka detyrim të qartë ligjor. Sipas tyre, pagimi i taksave është një detyrë e rëndësishme qytetare.

**Diskutoni:**

1. A kanë vepruar drejt organizatat?
2. A mund t'i drejtoheshin ato Gjykatës drejtpërdrejt në këtë rast?
3. Çfarë duhet të vendosë Gjykata në lidhje me vendimin e Këshillit të Bashkisë?
4. A jemi përpara shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore?





## BIBLIOGRAFIA

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2008

Ligji nr. 8788, dt. 7.5.2001, "Për organizatat jofitimprurëse"

Ligji nr. 8789, dt. 7.5.2001, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"

Instituti për Studime Publike dhe Ligjore, (2003), "Ligjet për organizatat jofitimprurëse", Komentar, Tiranë.

Omari, L. & Anastasi, A. (2008), "E drejta Kushtetuese", Shtëpia Botuese ABC, Tiranë.

### Rreth autores...

**Aurela Anastasi** është pedagoge e të Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ka kryer dhe vazhdon të kryejë disa detyra të rëndësishme shtetërore dhe shoqërore. Ka qenë Zv. Dekane në Fakultetin e Drejtësisë, UT dhe Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike, pranë këtij Fakulteti. Aktualisht, drejton "Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare", një OJF shqiptare. Është autore e disa punimeve, si monografi, tekste mësimore, si dhe artikujve studimorë e shkencorë të botuara brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, është drejtore e revistës "Ligji - mundësi zhvillimi për gratë", revistë për profesionistët e sistemit të drejtësisë.

# TRANSPARENCA ME JASHTË E OJF-VE DHE PRAKTIKA TË MIRA

*Dr. Eglantina Gjermeni*

*Ma. Irena Shtraza*

## Rëndësia e transparencës me jashtë

Është e rëndësishme të kuptohet roli unik dhe i rëndësishëm që kanë organizatat jofitimprurëse në ditët e sotme. Rreth 15 vjet më parë, OJF-të ishin aktore dytësore në botën e politikës, krijimit të politikave publike dhe të opinionit publik. Tashmë, ato luajnë një rol primar në tavolinat ndërmjetësuese, duke influencuar dhe duke i dhënë formë mendimeve dhe qëllimeve të individëve, grupimeve të ndryshme, apo shoqërisë në tërësi, sikurse janë institucionet që kanë më shumë ndikim në krijimin e opinionit publik. Roli, ndikimi dhe autoriteti i organizatave jofitimprurëse është rritur fuqishëm dhe ato renditen në një nivel me bizneset, për sa i përket sigurisë së shërbimeve që ato ofrojnë.

Transparenca e sektorit jofitimprurës është më shumë një proces, sesa një produkt dhe është e lidhur drejtpërdrejt me fuqizimin e këtij sektori. Kur flasim për transparencën me jashtë të organizatave jofitimprurëse, na vjen spontane të bëjmë disa pyetje. A kanë akses aktorët kryesorë në informacionin e përditësuar që ka të bëjë me organizatën, punën e saj, arritjet e saj, planet e saj të veprimit, etj? A kanë akses donatorët në raportet konçize financiare rreth përdorimit të granteve të dhëna prej tyre? A u jepet përfituesve të shërbimeve që ofron OJF-ja informacioni i nevojshëm rreth veprimitarisë së organizatës dhe përdorimit të fondeve nga organizata? A i komunikohet mbështetësve dhe bashkëpunëtorëve të organizatës se cilat janë veprimtaritë e reja në të cilat ajo angazhohet dhe me cilët partnerë të rinj bashkëpunon ajo?

Pyetjet që lindin janë nga më të shumtat...Në rast se përgjigjet janë negative, organizata duhet të rishikojë dhe riorganizojë praktikën që kërkon *transparenca e organizatës me jashtë*, që e thënë në terma të tjerë është ‘*marrëdhënia e organizatës me publikun*’. Të jesh transparent do të thotë shumë më shumë se të zbatosh rregullat për publikimin e një raporti vjetor apo përgatitja e raporteve financiare. Do të thotë të ndërtohet ura komunikimi me aktorët kryesorë duke u dhënë informacionin që u nevojitet dhe duke ju përgjigjur nevojave të tyre për informim.

“Marrëdhëniet me publikun janë një përpjekje e pandërprerë, e matur dhe e mirë-planifikuar për të krijuar dhe ruajtur një mirëkuptim dhe bashkëpunim të dyanshëm midis një organizate dhe publikut.”

(*British Institute of Public Opinion*)

Por pse duhet që organizatat jofitimprurëse të krijojnë marrëdhënie me publikun, për të dhënë më shumë informacion sesa kërkohet ligjërisht prej tyre? Në terma të përgjithshëm, marrëdhëniet me publikun ndihmojnë shoqërinë që të marrë vendime dhe të funksionojë në mënyrë më efektive, duke kontribuar në mirëkuptimin e dyanshëm midis grupeve dhe institucioneve. Ato janë në shërbim të harmonizimit të politikave publike dhe private të shoqërisë.

Transparenca e organizatave jofitimprurëse me publikun duke krijuar ura komunikimi me të, është një nevojë e pazëvendësueshme pasi OJF-të administrojnë burime financiare që nuk janë të tyret, gjë që indirekt i jep atyre një karakter publik megjithëse janë institucione private. Marrëdhëniet e mira me publikun, arrijnë të përkthejnë qëllimet e veprimtarisë së tyre në politika dhe veprimtari gjerësisht të pranueshme, të cilat sigurojnë mirëkuptim brenda organizatës dhe midis organizatës dhe ambientit të jashtëm. Rritja e rendimentit të organizatës, është një aspekt tjetër që ndikohet fuqishëm nga transparenca e duhur me jashtë, pasi të qenit transparentë, hap rrugë të reja komunikimi dhe bashkëpunimi me aktorët kyç, rrit besimin dhe përmirëson impaktin e punës së organizatës.

Roli i fuqizuar i organizatave jofitimprurëse kërkon që të jepet sa më shumë informacion rreth tyre dhe punës që ato bëjnë, sepse ato janë aktore të fuqishme në shoqërinë e një vendi dhe kanë nevojë që besueshmëria dhe legjitimiteti i tyre të mos vihet në dyshim nga publiku i gjerë. Një transparencë e lartë me jashtë, do i fuqizonte më shumë këto organizata, të cilat nuk mund të mbijetojnë gjatë pa besueshmërinë e pritur prej tyre. Mungesa e besueshmërisë të një OJF-je mund të kthehet në një armë të shkatërrimit masiv të reputacionit të OJF-ve, pasi shumë shpesh publiku nuk arrin të bëjë dallimin e duhur midis tyre. Efekti Domino nuk është specifik vetëm për sektorin jofitimprurës, por i aplikohet dhe fushave të tjera administrative. Sidoqoftë, OJF-të preken më fuqishëm nga ky efekt për arsye që përmendëm pak më lart: administrimi i burimeve që janë publike; dhe ndjeshmëria e lartë rreth përdorimit të tyre. Për këtë arsye, aksesit në informacionin që ka lidhje me organizatat, mbetet një mburojë e mirë për organizatat me përgjegjësi shoqërore dhe nivel besueshmërie të lartë.

Për të ngritur themele të forta të transparencës me jashtë, organizatat jofitimprurëse kanë nevojë për planifikime strategjike efektive për administrimin e marrëdhënieve me publikun për arsye të shumta, si: *të ngrenë fonde; të informojnë përfituesit rreth shërbimeve që ato afrojnë; të informojnë publikun e gjerë rreth arritjeve të tyre; të ndërgjegjësojnë të tërë publikun apo grupe të caktuara në lidhje me probleme të ndryshme sociale, politike apo ekonomike në të cilat organizata është e angazhuar; etj.*

Rrugët e transparencës që duhet të ndërmerren, duhen përshtatur me kujdes me nevojat specifike të organizatës, duke marrë në konsideratë misionin e saj, sektorin në të cilin ajo punon dhe kontekstin në të cilin ushtron aktivitetet e saj. Për shembull, një organizatë që strehon në fshehtësi gra dhe vajza të trafikuar, nuk mund të jetë krejtësisht transparente rreth adresës së saj dhe personelit që është i aktivizuar në veprimtaritë e saj, pasi një pakujdesi e tillë mund të verë në rrezik sigurinë e përfitueseve të këtij shërbimi dhe personelit të organizatës. Prandaj, duhet specifikuar që nuk ekzistojnë strategji fikse. Secila organizatë e përgatit dhe përshtat strategjinë e saj të komunikimit me jashtë, sipas misionit, kërkesave dhe llojit të aktivitetit që ajo ushtron.

## Krijimi i një strategjie të suksesshme për marrëdhëniet me jashtë

Edward Bernays, një nga pionierët e marrëdhënieve me publikun, i ka përkufizuar marrëdhëniet me publikun si *'arti i menaxhimit të komunikimit midis një organizate dhe anëtarëve të saj publikë më të rëndësishëm, për të ndërtuar dhe ruajtur një imazh pozitiv.'* Pra me pak fjalë, marrëdhëniet me publikun janë ndërtimi i marrëdhënieve me jashtë dhe ruajtja e reputacionit të fituar. Në mënyrë që një OJF të ndërtojë marrëdhënie të shëndetshme me jashtë, duhet të përgatisë një **plan komunikimi** të mirëorganizuar, që do t'i japë trajtë përpjekjeve të saj për të qenë sa më transparente dhe e besueshme.

Një plan i suksesshëm komunikimi duhet të fokusohet në disa linja kryesore, që janë;

### - Identifikimi i objektivave të planit të komunikimit

Të identifikosh objektivat e planit të komunikimit do të thotë të qartësosh qëllimin pse duam që ta krijojmë këtë plan komunikimi. Për shembull, mund të duam të ndërgjegjësojmë opinionin publik rreth masave që parashtrojnë ligji i ri për dhunën në familje, apo mund të duam të ngremë fonde për financimin e një projekti për strehimin e të pastrehëve. Objektivat janë vendimtare për hartimin e një strategjie të mirëfilltë komunikimi dhe duhet të tregohet shumë kujdes në formulimin e objektivave të realizueshme dhe të matshme, që mund të arrihen brenda një linje kohore të parapërcaktuar.

### - Identifikimi i grupit të interesit me të cilin duam të komunikojmë

Grupi me të cilin duhet të komunikohet mund të jetë publiku i gjerë, grupmosha të ndryshme, grupe të caktuara interesi, aktorët e interesuar në punën që bën organizata (politikë-bërës, partnerë kryesorë, OJF të tjera, donatorë). Duke adresuar saktë grupin të cilit i drejtohet mesazhi, bëhet e mundur dhe hartimi i një mënyre të përshtatshme për përcjelljen e tij, pasi rrugët e komunikimit për të arritur audiencën të ndryshme, nuk mund të jenë të njëjta.

### - Identifikimi i mesazheve kryesore që duam të përcjellim

Është shumë e rëndësishme që të kemi të qartë se çfarë mesazhesh duam të komunikojmë, që në fillimin e hartimit të një plani komunikimi.

*- Identifikimi i rrugëve të komunikimit që duam të përdorim*

Për ta vënë në jetë planin e komunikimit, duhen identifikuar rrugët që mendohet të përdoren. Mund të përgatiten materiale të shtypura si postera apo broshura, mund të lëshohet një deklaratë për shtyp në media, mund të organizohet një tryezë e rumbullakët, etj. Në qoftë se do përdoret media, duhet vendosur se cila gazetë, radio apo televizion, cili program televiziv apo radiofonik, do përdoret për të përcjellë mesazhin.

*- Planifikimi i një buxheti të mjaftueshëm për realizimin e planit të komunikimit*

Shpesh të përcjellësh mesazhe me anë të mediave, të shkruara apo elektronike, nuk kërkon shpenzime nga ana e organizatës. Sidoqoftë, komunikimet me anë të materialeve të shtypura, mund të kërkojnë një buxhet të caktuar. Shumë organizata jofitimprurëse kanë buxhet të kufizuar dhe hasin vështirësi në përballimin e shpenzimeve për qëllime komunikimi me publikun. Për këtë arsye, një zë të rëndësishëm në hartimin e një plani komunikimi, zë planifikimi i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e tij.

*- Identifikimi i personit që do të përfaqësojë organizatën*

Shpesh ndodh që organizata të përfaqësohet në takimet me median nga personi me vjetërsi më të madhe pune brenda saj. Gjatë hartimit të planit të komunikimit, duhet të tregohet kujdes në caktimin e një individi që është një komunikator/e i/e përgatitur dhe me shumë njohuri rreth temës/mesazhit që do të transmetohet nëpërmjet tij/saj. Do të ishte me vend parapërgatitja e disa pyetjeve dhe përgjigjeve të mundshme që mund të bëhen nga gazetarët, në mënyrë që të evitohen të papriturat.

*- Zgjidhje e problemeve të mundshme*

Kur përgatitet një plan komunikimi, duhet patjetër që të mendohen edhe rrugëdaljet në rast se ndodhin të papritura që prishin këtë plan. Duhet që organizata të përgatitet për përballimin e vështirësive të mundshme që mund të dalin për shembull gjatë një fushate, nëse një pjesëtar i stafit akuzohet për diçka, etj.

*- Vlerësimi i planit të komunikimit*

Pasi plani është vënë në zbatim dhe ka përfunduar, duhet të rezervohet pak



kohë për vlerësimin e tij, për të parë cilat ishin pikat e forta dhe dobësitë, për të matur impaktin që arriti të ketë plani i komunikimit, etj. Një vlerësim objektiv mundëson arritjen e rezultateve akoma më të mira në komunikimet e ardhshme me publikun.

## RRUGËT E KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN

Një nga rrugët më të përdorura për komunikimin me publikun, është **Media e Shkruar dhe Elektronike**. Përdorimi i medias të shkruar dhe elektronike për reklamimin e fushatave tematike apo aktiviteteve të tjera të rëndësishme, mund të jetë një mënyrë ekonomike dhe efektive për formimin e një ure komunikimi me publikun e gjerë.

Përmes medias, OJF-të komunikojnë me grupet e interesit, anëtarët, mbështetësit, klientët, qeverinë dhe njerëzit e tjerë me ndikim në punën e tyre. Në të njëjtën kohë, *media përfaqëson forume publike të vetme në llojin e tyre*, pasi ato ofrojnë hapësirë dhe kohë për debate publike dhe përballje të këndvështrimeve dhe politikave të ndryshme.

Përfaqësuesit e medias, gazetarët, botuesit, redaktorët janë opinionbërës me influencë pasi ata shprehin pozicionin e tyre lidhur me çështjet e ndryshme të ngritura nga OJF-të. (MCIC, 2007). Ndaj, kur flasim për rëndësinë që media ka për OJF-të, fillimisht duhet ta konsiderojmë median si një kanal kryesor informimi dhe komunikimi, si një forum publik i rëndësishëm së veçantë, si një aktor social shumë i rëndësishëm, si dhe partnere dhe aleate të mundshme.

Marrëdhëniet me median forcohen përmes proceseve afatgjata, të cilat konsistojnë në shkëmbime mesazhesh dhe lajmesh, bashkëpunim të vazhdueshëm profesional, ndjekje të qëllimeve dhe interesave të përbashkëta, dhe respektim të “rregullave të lojës”. OJF-të dhe mediat e ndërtojnë partneritetin e tyre mbi bazën e besueshmërisë, mirëkuptimit, përvojës pozitive, dhe gjithashtu mbi besimet, vlerat, vizionin dhe kulturën e përbashkët (MCIC, 2007).

Mënyra më e zakonshme për të inkurajuar mediat që të shkruajnë për Organizatën dhe Aktivitetin që do të organizohet, është dërgimi i një *Njoftimi ose Deklarate për Shtyp* që i informon mediat rreth aktivitetit që OJF-ja do të zhvillojë, rreth qëndrimit që ajo mban rreth një çështjeje të caktuar, rreth rezultateve të një projekti të caktuar, etj. Sigurisht që mediat që mund të

kontaktohen janë të shumta, por të shumta janë edhe organizatat që duan të zënë vend në reportazhet e tyre. Për këtë arsye, është e rëndësishme që informacioni që komunikojmë të jetë interesant dhe i denjë për t'u konsideruar një lajm i rëndësishëm. Një njoftim apo deklaratë për shtyp e formuluar me tonet e duhura, afron mediat rreth organizatës dhe i siguron aktivitetit publicitetin që i nevojitet. Një taktikë shumë efikase është edhe eksplorimi i tregut mediatik për të zbuluar se cilët gazetarë mbulojnë lajme të llojit që duam të shpërndajmë. Pasi të identifikohen gazetarët e duhur, lajmërimi i tyre paraprakisht rreth njoftimit apo deklaratës tonë për shtyp, do të ishte një hap i kujdesshëm dhe efikas. Gjithashtu është e rëndësishme që pas dërgimit të njoftimit apo deklaratës për shtyp, të kontaktohen sërish gazetarët për të konfirmuar nëse e morën lajmin dhe nëse e kanë kuptuar atë siç duhet. Përkrah gjithë kësaj pune, gatishmëria për të dhënë informacione të mëtejshme nëse kërkohen, finalizon përpjekjet për të përçuar siç duhet lajmin tonë.

*Njoftimet për Shtyp* - Me anë të një njoftimi për shtyp të shkurtër, të thjeshtë dhe të përmbledhur, organizata mund t'i ofrojë lajmin e ri në mënyrë shumë të shpejtë, një numri të madh mediash. Njoftimi i shkruar me kujdes në vetën e tretë dhe që fillon me lajmin kryesor, të ndjekur nga informacione të tjera të rëndësishme, duhet të mbarojë me një publicitet për organizatën që e nxjerr njoftimin dhe nuk duhet të zgjasë më shumë se 40 sekonda.

## PRAKTIKA TË MIRA

### ■ ■ Njoftim për Shtyp

Të ndihmojmë qeverisjen vendore për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik 25 shkurt 2008 Durrës. Projekti "Aksioni Transnacional kundër Trafikimit të Fëmijëve" (TACT), zhvilloi një ceremoni në Durrës për të prezantuar fillimin e seksionit të ri të mbrojtjes së fëmijëve në këtë bashki. Kjo u bë e mundur nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit midis Terre des Hommes dhe Bashkisë së Durrësit. Në këtë ceremoni morën pjesë kryetari i bashkisë së Durrësit, z.Vangjush Dako, Drejtoresha e Ndihmës dhe e Përkujdesit Shoqëror, Znj. Meme Xhaferri, si dhe përfaqësues së donatorëve të projektit TACT III, si p.sh: USAID, UNICEF, Ambasada Norvegjeze, Hellenic Aid, si





dhe Agjencia e Zhvillimit Austriak, etj. Gjithashtu, morën pjesë edhe partnerë të projektit TACT.

Seksioni për Mbrojtjen e Fëmijëve (SMDF) do të jetë një strukturë e përhershme në bashkitë ku punon TACT-i, si në: Korçë, Pogradec, Elbasan, Fier, Gjirokastrë dhe tashmë edhe në Durrës. SMDF-ja do të analizojë dhe do të monitorojë gjendjen ekonomike dhe sociale të fëmijëve dhe të familjeve vulnerabël; do të ofrojë shërbime mbrojtëse dhe do të kryejë aktivitete në koordinim me aktorët vendorë dhe rajonalë. Me anë të SMDF-ve të mësipërme, do të funksionojë një rrjet aktorësh shumë disiplinuar që ofrojnë shërbime sociale në nivel bashkiak me qëllim përmirësimin e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

#### **Shënim:**

*Projekti TACT III është një përpjekje e përbashkët e Terre des hommes (Tdh - Lozanë), Arsis (Greqi), i financuar nga USAID-i, Agjencia e Zhvillimit Austriak, Hellenic Aid, Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, UNICEF dhe Fondacioni OAK. Ky projekt punon në partneritet me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Qëllimi i TACT III është fuqizimi i rolit të shqiptarëve në krijimin dhe në mirëmbajtjen e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel kombëtar dhe komunitar të nevojshme për shmangien e fenomenit të trafikimit të fëmijëve.*

**Deklaratat për Shtyp** - Siç përmendëm më lart, edhe deklaratat për shtyp luajnë një rol shumë të rëndësishëm në komunikimin me jashtë, atëherë kur duhet të shprehet një qëndrim i caktuar në lidhje me një situatë apo ngjarje. Deklarata, jo më e gjatë se një faqe, e pajisur me një titull energjik dhe domethënës dhe e shkruar me gjuhë të personalizuar, të thjeshtë dhe të kuptueshme, duhet të përfshijë fakte dhe informacion mbështetës rreth qëndrimit që mban organizata. Me fjali të shkurtra dhe të qarta, në fillim të deklaratës për shtyp, i duhet dhënë përgjigje 5 pyetjeve bazë: *kush, ku, kur, çfarë, dhe pse*. Në qoftë se i përgjigjemi këtyre pyetjeve, informacioni më kryesor është përfshirë në deklaratën tonë për shtyp. Është gjithashtu e rëndësishme që në fund të deklaratës të vendosen kontaktet për ata që duan informacion më të zgjeruar apo intervistë.

■ PRAKTIKA TË MIRA

**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë**

**Prezenca në Shqipëri**

Public Affairs and Media Office

**Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe e Medias**

**DEKLARATË PËR SHTYP**

Prezenca e OSBE-së nxit miratimin e projektligjit shqiptar për barazinë gjinore TIRANË, 7 mars 2008 – Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Robert Bosch, tha sot se shpreson shumë që projektligji për Barazinë Gjinore në Shqipëri, paraqitur së fundi Kuvendit shqiptar për rishikim, do të miratohet së shpejti.

“Ky projektligj përmban shumë veçori të reja, si emërimin e Nëpunësve për Barazinë Gjinore në të gjitha nivelet e administratës, si dhe futjen e kuotave në organet vendimmarrëse,” tha ai.

Kjo deklaratë u bë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, më 8 mars.

“Gjithashtu, unë jam veçanërisht i gëzuar që mund të them se këto ndryshime të reja janë rezultat i një bashkëpunimi prej mëse dy vjetësh midis Drejtorisë për Mundësi të Barabarta të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, PNUD-it, UNFPA-së, UNIFEM-it dhe Prezencës së OSBE-së.”

Ambasadori Bosch tha se gjatë procesit të reformës aktuale zgjedhore, ka qenë e rëndësishme rritja e ndërgjegjësimit mes vendimmarrësve mbi nevojën e marrjes së masave të posaçme që do të promovonin dhe do të mbronin pjesëmarrjen e grave në zgjedhje.

Duke përmendur faktin se Prezenca, së bashku me UNIFEM-in dhe Këshillin e Evropës, kanë mbështetur së fundi disa projekte për të ndihmuar pjesëmarrjen e grave në proceset

zgjedhore, ai i inkurajoi gjithë parlamentarët që të bëjnë më të mirën për t’u ofruar grave garancitë e mjaftueshme për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tyre afatgjatë në politikë dhe jetën publike.

Prezenca e OSBE-së mbetet e gatshme që së bashku me partnerët e saj vendas dhe ndërkombëtarë, të ofrojë asistencë të mëtejshme teknike në hartimin e akteve nënligjore në funksion të zbatimit të plotë të ligjit për Barazinë Gjinore në Shqipëri.

Për më shumë informacion, kontaktoni **Zyrën e Prezencës së OSBE-së për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median**, Sheraton Tirana Hotel & Towers, 1st Floor, Sheshi "Italia", Tirana, Albania, Tel: +355 4 235 993, fax: +355 4 244 204, e-mail: pamo-al@osce.org, website: [www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)

**Konferencat për Shtyp** – Konferencat për shtyp janë një mënyrë tjetër shumë efikase për komunikimin me jashtë dhe kanë sërish median si element kryesor. Konferencat për shtyp kërkojnë organizim dhe mbahen vetëm për ngjarje, lajmërimi dhe njoftime të rëndësishme, që janë komplekse dhe kanë nevojë për dialog për t'u qartësuar. Është shumë e rëndësishme që konferencat për shtyp të mbahen atëherë kur ka vërtet lajm, pasi përndryshe dëmtohet besueshmëria e organizatës. Një ose dy folësit/et e përzgjedhur/a me kujdes, të cilët/at do të përfaqësojnë organizatën në konferencë, duhet të përgatisin një ose dy fjalime të shkurtra (maksimumi 8 minuta secili), që më pas do të pasohen nga pyetjet e gazetarëve, të cilave folësit/et duhet të jenë të gatshëm t'i përgjigjen në çdo moment. Kohëzgjatja ideale e një konference është 45 minuta dhe koha ideale për organizimin e saj janë paraditet e ditëve të marta, të mërkura dhe të enjte. Duhet pasur kujdes që shtypit (edhe atyre që nuk morën pjesë) t'i shpërndahen dosje që përmbajnë: njoftimin për shtyp, listat e fakteve, informacion kontekstual, citime, foto, grafikë, etj.

#### **- Përfshirja e personazheve publikë**

Një lëvizje shumë e zgjuar kur duam të reklamojmë fushata të rëndësishme, është përfshirja e personazheve publikë në fushatën që do ndërmerret nga organizata. Aktivizimi i një personazhi publik në fushatë, arrin të maksimizojë efektin publicistik, por në të njëjtën kohë ngelet një lëvizje e vështirë për t'u realizuar, pasi personazhet publikë janë të bombarduar me oferta të këtij lloji. Fama e personazheve të rëndësishëm publike nxit përfshirje më të madhe të mediave në fushata, duke bërë të mundur përcjellje më të gjerë dhe më të shpejtë të mesazhit që duam të komunikojmë.

## ■ PRAKTIKA TË MIRA

PNUD, një nga promovuesit kryesorë të *Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit* (OZhM), me synimin që të tërheqë burime të reja dhe të krijojë aleanca të fuqishme me - të rinjtë, yjet e sportit, politikanët, kryetarët e shteteve, gazetarët, njerëzit e biznesit, artistët, akademikët, drejtuesit fetarë, anëtarët e sindikatave dhe aktivistët e shoqërisë civile- ftoi këngëtarën e famshme lirike *Inva Mula* që të bëhej *Ambasadorja e OZhM-ve në Shqipëri*. Këngëtarja e mirënjohur pranoi me shumë dëshirë të mbështesë vendin e saj me aktivitete ndërgjegjësuese, pjesë e Fushatës së OZhM-ve.

Ajo vuri në shërbim popullaritetin e saj për ndarjen e mesazhit të OZhM-ve me bashkëkombësit e saj shqiptarë: të rinjtë, studentët, mediat, Romët, pakicat kombëtare, organizatat e shoqërisë civile, sektorin privat dhe publikun shqiptar në përgjithësi. Figura tepër e suksesshme e Inva Mulës ndihmoi për informimin e shqiptarëve mbi rëndësinë e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe përgjegjësitë e gjithsecilit për arritjen e tyre, duke përfshirë qeverinë – qendrore dhe atë rajonale, qytetarët, dhe komunitetin ndërkombëtar. Fama e saj nxiti përfshirjen e medias në këtë fushatë, për shpërndarjen e mesazheve të OZhM-ve një publiku të gjerë. Kjo ndihmoi në thellimin e debatit në vend, duke sjellë përpara çështjet më kritike, duke rritur mundësinë e zhvillimit dhe zbatimit të politikave për arritjen e OZhM-ve deri në 2015.

- **Partneriteti**

Shumë shpesh të partnerizosh përpjekjet për të arritur një objektiv të caktuar, çon në rezultate më të larta se përpjekjet e vetmuara. Për këtë arsye, organizatat jofitimprurëse duhet ta përdorin sa më mirë këtë strategji shumë funksionale. Krijimi i partneritetit me organizata të tjera apo institucione që punojnë në fusha të njëjta apo të ngjashme, do të ndihmonte në krijimin e një ure të re komunikimi me publikun apo grupet e interesit, pasi kjo përpjekje e përbashkët bashkëpunimi do të reklamohet nga disa partnerë njëherësh, gjë që shpejton përçimin e informacionit/lajmit dhe rrit impaktin e dëshiruar nga përcjellja e këtij informacioni.

### PRAKTIKA TË MIRA

Një shembull shumë i mirë partneriteti midis OJF-ve është *'Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit'*, i krijuar në vitin 1998 nga një grup organizatash, që janë: Shoqata 'Refleksione', 'Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza', 'Aleanca Gjinore për Zhvillim', 'Qendra për Nisma Ligjore Qytetare' dhe 'Strehëza për Gra dhe Vajza të Dhunuara'. Këto Organizata Jofitimprurëse, kanë bashkuar përpjekjet e tyre për eliminimin e dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit, duke bashkëpunuar në projekte, fushata dhe aktivitete të përbashkëta, duke përcuar në këtë mënyrë mesazhe të fuqishme të solidarizuara tek publiku i gjerë. Projekti i fundit në të cilin është angazhuar 'Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit', kërkon të fuqizojë dhe përkrahë implementimin me sukses të Ligjit të ri kundër Dhunës në Familje, që ka hyrë në fuqi me 1 Qershor, 2007.

#### - **Sponsorizimi**

Një mënyrë tjetër komunikimi me jashtë mund të jetë sponsorizimi i aktiviteteve të ndryshme të komunitetit. Kjo mënyrë megjithëse është e kushtueshme, përdoret shumë nga biznese të ndryshme, pasi në këtë mënyrë arrihet të krijohet një formë kontakti e rëndësishme me publikun. Kur sponsorizohet një aktivitet i caktuar që mendohet se mund të rrisë impaktin e punës së OJF-së, duhen përgatitur dhe shpërndarë materiale të ndryshme publicitare si broshura, postera, publikime, etj. Në këtë mënyrë sigurohet një mënyrë e re për të përcuar informacionin tek publiku.

#### - **Raporti vjetor**

Përgatitja e një raporti vjetor nga OJF-të është një praktikë e domosdoshme për OJF-të, zbatimi i të cilës lë akoma për të dëshiruar në shumë prej tyre. Sidoqoftë një problem i tillë nuk ekziston vetëm në Shqipëri, por edhe gjetkë. Ashtu si mjetet e tjera të komunikimit me jashtë që përmendëm më lart, raporti vjetor i organizatave jofitimprurëse, ka një rëndësi themelore në arritjen e shkallës së duhur të transparencës me publikun. Vetëm duke bërë një raportim të punës së bërë gjatë vitit, mund të informohet në mënyrë të detajuar publiku dhe aktorët kyç me të cilët OJF-ja bashkëpunon.

Raporti vjetor mund të përgatitet në variant të shtypur, ose vetëm në variant elektronik në rast se mungojnë fondet për shtypjen e tij. Varianti elektronik mund të shpërndahet me e-mail dhe gjithashtu duhet të publikohet në faqen zyrtare të internetit të organizatës. Kujtojmë që raporti vjetor duhet të përgatitet brenda 8 muajve nga mbarimi i vitit të punës.

Një raport vjetor i përgatitur sistematikisht dhe në mënyrë korrekte, i ofron mundësinë publikut të marrë gjithë informacionin e nevojshëm rreth organizatës dhe punës së saj, shton besueshmërinë e organizatës dhe bëhet një urë lidhëse mes saj dhe publikut. Në këtë mënyrë rritet gjithashtu bashkëpunimi me organizatat e tjera, me autoritetet dhe Institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore, me donatorët, me grupet e interesit, si dhe vetë bashkëpunimi i brendshëm i organizatës. *Raporti vjetor i një organizate jofitimprurëse është një pasqyrë e punës së saj në shërbim të komunitetit dhe një rrugë e domosdoshme komunikimi me jashtë.*

#### ■ ■ PRAKTIKA TË MIRA



#### **- Përdorimi i burimeve online**

Për të përdorur burimet online duhet që pikë së pari OJF-ja të ketë një faqe interneti të sajën, në të cilën të përfshihen të gjitha informacionet më të rëndësishme dhe domethënëse rreth saj. Të krijosh dhe të përditësosh një faqe interneti, nuk është një procedurë aq e shtrenjtë dhe e vështirë sa mund të mendohet. Faqja e internetit të OJF-së mund të krijohet në fillim me ose pa ndihmën e një eksperti, pasi procedurat që duhet të ndiqen mund të gjenden lehtë në internet.



OJF-të duhet ta përdorin faqen e internetit për të paraqitur shkurt dhe në mënyrë tërheqëse nga ana vizuale zhvillimet më të fundit dhe më interesante rreth aktiviteteve të tyre. Faqja e internetit duhet të përmbajë informacion konçiz mbi misionin dhe objektivat e organizatës, mbi personelin e saj, mbi aktivitetet e rëndësishme që ajo ka zhvilluar dhe do zhvillojë, raporte vjetore, buletine, botime dhe studime të bëra nga organizata, njoftime punësimi, adresa e-maili funksionale, numra telefoni, adresën e saktë të organizatës, etj. Në rastet kur organizata duhet të reklamojë një aktivitet apo fushatë të rëndësishme, krahas njoftimeve për shtyp, mund të përdoren njoftime zyrtare të publikuara në faqen e organizatës. Gjithashtu, faqja e internetit mund të përdoret edhe gjatë procedurës së punësimit të anëtarëve të rinj të stafit.

Faqja e internetit duhet të ketë një strukturë specifike dhe një gjuhë të thjeshtë dhe konçize. Informacioni duhet të përditësohet vazhdimisht në mënyrë që organizata të ruajë dhe mbrojë komunikimin e saj me jashtë. Mospërditësimi i informacionit, e bën faqen e internetit të pavlefshme si urë lidhjeje me publikun, pasi informacioni i gjendur në të mund të jetë i vjetruar dhe mund të keqinformojë lexuesin. *Për shembull*, një njoftim për punësim që akoma figuron në faqen e internetit të organizatës, megjithëse vendi i punës nuk është më i lirë, mund të krijojë pakënaqësi tek vizitori i faqes, që dëshiron të aplikojë për këtë vend pune, por mëson më pas se ai vend pune është zënë para një muaji.

Për të monitoruar popullaritetin e organizatës, mund të përdoret metoda e monitorimit të vizitorëve të faqes së internetit. Numri i vizitorëve që vizitojnë faqen e internetit të organizatës mund të monitorohet duke përdorur një shërbim të *Google*, që quhet *Google Analytics*. Përdorimi i këtij funksioni është shumë i thjeshtë për çdo përdorues modest të Internetit. Me anë të *Google Analytics* mund të vëzhgojmë se kush dhe sa shpesh viziton faqen e organizatës, çfarë informacioni konsultohet më shpesh, etj. Një mënyrë e tillë monitorimi, ndihmon që të identifikohet informacioni që i duket më i rëndësishëm vizitorëve, si dhe të merren sugjerimet dhe reagimet e nevojshme në lidhje me projektet, aktivitetet, studimet, botimet, dhe organizimet e ndryshme të organizatës. Përveç këtyre që thamë më lart, organizata duhet të sigurohet që adresa e saj mund të gjendet lehtë në *motorët e kërkimit*

*online si Google, Yahoo, etc.* Kjo do të mundësonte lokalizimin e faqes së internetit të organizatës duke përdorur fjalë-kyçe domethënëse (në rastet kur vizitori nuk e di adresën e saktë), si dhe publicitet të rastësishëm. Një mënyrë tjetër reklamimi është edhe vendosja e link-ut të një organizate, në faqet e internetit të organizatave të tjera bashkëpunuese dhe anasjelltas.

Të ndërtohet dhe të mirëmbahet një faqe interneti është një procedurë sa e thjeshtë aq edhe funksionale. Faqja e internetit mund të shërbejë si një urë e mirëfilltë komunikimi me publikun, duke rritur kështu besueshmërinë e organizatës jofitimprurëse, si dhe cilësinë e shërbimeve të saj.

#### ■ PRAKTIKA TË MIRA

Disa faqe interneti të fondacioneve/organizatave/shoqatave të përgatitura me shumë kujdes janë:

<a href="http://albania.rec.org">http://albania.rec.org</a>	Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri
<a href="http://www.ahc.org.al">http://www.ahc.org.al</a>	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
<a href="http://www.soros.al">http://www.soros.al</a>	Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, SOROS
<a href="http://www.mjaft.org">http://www.mjaft.org</a>	Lëvizja MJAFT
<a href="http://www.crca.org.al">http://www.crca.org.al</a>	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, CRCA

### Organizimi i një fushate të suksesshme

Si fillim duhet të identifikohet qartë nevoja për kryerjen e një fushate të caktuar. Në qoftë se e vlerësojmë të nevojshme, duhet të fokusojmë vëmendjen tek fushatat që mund të ndërmerren nga OJF të tjera, me të njëjtën tematikë apo me tematikë të ngjashme.

Mënyra se si arrihet të përçohet fushata që një OJF dëshiron të ndërmarrë, varet në përqindje shumë të madhe nga audienca që ne duam të prekim me anë të kësaj fushate. Për shembull, nëse duam të arrijmë një grup interesi të përbërë nga studentë universitarë, përdorimi i teknologjive të reja si mesazhe telefonike dhe elektronike, reklamime në faqe interneti që thithin interes rinor,



apo afishime të ngjitura në universitete dhe në baret dhe klubet që frekuentohen nga studentë, mund të ishte një mënyrë e përshtatshme komunikimi.

Teknika që OJF-të mund të përdorin varen gjithashtu edhe nga tipi i fushatës që mendohet të organizohet. P.sh. një fushatë për fëmijë mund të kërkojë metoda më dinamike organizimi, se një fushatë për të rritur.

### ***Disa teknika për bërjen e një fushate të suksesshme mund të jenë;***

- Përdorimi i medias për të informuar publikun (gazeta, revista, televizion, radio)
- Reklamime online – si përcjellje e mesazhit promovues nga njëra adresë e-maili në tjetrën. Ky lloj qarkullimi i mesazhit, mund të jetë shumë efektiv pasi arrin tek shumë individë njëherësh dhe përcillet dorë pas dore. Sigurisht që duhet të tregohet kujdes që përmbajtja e e-mailit të jetë interesante për marrësit, në mënyrë që ata të jenë të interesuar për kalimin e mesazhit tek të tretë.
- Përdorimi i publikimeve të ndryshme si, fletëpalosje, broshura, postera, etj, mund të ndihmojë në përcjelljen e mesazhit.
- Manifestimet dhe protestat paqësore mund të ndikojnë bindshëm në përçimin e mesazhit të fushatës.
- Krijimi i një faqeje interneti me tematikë specifike për fushatën, ndihmon në shpërndarjen akoma më të gjerë të informacionit.

### **PRAKTIKA TË MIRA**

Faqja e internetit [www.stopvaw.org](http://www.stopvaw.org) (Stop Violence Against Women), është një faqe që është ndërtuar në funksionin e një forumi për informim, advokasi dhe ndryshim. 'The Advocates for Human Rights' e krijuan këtë faqe si një mjet për promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave, në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, si dhe në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik. STOPVAW u krijua me mbështetjen dhe ndihmën e United Nations Development Fund for Women (UNIFEM) dhe me këshillimin e 'The Open Society Institute's Network Women's Program'. Kjo faqe interneti adreson dhunën kundër grave si një nga abuzimet më të rënda që i bëhet të drejtave njerëzore nëpër botë. STOPVAW ofron informacion dhe mjete advokimi për mbrojtësit e të drejtave të grave, me qëllim eliminimin e të gjitha formave të dhunës kundër grave në rajon.

## Partneriteti Efikas me Televizionet dhe Radiot

Ekziston një mirëkuptim e bashkëveprim ndërmjet organizatave jofitimprurëse dhe mediave të ndryshme, sidomos në veprimtari që lidhen në qëndrimet ndaj dukurive të jashtme, ku OJF-të kanë përqendruar vëmendjen e tyre dhe kërkojnë të gjejnë mbështetje në opinionin e gjerë. Kështu, media mbështet veprimtarinë e dukshme të OJF-ve kur ato u kundërvihen dukurive të ndryshme negative të shoqërisë sonë dhe bëhen burim i lëndës së parë për informacion. Në këtë rast, edhe OJF-të mirëpresin ndihmesën e mediave dhe e ftojnë atë për një qëndrim të përbashkët. (Hamzaj, 2006).

### PRAKTIKA TË MIRA

Një nga OJF-të që mund të konsiderohet si një shembull shumë dinamik në përdorimin me efikasitet të medias, me qëllim arritjen e mbështetjes nga opinioni i gjerë, është Lëvizja MJAF! Vetëm me anë të një vizite shumë të shkurtër në faqen e internetit të kësaj organizate, mund të kuptohet mjaft qartë impakti mediatik dhe përdorimi që gjen ky impakt në realizimin me sukses të aktiviteteve. Numri i madh i deklaratave dhe njoftimeve për shtyp, si reagim aktiv ndaj ngjarjeve dhe ndryshimeve të rëndësishme që ndodhin në vendin tonë, është një tregues domethënës i këtij kanali komunikimi që ka treguar se po të përdoret siç duhet, mund të jetë shumë efikas. Fushatat e sensibilizimit me sloganët që thithin vëmendjen e mediave, arrijnë të lënë gjurmë dhe të garantojnë publicitetin e nevojshëm.

Ky komunikim i drejtpërdrejtë, është në funksionim të misionit të kësaj lëvizjeje dhe në funksionim të realizimit të objektivave që paraprijnë aktivitetet dhe qëndrimet e saj.

Shumë shpesh informacioni që jepet me anë të njoftimeve dhe deklaratave për shtyp, përfundon vetëm në mediat e shkruara. Në qoftë se organizata ka interes që lajmi i saj të përcillet edhe nga mediat elektronike, duhet t'u dërgojë atyre njoftimin apo deklaratën e saj për shtyp. Por, më parë OJF-ja duhet të konsiderojë qëndrimin dhe perceptimin e publikut për median me të cilën ka vendosur të bashkëpunojë.

Duhet treguar kujdes që përpara se t'u dërgohet televizioneve dhe radiove njoftimi apo deklarata për shtyp, OJF-ja të sigurohet që ka mundësi të japë intervistë nëse i kërkohet. Ndërkohë, një person i caktuar nga organizata, duhet të përgatitet për të dhënë intervistën (e regjistruar ose direkte) me televizionin apo radion që OJF-ja kontakton dhe që pranon të bashkëpunojë. Në rastin e intervistave direkte, nevojitet një tekst i saktë dhe i mirëpërgatitur, pasi ka vetëm një shans për ta përcjellë mesazhin ashtu siç duhet.

Të programosh paraprakisht se çfarë do u thuhet gazetarëve në intervistë, është një hap shumë i rëndësishëm në këtë proces. Edhe në qoftë se thirrja për një intervistë e gjen OJF-në të papërgatitur, i/e intervistuari/a ka të drejtë që t'i kërkojë gazetarit/es pak minuta kohë për t'u përgatitur. Duke menduar paraprakisht se çfarë pyetje mund t'i bëjë gazetari/ja, i/e intervistuari/a mund t'i përgjigjet me lehtësi edhe pyetjeve që duan ta vënë në vështirësi.

Personi që përfaqëson organizatën dhe që intervistohet, duhet të jetë sa më direkt dhe i vërtetë me gazetarin/en, duhet të jetë i pajisur me informacion rreth pikave të dobëta dhe të forta të medias me të cilën po bashkëpunon, duhet ta lavdërojë median atëherë kur është e përshtatshme, ta kritikojë atë në mënyrë konstruktive kur është e nevojshme dhe ta monitorojë atë në mënyrë se si e ofron lajmin dhe intervistën e dhënë.

Gjithashtu është shumë e rëndësishme që përfaqësuesit e intervistuar të organizatës të jenë profesionalë dhe të kërkojnë profesionalizëm nga gazetarët. Njohja e kodeve të etikës së medias, do t'i bënte më të aftë për të kërkuar profesionalizëm prej gazetarëve.

Siç përmendëm gjerësisht më lart, OJF-të varen shumë nga mbulimi që i bëhet aktiviteteve dhe qëndrimit të tyre nga mediat - të shkruara apo elektronike qofshin, sepse kështu ato arrijnë të ndërgjegjësojnë publikun rreth misionit

dhe punës së tyre, që është gjithmonë në shërbim të shoqërisë së vendit dhe grupeve të veçanta të interesit brenda kësaj shoqërie (*International Code Council, 2005*). Për këtë arsye, një nga detyrat kryesore të OJF-ve për krijimin e rrugëve të komunikimit me jashtë, është krijimi i një strategjie të mirëfilltë dhe të suksesshme komunikimi me mediat, duke ndjekur hap pas hapi sugjerimet që u dhanë më lart, duke mos harruar që **informacioni që duam të përcjellim duhet të jetë domethënës për mediat, por akoma më shumë, duhet të jetë domethënës për audiencën të cilës i drejtohet.**



## BIBLIOGRAFIA

Lloyd, R. (2006) "NGO Transparency - Accountability in Action", Bi-monthly Newsletter of One World Trust. Publikuar në <[www.oneworldtrust.org](http://www.oneworldtrust.org)>, vizituar për herë të fundit në 16 Mars 2008.

Masudul K. Biswas, (July 2007), '*Developmental Issues in News Media: NGO-Media Interaction in Bangladesh*', The International Journal of Not-for-Profit Law, Volume 9, Issue 3.

NGO Handbook, <<http://www.ngohandbook.org>>, vizituar për herë të fundit në 6 Prill 2008.

One World Southeast Europe, <<http://sq.oneworld.net>>, vizituar për herë të fundit në 31 Mars 2008.

Vidal, P., (2005), '*A conceptual approach and development of the SRO model*' Social Responsibility of non-profit Organizations.

Rrjeti ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) & Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), (*Shtator 2007*), *Praktika Qytetare Ballkanike, 'Marrëdhëniet me Median – Udhëzues për Organizatat e Shoqërisë Civile', Maqedoni.*

The American Marketing Society,  
<<http://www.marketingpower.com>>, vizituar për herë të fundit në 16 Mars 2008.

### Rreth Autoreve...

**Eglantina Gjermeni** është diplomuar me gradën Doktore në Punë Sociale nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Në vitin 1998, ajo u diplomua me Gradën Master në Punë Sociale, pranë Universitetit Shtetëror Grand Valley në Michigan, Sh.B.A. Eglantina është lektore në Departamentin e Punës Sociale pranë Universitetit të Tiranës që nga viti 1995. Ka filluar punën në Qendrën e Aleancës Gjimore për Zhvillim si Drejtore Ekzekutive në Qershor 1999. Eglantina ka një eksperiencë disa vjeçare në trajtime, punë kërkimore dhe studimore rreth çështjeve të përkatësisë gjimore dhe zhvillimit

në të gjitha shtresëzimet sociale. Në dhjetor 2006 ka fituar çmimin “Lidershipi Shqiptar” për kategorinë “Shoqëri Civile” nga Co-Plan dhe Net-Rrjeti për Shkëmbime dhe Trajnim.

**Irena Shtraza** ka përfunduar në vitin 2004 Studimet Pas Universitare pranë Fakultetit të Psikologjisë, në Universitetin e Padovës, Itali. U diplomua në vitin 2002 për “Psikologji Këshillimi”, pranë Universitetit Amerikan të Bosforit, Stamboll, Turqi, si dhe ka kryer studime të dyta universitare në “Psikologji Klinike” në Universitetin e Padovës, Itali. Ka qenë vazhdimisht e përfshirë në punë kërkimore pranë universiteteve ku ka studiuar dhe ka eksperiencë pune në fushën e burimeve njerëzore dhe në atë të këshillimit psikologjik. Aktualisht punon si koordinatore projekti pranë Aleancës Gjimore për Zhvillim, që nga Shtatori, 2007. Gjithashtu është e angazhuar në mësimdhënie që nga Shtatori, 2007.



## PAKETA FISKALE DHE OJF-TË

*MA. Genta Tafa (Bungo)*

Për realizimin e shumë detyrave dhe masave, që shteti është i detyruar t'i kryejë në bazë të kushtetutës, ligjeve dhe dispozitave të tjera, ka nevojë për mjete monetare, të cilat i mbledh duke shfrytëzuar sovranitetin e tij financiar. Këto janë tatimet, taksat dhe doganat, si të hyra të zakonshme të shtetit.

**Tatimet** janë pagesa të detyrueshme, në ngarkim të kontribuesve tatimorë, që përdoren për mbulimin e nevojave mbarë-shoqërore. Ndërsa taksat janë një çmim për shërbimet speciale, që shteti iu ofron kontribuesve taksorë.

Legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga ligjet për tatimet e taksat nacionale dhe ato vendore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Si pjesë të rëndësishme të legjislacionit tatimor mund të përmendim:

- Ligji nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

**a)** Ligji nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në Republikën e Shqipërisë administrimi i tatimeve dhe taksave bëhet nga administrata tatimore. Kjo administratë përbëhet nga:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
2. Degët e Tatimeve në Rrethe;
3. Komisioni i Apelimit të Tatimeve
4. Zyrat Tatimore të Pushtetit Vendor;

*Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve* është autoriteti qendror i vetëm tatimor

në Republikën e Shqipërisë, e cila ka *degët e veta në rrethe*. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Degët e saj në rrethe janë organet kompetente që zbatojnë dhe administrojnë tatimet. Kjo drejtori e ka selinë në Tiranë dhe në strukturën e saj dhe të degëve të saj funksionon edhe Policia Tatimore. Dega e tatimeve drejtohet nga Kryetari i Degës.

*Komisioni i Apelimit të Tatimeve* përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga Ministri i Financave. Komisioni i Apelimit të Tatimeve është organ i pavarur pranë Ministrisë të Financave dhe i pavarur në vendimmarrje. Tatimet dhe taksat vendore administrohen nga organet e qeverisjes vendore, të cilat kanë në vartësi *zyrat tatimore të pushtetit vendor*.

Sistemi fiskal në Republikën e Shqipërisë nuk bën asnjë dallim ndërmjet subjekteve vendas apo të huaj.

Me ndryshimet e fundit që iu bënë paketës fiskale, subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike tregtare, detyrohen të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me dispozitat e ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit përbën, njëkohësisht, edhe regjistrim në organet tatimore përkatëse. Përveç procedurave të regjistrimit, ligji parashikon procedura të veçanta edhe për çregjistrimin e tatimpaguesit.

Subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit çregjistrohen nga regjistri tregtar pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të paguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes për subjektet, për të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, kërkohet paraqitja e bilancit.

**b) Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar.**

Në tatimin mbi vlerën e shtuar *baza tatimore në fazën e tatuar është vlera plotësuese (e shtuar) në po atë fazë të ciklit të qarkullimit*. Shuma e tatimit të paguar në fazën e mëparshme nuk hyn në bazën tatimore të fazës tjetër. Tatóhet vetëm vlera plotësuese në secilën fazë të tatuar të ciklit të qarkullimit. Tatimi mbi vlerën e shtuar është një tatim i përgjithshëm, indirekt dhe mbi konsumin.

Në çdo hallkë llogaritet tatimi i paguar për të gjitha furnizimet dhe tatimi i llogaritur për të gjitha shitjet. Tatimi që u paguhet organeve tatimore llogaritet si diferencë e këtyre elementëve.



Kur aplikohet tatimi mbi vlerën e shtuar si tatim-pagues njihen personat që kryejnë veprimtari fitimprurëse, por barra tatimore bie në çmimin e blerjes nga konsumatorët.

Në kuptim të këtij ligji persona të tatueshëm (obligues tatimorë) janë:

- a)** ata persona, furnizimet e të cilëve janë mbi kufirin minimal të regjistrimit të furnizimit për një vit dhe ky kufi është 8 milionë lekë;
- b)** të gjithë personat, të cilët dëshirojnë të regjistrohen pavarësisht se nuk e arrijnë këtë nivel.

Qarkullimi që merret parasysh përfshin të gjitha veprimtaritë ekonomike të kryera nga i njëjti person dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi.

### **Cili është mekanizmi i llogaritjes së TVSH-së të pagueshme?**

Tatimi mbi vlerën e shtuar i pagueshëm nga një person i tatueshëm për një periudhë tatimore do të llogaritet duke zbritur nga TVSH-ja e zbatuar për periudhën tatimore mbi vlerën totale të tatueshme, të të gjitha furnizimeve të tatueshme të bëra nga ky person, çdo kreditim tatimi të lejuar për këtë person për atë periudhë.

### **Kreditimi i tatimit lejohet në këto raste:**

- a)** për të gjitha furnizimet e tatueshme të bëra për personin e tatueshëm nga persona të tjerë të tatueshëm;
- b)** për të gjitha importet e mallrave të bëra nga personi i tatueshëm;
- c)** kur një pagesë nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht për një furnizim të tatueshëm prej furnizuesit dhe është një borxh i keq.

Nëse kreditimi i tatimit për një periudhë tatimore është më i madh se TVSH-ja e zbatuar për atë periudhë, personi i tatueshëm ka të drejtën të mbartë shumën e mbetur si kreditim tatimor për periudhën pasardhëse tatimore në bazë të nenit 32 të ligjit.

Një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor kur:

- a. Personi i tatueshëm ka mbartur një shumë të kreditimit tatimor për 3 muaj me radhë, në bazë të pikës 1 të këtij neni;
- b. Rimbursimi i kërkuar tejkalon shumën prej 400 000 lekë.
- c) Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

Me këtë ligj rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.

Në kuptim të këtij ligji, rezident në Republikën e Shqipërisë janë këta persona:

- 1) **Individi, në rast se:**
  - ◆ ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil;
  - ◆ është shtetas shqiptar dhe funksionar konsullor, diplomatik ose i ngjashëm i Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj.
- 2) **Individi që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë të një periudhe tatimore.**
- 3) **Personi juridik, i cili:**
  - ◆ ka selinë qendrore (zyrën qendrore) në Republikën e Shqipërisë;
  - ◆ ka vendin e menaxhimit efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.
- 4) Personi fizik, që, sipas legjislacionit tregtar, është regjistruar me këtë cilësi në organin e ngarkuar me ligj për regjistrimin e subjekteve.

#### Tatimi Mbi Të Ardhurat Personale

Tatimi mbi të ardhurat personale, që më poshtë do të quhen “të ardhura”, llogaritet mbi të ardhurat e individëve. *Subjekte të tatimit mbi të ardhurat personale* janë individët rezidentë për të gjitha burimet e të ardhurave dhe ata jo-rezidentë për burimet e të ardhurave të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme:

- a) Pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës;



Përrjashtohen të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdhëniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatët, ose funksionarë të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, ose të pranuar nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk i nënshtrohen përjashtimeve të këtij paragrafi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët nuk gëzojnë statusin e diplomatit, të njohur nga konventa apo marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim;

b) Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare;

c) Të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose letra të tjera me vlerë të Qeverisë, të emërtuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji;

ç) Të ardhurat që rrjedhin nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale;

d) Të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qiratë, me përjashtim të rasteve kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar;

dh) Të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;

**d) Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë.**

f) Të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ja shet një personi tjetër;

g) Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jo-rezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.

### **Tatimi Mbi Fitimin**

Tatimit mbi fitimin i nënshtrohen të gjithë personat juridikë, vendas dhe të huaj, shtetërore apo private, që kryejnë ose do të kryejnë një qarkullim më të madh se 8 milionë lekë në një vit kalendarik dhe që janë subjekte të tatimit

mbi vlerën e shtuar, si edhe çdo person tjetër, pavarësisht nga forma juridike e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur ky është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar.

Tatimit mbi fitimin i nënshtrohen të gjithë personat fizikë, të regjistruar në TVSH dhe që nuk janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël.

Qarkullimi që merret parasysht, përfshin të gjitha veprimtaritë ekonomike të kryera nga i njëjti person dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që paguan blerësi. Përqindja e tatimit mbi fitimin është 10%.

Fitimi i tatueshëm është fitimi vjetor që llogaritet mbi bazën e fitimit që rezulton në bilancin kontabël. ***Fitimi përfaqëson tepricën e të ardhurave totale mbi shpenzimet e kryera për arritjen e këtyre të ardhurave.***

Tatimi mbi fitimin llogaritet për çdo vit fiskal që është i njëjtë me vitin kalendarik. Humbja e rezultuar dhe e njohur nga organet tatimore zbritet nga fitimi i vitit pasardhës. Kur humbja është më e madhe se fitimi i vitit pasardhës, pjesa e mbetur zbritet nga fitimi i vitit të dytë dhe të tretë pasardhës.

*Përfshihen nga tatimi mbi fitimin:*

- a) Organet e qeverisjes qendrore dhe vendore;
- b) Banka e Shqipërisë;
- c) Personat juridikë që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre;
- ç) Organizatat e punës apo dhomat e tregtisë, industrisë ose bujqësisë, pasuria apo fitimi i të cilave nuk përdoret për përfitimin e një individi apo të një anëtari të tyre;
- d) Organizatat ndërkombëtare, agjencitë e bashkëpunimit teknik dhe përfaqësitë e tyre, përjashtimi nga tatimet i të cilave parashikohet nga marrëveshje të veçanta;
- dh) Personat e parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi.



- e) Fondacionet ose institucionet financiare jo-bankare të krijuara ose të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë për qëllim mbështetjen e politikave zhvilluese të qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive;
- ë) Shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të liçensuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

Gjithsesi, të gjitha subjektet e përmendura, pavarësisht nga përjashtimi nga pagimi i tatimit mbi fitimin, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin vjetor, në të njëjtat afate si subjektet, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin.

### **Tatimi i mbajtur në burimin e të ardhurave**

Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jo-fitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë:

- a. dividendët;
- b. ndarjet e fitimit;
- c. interesat;
- d. pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale;
- e. pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit;
- f. pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues;
- g. pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to;
- h. pagesat për qeratë;
- i. pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre.

### **Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”**

QKR është institucion publik qendror, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e tregtisë, dhe ushtron juridiksionin në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

QKR kryen këto funksione:

- a) mban regjistrin tregtar;
- b) kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- c) kryen regjistrimin e subjekteve, të përcaktuara në këtë ligj, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe inspektimit të marrëdhënieve të punës;
- ç) lëshon çertifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve, të depozituara sipas përcaktimit të këtij ligji;
- d) publikon të dhënat e regjistrit të mbajtur, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;
- dh) pranon kërkesat për liçenca, leje dhe autorizime administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ia dorëzon ato aplikuesit pas miratimit nga organet përkatëse;
- e) informon dhe këshillon për procedurat e regjistrimit dhe të liçensimit.

Sipas nenin 22, detyrimin për regjistrim e kanë:

- a) personat fizikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike tregtare;
- b) shoqëritë e thjeshta sipas dispozitave të Kodit Civil;
- c) shoqëritë tregtare;
- ç) degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja;
- d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;
- dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- e) çdo subjekt tjetër, për të cilin parashikohet detyrimi për regjistrim, në bazë të legjislacionit shqiptar.

Subjektet çregjistrohen nga regjistri tregtar në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridikë, shpërndarjen e shoqërisë së thjeshtë, në rastet e përfundimit të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare të personit fizik, si dhe në çdo rast tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Subjektet e çregjistruara vazhdojnë të mbartin përgjegjësinë për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike.



Por siç thamë edhe më lart, pjesë e paketës fiskale janë edhe taksat. Dy janë ligjet që rregullojnë të gjithë sistemin taksor në vendin tonë.

- Ligji nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën Shqipërisë”
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Ligji nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” trajton vetëm taksat kombëtare. Ligji përcakton shprehimisht nivelin e çdo takse kombëtare, si dhe agjentin që ngarkohet për vjeljen e tyre. Për shërbimin që kryejnë, agjentëve të taksave u jepet komisioni përkatës në rrugë buxhetore.

Taksat vendore rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”. Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore dhe mbledhjen e administrimin e tyre.

Si taksa vendore ligji përcakton:

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël;
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore;
3. Taksa e fjetjes në hotel;
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve;
7. Taksa për zënien e hapësirave publike;
8. Taksa e tabelës;
9. Taksa të përkohshme.

Subjekt i taksës vendore mbi biznesin e vogël është kushdo që kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë. E ardhura nga taksa vendore mbi biznesin e vogël i takon asaj njësie të qeverisjes vendore, në territorin e juridiksionit të së cilës gjendet vendndodhja e biznesit. Kjo taksë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Subjektet e kësaj takse

janë të detyruar të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme është një lloj tjetër i taksave vendore. Kësaj takse i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive të paluajtshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Detyrimin e kësaj takse e mbart pronari i saj ose bashkë-pronari në përputhje me pjesën që zotëron.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përfshin:

- a) taksën mbi ndërtesat;
- b) taksën mbi tokën bujqësore.

Kjo taksë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.

Niveli i taksës mbi ndërtesat caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e taksueshme. Të ardhurat e realizuara nga taksa mbi ndërtesat i takojnë 100 për qind bashkisë ose komunës, ku realizohet kjo taksë.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjstive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- c) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme





vendoset mbi ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme, në çastin e kalimit të pronësisë mbi to. Kjo taksë paguhet nga personi që ka të drejtën e pronësisë para kryerjes së regjistrimit.

Përrjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a. Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;
- c. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
  - i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
  - ii. bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.

Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose komunal për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

A kanë detyrime fiskale organizatat jofitimprurëse? A janë ato obligues tatimorë? Po t'i referohemi ligjit nr. **8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”**, në ndryshimin e bërë nenit 40 thuhet se ato përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat që realizojnë nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë. Por, kur këto të ardhura nuk përdoren në përputhje me veprimtarinë për të cilën është regjistruar kjo OJF, atëherë kjo do të konsiderohet si veprimtari fitimprurëse dhe do t'i nënshtrohet tatimit.

Por kjo është vetëm njëra anë e medaljes. Le të shikojmë me radhë ligjet tatimore nga këndvështrimi “OJF”.

Ligji nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ashtu si gjithë subjektet e tjera, edhe OJF-të kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore dhe për t'u pajisur me çertifikatë tatimore. Këtij detyrimi i

nënshtrohen edhe fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, etj, që ushtrojnë veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor ose edukativ, pavarësisht nga fakti se veprimtaria e tyre mund të mos jetë ekonomike e fitimprurëse. Për t'u pajisur me çertifikatë tatimore, personat fizike ose juridikë të mësipërm duhet të paraqesin në organet tatimore, përveç vendimit të gjykatës për regjistrimin e tyre, statutin dhe të dhëna të tjera kontakti. Organet tatimore mbajnë një regjistër të veçantë për evidentimin e këtyre personave, duke i vlerësuar ata, për efekte fiskale, si tatimpagues pasivë.

Këta persona fizikë ose juridikë (OJF), që krahas veprimtarisë me karakter fetar, humanitar, bamirës, shkencor ose edukativ, kryejnë edhe veprimtari të tjera, me karakter ekonomik, janë të detyruar të regjistrojnë veçmas këto aktivitete në organet tatimore, njëlloj si çdo tatimpagues tjetër, që ushtron veprimtari ekonomike.

Ashtu si gjithë subjektet e tjera, edhe OJF-të kanë detyrimin për t'u regjistruar pranë QKR-së, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe procedurat që parashikon ai. Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit përbën, njëkohësisht, edhe regjistrim në organet tatimore përkatëse. Në bazë të nenit 22 të këtij ligji, mbart detyrimin për t'u regjistruar në regjistrin tregtar, përveç të tjerëve, edhe çdo subjekt për të cilin legjislacioni parashikon detyrimin për regjistrim. Kështu që OJF-të janë të detyruara të kryejnë regjistrimin pranë QKR-së. Aplikimi për regjistrim bëhet brenda 30 ditëve nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e formimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar. Të drejtën për aplikim e ka përfaqësuesi ligjor, sipas përcaktimit të ligjeve përkatëse ose çdo person i autorizuar prej tyre.

### **Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar**

Siç thamë edhe më lart, objekt i këtij ligji janë marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.

*Tatimi mbi të ardhurat personale* llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Si e ardhur e tatueshme do të konsiderohen pagat dhe shpërblimet që përfitohen nga marrëdhënia e punës. Kjo do të thotë që të gjithë individët, për aq sa përfitojnë paga dhe shpërblime nga puna në kuadrin e veprimtarisë së OJF-së, i nënshtrohen pagimit të tatimit mbi të ardhurat personale.



### Sa është masa e tatimit të pagueshëm?

Sipas ndryshimeve të fundit të paketës fiskale dhe me aplikimin e konceptit të “taksës së sheshtë” detyrimi llogaritet i tillë:

E ardhura e tatueshme (në muaj)		Përqindje
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	
0	10 000	0 për qind
10 001 +	30 000	+ 10 për qind të shumës mbi 10 000 lekë
30 001 +	Më tepër	10 për qind të shumës mbi 0 lekë

Pra, si konkluzion detyrimi i parë i OJF-së është pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale për të gjithë të punësuarit. Duke e konsideruar OJF-në si punëdhënës, në zbatim të nenit 10, ka detyrimin të llogarisë dhe mbajë këtë tatim si edhe të derdhë tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

*Tatimi mbi fitimin* është fusha e dytë e veprimit të këtij ligji. Në fakt, duke u nisur nga emri, meqenëse organizatat janë jofitimprurëse, do të thotë që mungon baza tatimore për këtë tatim, domethënë mungon fitimi. Dhe në fakt neni 18, pika c, parashikon përjashtimin nga pagimi i tatimit mbi fitimin të personave juridikë që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre. Pavarësisht përjashtimit nga pagimi i tatimit mbi fitimin, këta persona janë të detyruar të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin vjetor, në të njëjtat afate si subjektet, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin.

Duke patur parasysh faktin që një OJF mund të kryejë edhe veprimtari ekonomike, apo mund të marrë pjesë si të gjithë personat e tjerë juridikë në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktiveve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve



Ashtu siç kemi thënë dhe më lart, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet:

- a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b. për të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke patur parasysh furnizimet e bëra nga OJF-të, ligji parashikon se:

“Furnizimi i bërë nga një organizatë jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar është një furnizim i përjashtuar nëse është:

- a) furnizim mallrash a shërbimesh për trajtim mjekësor ose dentar;
- b) furnizim shërbimesh për mbrojtjen e kujdesin ndaj fëmijëve ose të moshuarve;
- c) furnizim shërbimesh arsimore, kulturore apo sportive;
- ç) furnizim shërbimesh nga organizata fetare a filozofike me qëllim mirëqenien shpirtërore.”

### **Ligji nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”**

OJF-të gëzojnë privilegje jo vetëm tatimore, por edhe taksore. Ligji rregullator i taksave kombëtare parashikon përjashtimin e OJF-ve nga pagimi i disa taksave.

- Përjashtohen nga pagimi i taksave konsullore:
  - personat e organizatave bamirëse dhe filantropike;
  - personat që shoqërojnë mjete me ndihma humanitare në bazë të marrëveshjeve ose të dërguara nga organizatat bamirëse, institucionet e ndryshme, individë të veçantë, ose qeveritë e huaja;
- Përjashtohen nga taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja:
  - mjetet e përfaqësive diplomatike e të shoqatave bamirëse
- Nga pagimi i taksës për shërbimet e radio-komunikacioneve përjashtohen:
  - organizatat bamirëse dhe filantropike të regjistruara në vendin tonë;

• Nga pagimi i taksës së kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen:

- personat e organizatave bamirëse e filantropike;

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”

Ky ligj rregullon mënyrën e mbledhjes dhe administrimin e taksave që mblihen nga pushteti vendor. Meqenëse shumica e këtyre taksave vendore janë individuale apo familjare ndeshim pak përjashtime për OJF-të.

Në fakt të bën përshtypje përjashtimi nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme i atyre subjekteve që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë, ndër të tjera, organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose komunal për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agentit të taksave.

Ndërsa përjashtime të tjera OJF-të përfitojnë për aq sa parashikohet në ligjin organik të tyre. Gjithsesi janë të detyruara të paguajnë taksën e tabelës, taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve apo edhe taksa të tjera të përkohshme të vendosura nga pushteti vendor në përputhje me ligjin.

## BIBLIOGRAFIA

Genta Tafa (Bungo), G. (2007), "Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare" ILAR, Tiranë

Ligji nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore ne RSH".

Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Ligji nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat".

Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ligji nr. 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në RSH".

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

### Rreth autores...

**Genta Tafa (Bungo)** ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 1993. Pasi ka punuar si specialiste në Ministrinë e Punëve të Jashtme në vitet 1993-1996, në Janar të vitit 1996 është angazhuar në Fakultetin e Drejtësisë si pedagoge me kohë të plotë për lëndën 'E Drejta Financiare'. Ka punuar në këtë detyrë deri në shtator të vitit 2003, kohë në të cilën u angazhua si Drejtore e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, detyrë që e ka kryer deri në 2006-tën. Prej asaj kohe vazhdon të jetë lektore e së Drejtës Financiare në Fakultetin e Drejtësisë "Luarasi" dhe Universitetin jo-publik "Kristal". Ka marrë titullin "Master" në vitin 2003 dhe momentalisht është në fazën finale të mbrojtjes së gradës "Doktor" në fushën e "Tatimeve të Dyfishta".

# PROCEDURAT PRAKTIKE PËR TË ARRITUR TRANSPARENCËN FINANCIARE

*Mirela Arqimandriti, MBA*

Artikulli i mëposhtëm hedh një vështrim mbi bazat e një sistemi të mirë të menaxhimit financiar, të rëndësia e të pasurit politika financiare dhe se si t'i zhvillojmë ato. Gjithashtu flitet mbi rëndësinë e rolit të strukturave bazë në kontrollin financiar dhe besueshmërinë, duke sqaruar detyrat e Bordit dhe Drejtorit Ekzekutiv në një organizatë. Rëndësia e auditimit vjetor të jashtëm është një nga çështjet që do të trajtohet në artikull, si dhe rëndësia e përdorimit të shifrave që dalin nga raportet financiare.

Artikulli është shkruar me një gjuhë të thjeshtë për t'u kuptuar jo vetëm nga financierët, por edhe nga personat e tjerë brenda organizatave, që kanë një rol të rëndësishëm drejtues. Shumë njerëz në pozicion drejtimi në organizata të shoqërisë civile dhe në projekte të ndryshme e gjejnë veten duke menaxhuar shumën të mëdha parash, por ndërkohë kanë pak ose aspak njohuri se si ti menaxhojnë këto para.

## 1. HYRJE

### **Etimologjia e transparencës**

Termi transparencë, vjen nga latinishtja *transparere*, “të shfaqesh”, “të jesh i dukshëm”. Ky term në wikipedia ka këtë kuptim primar: “*Transparenca është një veti fizike që lejon transmetimin e dritës përmes një materiali*”. Por, fjala transparencë është duke u përdorur shumë sidomos vitet e fundit, edhe në kontekste të tjera në lidhje me atë që bëjnë njerëzit në fusha të ndryshme.

Më poshtë sqarohet se si duhet të veprojnë një organizatë e shoqërisë civile



për t'i dhënë kuptim fjalës *Transparencë* në mjediset ku ajo operon.

### ***Çfarë janë Transparenca dhe Përgjegjësia?***

Koncepti i *transparencës* është në thelb i thjeshtë. Ky koncept mbulon shpërndarjen e informacionit, të cilin publiku ka të drejtë ligjore ta ketë në çdo moment. Kjo, detyron krijimin e një linje komunikimi të sqartë, duke përfshirë publikimin e raporteve të detajuara të cilat kanë për qëllim të tregojnë pozicionin financiar të organizatës dhe parimet e menaxhimit financiar, si dhe të zbulojnë strukturat e brendshme të vendimmarrjes, metodologjinë si dhe detaje të zbatimit të projekteve dhe të nismave të ndërmarra.

Ndërsa *përgjegjësia* është një nocion më kompleks që përfshin përgjegjësinë fiskale, përgjegjësinë e procesit, përgjegjësinë e programit, të cilat konfirmojnë që organizata ka vepruar në përputhje me misionin dhe objektivat e saj.

Pra, *koncepti i përgjegjësisë* është më i kufizuar dhe më i ligjshëm për t'u gjykuar se sa *transparenca*. Të dy konceptet kanë lidhje me gjithë faktorët etikë, rregullues si dhe të njohur nga ligji. Ata gjithashtu i shërbejnë efikasitetit në një organizatë.

### ***Nevoja për Transparencë***

Transparenca është në interesin e vetë organizatës. Publiku dhe donatorët kanë më shumë mundësi ta mbështesin organizatën, kur janë të informuar rreth aktiviteteve, organizatës, statusit ligjor dhe financave, sidomos kur kontrollet e pavarura dhe auditimet konfirmojnë efikasitetin dhe ndershmërinë në menaxhimin e saj.

Transparenca në formën e informacionit publik *rreth* dhe *nga* organizata kërkohet në interes të të gjithë shoqërisë. Transparenca është më shumë se të japësh informacion. Ajo nënkupton dhënien e mundësisë për të depërtuar në mënyrën se si institucionet, qofshin qeveritare, joqeveritare apo tregtare, punojnë aktualisht.

Por, transparenca nuk do të thotë ndarje totale e informacionit midis të gjithëve. P.sh. në organizatat qeveritare ka informacione si, mbrojtja e vendit, lufta kundër krimit, apo informacione mjekësore, të cilat nuk duhen bërë publike. Bizneset

nuk mund të bëjnë publike patentat e tyre dhe formulat sekrete të produkteve të cilat sjellin fitimin. Ndërsa OJF-të p.sh. nuk mund të bëjnë publike shkrimin e projekt propozimeve, etj.

### ***Konkluzion***

Transparenca është mënyra më e mirë për të luftuar korrupsionin. Megjithëse janë bërë përparime në luftën kundër tij, ka akoma shumë sfida. Një sfidë kryesore për organizatat e shoqërisë civile mbetet se *si të veprojë me më shumë efektivitet, veçanërisht në një mjedis i cili nuk inkurajon sinqeritetin dhe transparencën*. OJF-ja duhet të zhvillojë metoda pjesëmarrëse për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndërtuar koalicione, si dhe të eksperimentojë sisteme për mbështetjen dhe monitorimin e strategjive antikorrupsion. Reduktimi i korrupsionit promovon zhvillimin ekonomik dhe të drejton drejt prosperitetit dhe stabilitetit.

Nevoja për transparencë ka të bëjë padyshim me cilësinë e produktit, që në rastin e OJF-ve janë: botimet, trajnimet, studimet, fushatat, etj.; mënyra e shpërndarjes së informacionit te publiku; e mbi të gjitha mënyrat se si janë përdorur paratë në dispozicion për të realizuar këto produkte. Pra, *menaxhimi financiar*.

## **2. Menaxhimi financiar dhe menaxhimi i programeve/projekteve**

Funksionet e menaxhimit financiar në OJF janë të lidhura direkt me funksionet e menaxhimit të projektit/programit. Kjo do të thotë se menaxhimi financiar implementohet paralel me menaxhimin e projektit/programit.

*Menaxhimi financiar i një organizate kalon përmes hapave të mëposhtëm:*

***Buxhetimi.*** Një buxhet është një plan i shprehur në terma monetarë. Për këtë arsye, i përdorur në mënyrën e duhur si mjet financiar, përmes buxhetit mund të parashikohen rreziqe të mundshme në çdo etapë të projektit/programit, duke paralajmëruar menaxhimin e organizatës, sapo të vërë re shmangie nga shumica në dispozicion;

***Llogarimbajtja.*** Llogarimbajtja ose ndryshe regjistrimi i çdo transferte në të

gjitha fazat e veprimeve. Mbajtja e llogarive ka të bëjë me komunikimin e informacionit rreth aktiviteteve financiare në projekt. Ky informacion përbën një nga të dhënat e vendimmarrjes. Informacioni i dhënë në kohë, i saktë dhe i sigurtë çon drejt vendimeve të marra në kohë, të sakta dhe të sigurta;

**Kontrolli i brendshëm.** Kontrolli i brendshëm, është një plan i organizatës që përfshin koordinimin e masave dhe metodave të ndryshme për të ruajtur asetet, për të kontrolluar saktësinë dhe sigurinë e të dhënave financiare, për të promovuar efikasitetin operacional dhe për t'u kujdesur që politikat e përshkruara në manuale të ndiqen me përpikmëri;

**Analizat financiare.** Këto shërbejnë për të analizuar gjendjet aktuale në lidhje me performancën e mëparshme dhe për të drejtuar vendimet e ardhshme të organizatës.

Le ti marrim me radhë:

## 2.1 Buxhetet

Buxheti është *“një plan për veprim”*. Ai prezanton projektet e organizatës për muajt dhe vitet e ardhshme të shprehura në terma financiarë. Kjo do të thotë se, përpara se të përgatisë një buxhet, organizata duhet të ketë të qarta mirë objektivat e saj. Shpesh procesi është i dyanshëm dhe ndonjëherë gjatë bërjes së buxheteve vendosen dhe rregullohen disa nga objektivat. Duke qenë se buxheti është mekanizmi që na lejon të përkthejmë në terma monetarë programet dhe aktivitetet e organizatës, ai është një mjet kyç i menaxhimit. Përmes buxhetit bëhet planifikimi dhe analiza e kostove të aktiviteteve të organizatës. Buxheti ka dy funksione, *planifikues* dhe *kontrollues*.

## 2.2 Llogarimbajtja

Llogarimbajtja është arti i të regjistruarit, klasifikuarit, përmbledhjes dhe interpretimit të realizimit të aktiviteteve në terma monetarë. Në bazë të përkufizimit, llogarimbajtja ka katër funksione:

**Të regjistrojë** - Ky proces është një proces rutinë dhe mekanik që ka lidhje me hedhjen e transfertave në librat e llogarive, në mënyrë kronologjike në përputhje me rregullat e procedurat financiare;

**Të klasifikojë** - Ky funksion përfshin ndarjen ose grupimin e transfertave të ngjashme në klasat respektive të përcaktuara më parë gjatë buxhetimit. Pra, të klasifikosh do të thotë që një shpenzim të caktuar ta kalosh në një kartelë llogarie;

**Të përmbledhë** - Kjo përfshin përgatitjen e raporteve financiare. Këto raporte duhen përgatitur në mënyrë periodike, mujore, tre mujore vjetore, gjashtëmujore, ose vjetore. Raportet më të rëndësishme financiare janë bilanci, pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë;

**Të interpretojë** - Raportet financiare të përgatitura shpjegohen më tej për të drejtuar menaxhimin e organizatës në formulimin e vendimeve.

### ***2.3 Përse kemi nevojë për një sistem llogarimbajtje?***

Sistemi i llogarimbajtjes është pjesë thelbësore në menaxhimin dhe përgjegjësinë financiare. Ky sistem bën të mundur që të monitorojmë nëse strategjia financiare e organizatës po funksionon, nëse organizata është e shëndetshme financiarisht, dhe nëse paratë janë shpenzuar mirë gjatë arritjes së objektivave. Një sistem i mirë llogarimbajtje i organizatës, bën të mundur që organizata të jetë financiarisht e përgjegjshme dhe e besueshme për të gjithë personat kyç. Llogarimbajtja është një sistem për të regjistruar të gjitha paratë që hyjnë në organizatë dhe të gjitha paratë që dalin prej saj.

*Llogarimbajtja është e nevojshme sepse:*

- Aktorët kuptojnë, me anë të saj se cili është pozicioni financiar i organizatës;
- Bën të mundur monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt buxhetit;
- Tregon nivelin e transparencës dhe të përgjegjshmërisë;
- Shërben për të bërë më mirë planifikimin financiar;
- Siguron që të mos humbasim para nga keqmenaxhimi ose korrupsioni.

*Nëse keni një sistem të mirë llogarimbajtje, ju:*

- Do të jeni të aftë të jepni raporte të rregullta financiare ndaj atyre për të cilët keni përgjegjësi;

- Do të jeni të aftë të merrni vendime në lidhje me buxhetet dhe shpenzimet;
- Do të keni dëshmi në formën e faturave dhe pagesave për çdo shpenzim.

*Sistemi i llogarimbajtjes duhet ndërtuar dhe mirëmbajtur:*

- Nga një person i punësuar në organizatën tuaj, i cili/e cila është në pozicionin e financierit/es ose llogaritarit/es;
- Nga një organizatë tjetër që ofron shërbime financiare për disa organizata;

## 2.4 Cilat janë bazat e sistemit financiar?

Që të mbahen libra llogarie të saktë, ju keni nevojë të zbatoni rregullat që vijojnë:

- Të çelni një llogari bankare dhe të pajiseni me një bllok çekesh;
- Të çelni një sistem regjistrimi me faturat përkatëse;
- Të çelni një sistem regjistrimi mujor për librat e pagesave, për të regjistruar dhe analizuar të ardhurat e shpenzimet;
- Të krijoni formate përkatëse për deklaratat financiare mujore e vjetore.

*Librat e llogarisë që do të mbani duhet të tregojnë:*

**Të ardhurat** - Këto përfaqësojnë të gjitha paratë që hyjnë në organizatë (nga ngritja e fondeve, donacionet, interesat bankarë, grantet, shitjet, etj);

**Shpenzimet** - Këto janë para që organizata juaj i shpenzon (p.sh. kanceleri, telefon, ujë, elektricitet, qera, komisione bankare, shpenzime për trajnime, botime, transport, etj.);

**Balancën** - Këto janë paratë që mbeten në fund të çdo muaji/viti.

Çdo transfertë financiare duhet të kalojë përmes hapave të mëposhtëm:

1. Një transfertë ndodh kur paratë janë shpenzuar apo kur kanë hyrë;

2. Transferta regjistrohet në formë të shkruar si dëshmi që ka ndodhur. Kjo mund të jetë në formë fature të lëshuar nga ju për paratë e arkëtuara, ose e një fature të lëshuar nga furnitori/shitësi kur ju paguani për të blerë diçka. Nëse pagesa kryhet përmes bankës ju do të pajiseni me një faturë konfirmimi të printuar. Nëse paguani me çek, ju nuk merrni faturë, por transfera do të regjistrohet në deklaratën e bankës;
3. Më pas transfera regjistrohet në librat e llogarive tuaja. Për të gjitha paratë e marra dhe të shpenzuara ky regjistrim duhet të bëhet në librin e arkës apo të bankës;
4. Për të gjitha transfertat e bëra në një muaj, ju duhet të përgatisni deklaratat mujore bankare dhe të arkës. E njëjta gjë duhet bërë për të gjithë vitin.

*Një sistem llogarimbajtje duhet të japë informacion që të jetë:*

- I përshtatshëm (t'ju thotë juve ato që duhet të dini);
- I kuptueshëm (i formatuar në një mënyrë që të mund ta kuptoni);
- I besueshëm (t'ju japë informacion që të jetë gjithmonë korrekt);
- I kompletuar (t'ju japë informacion për gjithçka që doni të dini);
- I pajtueshëm (t'ju japë informacion që mund të krahasohet me informacionin nga vitet e kaluara);
- I pranueshëm nga bota e jashtme (veçanërisht nga auditorët, donatorët dhe qeveria).

Çelësi për një sistem llogarimbajtje të dobishëm është: ***“Mbaje të thjeshtë, të detajuar, logjik, me të dhënat e fundit të regjistruara, me dokumentet mbështetëse për çdo transfertë”.***

## 2.5 Krijimi i sistemit

Fillimi i një llogarimbajtje të mirë është krijimi i sistemit të llogarive. Për ta bërë këtë *ju duhet të përcaktoni qartë:*

- Titujt nën të cilat informacioni financiar duhet të përmblihdhet;
- Rrugën në të cilën të ardhurat e shpenzimet do të shpërndahen;
- Titujt nën të cilat regjistrimet financiare mbahen, njihen ndryshe si *diagrama e llogarive*;
- Titujt e diagramës tuaj të llogarive duhet të jenë pak a shumë të njëjtë me zërat e nënzërat e buxheteve tuaj. Titujt e diagramave janë të koduara dhe personi që mban financat di cilat kode të përdorë për shpenzimet apo të ardhurat e ndryshme. Titujt duhet të kenë kuptim për ju, sepse ato lidhen me punën që ju bëni. Këto tituj janë të rëndësishëm sepse në bazë të të dhënave të regjistruara nën to ju do të keni mundësi të raportoni pranë donatorëve tuaj.

### ***Sistem financiar i kompjuterizuar apo manual?***

Në vitet që jetojmë si dhe me zhvillimet e programeve kompjuterike, mbajtja e llogarive në formë manuale ka dalë pothuajse jashtë përdorimit. Një sistem i kompjuterizuar thjeshtëzon shumë procesin e hyrjeve dhe daljeve dhe tabelat që dalin nga ky lloj sistemi, e bëjnë më të lehtë marrjen e informacioneve të ndryshme. Sistemi kompjuterik kërkon kohë në ndërtimin e tij dhe mirëmbajtjen me informacion të freskët.

Sistemet më të mira të kompjuterizuara janë programet financiare, por në pamundësi për t'i patur ato, një metodë e mirë kompjuterike është ndërtimi i librave të ndryshëm financiarë në programin Excel.

## **2.6 Mbajtja e llogarive**

Çdo sistem llogarimbajtje kërkon një sistem të mirë plotësimi. *Për të kompletuar një libër arke dhe banke, duhen dokumentet e mëposhtëm:*

- Deklaratat e bankës, të skeduar sipas datës;
- Urdhrat e transfertave bankare të skeduar sipas datës;
- Faturat e pagesave, të skeduar sipas datës;
- Mandat pagesat dhe arkëtimet me numër rendor të paravënë, me të paktën dy kopje;





raportimeve apo të tjera kushte që donatori ju ka vendosur si detyrim për shumën e marrë.

**Një regjistër** i rëndësishëm është ai i **marrëdhënieve me shtetin**, i cili duhet të ketë brenda të paktën dy nëndosje, një për tatimet dhe një për zyrën e punës. Dosja e tatimeve duhet të ketë brenda listë-pagesat mujore të punonjësve tuaj dhe çdo transfertë për pagesën e tatimeve mbi të ardhurat për çdo person që bashkëpunon me organizatën tuaj, por që nuk është zotëruar i një licëse biznesi. Duhet të ketë gjithashtu, një kopje të bilancit tuaj vjetor të dorëzuar në zyrën e tatimeve sipas formatit blu, si dhe numrin tuaj të NIPT-it. *Regjistri për zyrën e punës* duhet të ketë kontratat me stafin e organizatës, deklaratat tremujore për ndryshme të mundshme të stafit, certifikatën e deklarimit të veprimtarisë në ISHP, regjistrin e aksidenteve në punë, e të tjera detaje të cilat ju kërkohen nga institucionet përkatëse me shkrim. Mbajtja në mënyrë të rregullt e këtyre regjistrave shmang mundësinë e marrjes së gjobave nga shteti kundrejt organizatës.

## 2.7 Kontrolli i brendshëm

Kontrolli i brendshëm në një organizatë rregullohet përmes politikave financiare të shprehura në një manual politikash e procedurash, që duhet të miratohet nga Bordi Drejtues i organizatës. Një politikë nuk është dokument ligjor, por një marrëveshje mbi një grup parimesh dhe udhëzimesh rreth një fushe kryesore brenda organizatës. Politika tregon se si është ecuria e punëve të organizatës dhe se si organizata e administron veten, ndërsa procedurat janë hapa për ta zbatuar këtë politikë. Politikat e mira shprehin një mënyrë të ndjeshme dhe të favorshme menaxhimi të çështjeve të organizatës. Politikat nuk duhet të ndryshohen shpesh pasi ato kanë për qëllim të drejtojnë punën e organizatës për një kohë të gjatë. Një politikë kthehet në praktikë të një organizate kur, pasi miratohet nga bordi ose strukturat e tjera drejtuese, zbatohet nga çdokush në organizatë.

*Një politikë e mirë financiare duhet të jetë:*

- E favorshme;
- Të përmbushë kërkesat ligjore;
- Gjithëpërfshirëse;

- Realiste (pra që të mund të zbatohet);
- E përshtatshme.

### ***Pse organizata duhet të ketë politika?***

Ideja nuk është të bëhesh burokratik sa më shumë të mundesh, por pasja e politikave, në veçanti atyre financiare, tregon që organizata drejtohet në mënyrë të drejtë dhe të përgjegjshme.

Ekzistojnë disa politika financiare të cilat janë standarde dhe pothuajse të gjitha organizatat i kanë ato. Ndërsa, ka politika të tjera financiare që vijnë si rezultat i ndryshimeve dhe eksperiencave të veçanta që kalon organizata, ose nga ndryshimi i kushteve të mjedisit ku organizata funksionon.

### ***Çfarë është vlera e një politike?***

Politika aftëson një organizatë të decentralizojë vendimmarrjen dhe bën që të merren lehtë vendimet. Ajo i jep dikujt (siç është llogaritari) një udhëzues për ta ndjekur. Politikat ndihmojnë organizatën të jetë e qëndrueshme në mënyrën se si operon dhe e ndihmon atë që të ruajë transparencën dhe besueshmërinë.

### ***Për cilat politika financiare kemi nevojë?***

Një manual politikash dhe procedurash financiare, duhet të përfshijë politika dhe procedura në lidhje me një numër fushash të caktuara, si p.sh:

- Të ardhurat;
- Shpenzimet (p.sh. shumat, pagesat, kërkesat me shkrim, shpenzimet e pabuxhetuara);
- Petty cash;
- Buxhetet;
- Menaxhimi financiar;
- Udhëtimet (makina, klasa e biletave apo hoteleve, dietat);
- Auditimet;
- Asetet (blerja, përdorimi, mirëmbajtja, amortizimi);
- Konvertimi i monedhave të huaja;
- Rrogat, sigurimet shoqërore, taksat;
- Huamarrja;
- Hapja dhe mbyllja e llogarive.

## 2.8 Rolet në kontrollin financiar dhe përgjegjshmërinë

Raporte të rregullta financiare duhen përgatitur për të gjithë ata të cilët kanë të drejtën të dinë se si menaxhohen fondet e organizatës. Organizata duhet të japë llogari në bazë të faturave përkatëse për çdo shpenzim dhe duhet të tregojë që paratë janë shpenzuar sipas qëllimit të dhënë dhe për aktivitetin përkatës për të cilin janë kërkuar. Organizata duhet të marrë të gjitha masat që të mos ketë keqpërdorim të fondeve.

Për sa i përket roleve dhe përgjegjësive në kontrollin financiar dhe përgjegjësinë që duhet mbajtur, janë disa parime bazë të cilat duhen ndjekur:

- Çdo koordinator projekti duhet të njihet me buxhetin përkatës të projektit që do të menaxhojë;
- Në bashkëpunim me drejtorin ekzekutiv dhe oficerin e financës duhet të ndjekë hap pas hapi këtë buxhet, që të mënjanohen gabime të mundshme;
- Duhet të jetë e qartë për të gjithë se kush do të bëjë çfarë. Kjo përcaktohet në planet e punës së organizatës, të cilat rishikohen gjatë mbledhjeve të stafit;
- Stafi i organizatës duhet të kenë aftësitë e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse.

## 2.9 Rolet e strukturave kyçe të organizatës në Menaxhimin Financiar

 *Roli dhe përgjegjësitë e bordit në menaxhimin e një organizate:*

- Të sigurojë që organizata ka burime të mjaftueshme që të kryejë me sukses funksionet e saj;
- Të sigurohet që organizata i përdor paratë dhe kohën me efektivitet;
- Të informohet me shkrim se si janë shpenzuar paratë e organizatës për projekte të ndryshme, cilat objektiva janë arritur, cilat aktivitete janë zbatuar;

☞ *Roli dhe përgjegjësitë e Drejtorit/eshës Ekzekutiv/e.*

Drejtori/esha Ekzekutiv/e është personi që ka përgjegjësinë për:

- Buxhetet;
- Ngritjen e fondeve;
- Shpenzimet;
- Të sigurohet që regjistrimet financiare janë mbajtur në rregull;
- Të sigurohet që librat e financës mbahen në rregull;
- Të sigurohet që raportet financiare prodhohen dhe shpërndahen në kohë të ata që kanë nevojë për to;
- Të monitorojë aktivitetet që të jenë në linjë me buxhetet;
- Të kontrollojë raportet financiare dhe të drejtojë vëmendjen e stafit dhe të bordit drejt një problemi të mundshëm.

☞ *Roli dhe përgjegjësitë e Koordinatorëve të projekteve*

Koordinatorët e projekteve formojnë atë që quhet skuadra e menaxhimit të projektit në një organizatë. Çdo koordinator/e projekti duhet:

- Të njohë buxhetet e projekteve që menaxhon;
- Të kërkojë bërjen e pagesave të personave të tretë që kontribuojnë, me një letër të shkruar apo me e-mail drejtuar oficerit/es të/së financës, për dijeni (cc) drejtorit/eshës ekzekutiv/e;
- Të lajmërojë me shkrim disa ditë përpara, vendin dhe sasinë e pjesëmarrësve në një ngjarje të caktuar si trajnim, konferencë, etj;
- Në bashkëpunim me oficerin/en e financës të përgatisë buxhetet për projektet e reja;
- Në bashkëpunim me oficerin/en e financës të kontrollojë buxhetin e projektit, në mënyrë që shpenzimi i zërit të caktuar të mos kalojë shumë në dispozicion;
- Të asistojë drejtorin/eshën ekzekutiv/e dhe oficerin/en e financës për burime të mundshme ngritje fondesh brenda projekteve përkatës.

### *Roli dhe përgjegjësitë e oficerit/es të/së financës*

Shumica e punëve në lidhje me financën bëhen nga oficeri/ja i/e financës dhe nga llogaritari/ja.

*Detyrat e oficerit/es të/së financës janë:*

- Të lëshojë fatura për pagesat e bëra;
- Të lëshojë fatura për paratë e arkëtuara;
- Të depozitojë paratë në llogaritë përkatëse;
- Të përgatisë kërkesat për çeqe, për pagesa të ndryshme;
- Të sigurohet që faturat të paguhen në kohë;
- Të përgatisë raporte financiare sipas kërkesave duke ndjekur me rigozitet kontratat me donatorët;
- Të kontrollojë asetet dhe blerjen e kancelarive.

### *Roli dhe përgjegjësitë e auditimit të jashtëm*

Një auditim i jashtëm është një raport i pavaruar që mbulon:

- Sa para ka marrë organizata dhe sa ka shpenzuar në vitin financiar si dhe për çfarë janë përdorur këto para;
- A janë shpenzuar këto para në përputhje me statutin e organizatës, vendimet e bordit dhe kërkesat e donatorëve;
- A është mbajtur në rregull sistemi financiar i organizatës;
- Vlerën e asetëve të organizatës;
- Si mund të përmirësohet sistemi financiar.

Personi që bën auditimin e jashtëm nuk duhet të jetë i përfshirë në aktivitetet e organizatës ose të jetë i afërm ose i njohur i një personi që punon në organizatë.

## **2.10 Si t'i përdorim librat që prodhohen nga sistemi financiar që ndërton një organizatë?**

Organizatrat duhet të mbajnë një sistem financiar llogarie, për arsytet e mëposhtme:

- Për të qenë të pajisur me praktika financiare menaxhimi për

personat kyç;

- Për të parandaluar keqpërdorimin e parave;
- Për të patur një mjet menaxhimi praktik për leadershipin e organizatës dhe për koordinatorët e projekteve;
- Për të hartuar raporte financiare mujore, gjashtëmujore, vjetore apo periodike, kurdoherë që kërkohen për strukturat menaxhuese të organizatës dhe për donatorët. Këto raporte duhet të jenë lehtësisht të lexueshme për jofinanciarët dhe për drejtuesit/et. Informacioni i dhënë duhet të ndihmojë drejtuesit/et e organizatës për të marrë vendime rreth drejtimit të organizatës.

### 3. Raportet Financiare

Raportet financiare të prodhuara nga sistemi juaj i llogarimbajtjes duhet t'ju bëjnë të aftë t'i përgjigjeni pyetjeve, si:

- A ka diferenca midis buxheteve dhe të ardhurave e shpenzimeve? Nëse po, pse? A na duhet të ndërmarrim ndonjë veprim të mundshëm?
- A janë shpenzuar grantet e donatorëve sipas qëllimit? Nëse jo, pse?
- A janë përdorur shumica e parave në realizimin e projekteve/ programeve në krahasim me shpenzimet administrative?
- A ka ndonjë zë për të cilin ne nuk kemi kërkuar aq para sa duhet?
- Çfarë zotërojmë dhe çfarë kemi borxh në një moment të caktuar (Bilanci është një mjet për ta thënë këtë);
- Sa është vlera e aseteve tona?
- A është pozicioni ynë financiar i shëndetshëm? A mund të vazhdojmë të bëjmë punën që i shërben misionit dhe objektivave tona?
- A kemi një shpërndarje të mirë të të ardhurave tona apo jemi të varur nga një burim i vetëm?

### 3.1 Deklaratat financiare

**Bilanci** – është deklarata që tregon pozitën financiare të organizatës në një moment të dhënë. Tregon aktivin, pasivin, balancimin e fondeve në një datë të caktuar.

**Tabela e të ardhurave e shpenzimeve** - Është deklarata që tregon përmbledhjen e transfertave financiare për një periudhë të caktuar. Tregon historikun financiar të organizatës në këtë periudhë.

**Tabela e rrjedhjes së parave (Cash flow)** - Kjo tabelë tregon burimet e të gjitha të ardhurave dhe aplikimin e disbursimeve për një periudhë të caktuar. Gjithashtu tregon përbërësit e gjendjes së parave, duke u ndarë në: *para në bankë* dhe *para në arkë*.


### 3.2 Analizat financiare

Në mënyrë që vendimet të jenë sa më racionale për organizatën duhen përdorur disa mjete analitike të cilat japin të dhëna të përgjithshme. Organizata vetë, si dhe palët e treta si, donatorët, auditorët, vlerësuesit – të gjithë ndërmarrin analiza financiare. Më poshtë janë dhënë dy nga metodat bazë të analizave.

**Analiza vertikale.** Analiza vertikale përdoret për të vlerësuar performancën e organizatës. Çdo zëri në një deklarata financiare, i bëhet raporti në lidhje me bazën. Në një OJF, një bazë mund të jetë: shuma totale e të ardhurave, granti total, apo shpenzimet totale.

**Analiza Horizontale.** Ka disa lloje analizash horizontale dhe njëra prej tyre është: *analiza e mospërputhjeve*. Ky raport tregon diferencën midis shpenzimeve aktuale dhe buxhetit, si dhe arsyet për këto diferenca.

Analizat financiare bëhen përmes proporcioneve financiare.

 **Proporcionet financiare** - Shërbejnë për të na ndihmuar për të zgjidhur disa nga pyetjet që dalin për mirëmenaxhimin apo qëndrueshmërinë e organizatës. Proporcionet financiare janë një mjet i cili u jep përgjigje një sërë pyetjesh. Një proporcion financiar na tregon çfarë përqindje është një zë

i caktuar i raporteve financiare që ne duam ta masim, në lidhje me totalin. Proporcionet financiare llogariten mbi bazën e shifrave të raporteve financiare. Nëse një proporcion nuk del mirë, ne duhet ta shohim me kujdes situatën.

Proporcioni na bën një paralajmërim “të ndalojmë dhe të kontrollojmë”. Disa nga proporcionet më të përdorura në një organizatë jofitimprurëse janë:

• ***Proporcioni i likuiditetit***

Është marrëdhënia midis parave në dispozicion për aktivitetet për një periudhë të caktuar dhe shpenzimeve që duhen bërë për të njëjtën periudhë.

• ***Proporcioni i pagave***

Është raporti midis shumës në dispozicion për pagat në organizatë dhe buxhetit total të organizatës.

• ***Proporcioni i shpenzimeve administrative***

Është raporti midis parave për shpenzime administrative dhe buxhetit total.

• ***Proporcioni i kostove fiks***

Është raporti i kostove fikse në lidhje me buxhetin total. Kostot fikse janë ato për të cilat ju duhet të paguani edhe sikur të mos kishit asnjë projekt.

**Pyetje të mundshme që mund të bëhen kur rishikohet menaxhimi financiar:**

- Kur ka qenë auditimi i fundit që keni bërë?
- Çfarë konkluzioni ka nxjerrë auditimi që keni bërë?
- A ka organizata para të mjaftueshme në bankë për të paguar detyrimet që ka?
- Sa gjatë mund të jetojë organizata pasi të gjitha fondet e saj të jenë shteruar?
- A janë të ardhurat dhe shpenzimet në balancë?
- A ka rritje apo zbritje në nivelin e aktiviteteve të organizatës nga viti i kaluar?
- Sa është balanca e kostove direkte të projektit kundrejt kostove administrative?



- Sa “e varur nga donatorët” është organizata?
- A janë shpenzimet në linjë me buxhetet?
- A janë të ardhurat në një linjë me buxhetet?
- A ka ndryshime të dukshme?

Këto dhe një sërë pyetjesh të tjera, ndihmojnë në parandalimin e problemeve të mundshme gjatë menaxhimit të organizatës.

Së fundi, më poshtë gjeni një tabelë e cila ju ndihmon të kontrolloni sistemin e mbajtjes së llogarive kundrejt sistemit të menaxhimit të tyre.

<b>Mbajtja e llogarive</b>	<b>Menaxhimi i llogarive</b>
Regjistrimi i transfertave	Bën të mundur krahasimin e rezultateve me objektivat
Klasifikimi i transfertave	Bën të mundur përcaktimin e arsyeve për mospërputhje
Bashkërendimi i të dhënave të bankës e arkës	Ndihmon në korrigjimin e veprimeve të gabuara të bankës e arkës
Përmbledhja e transfertave në raportet financiare, bazuar në buxhetet përkatës	Ndihmon në parashikim & planifikim
Prezantimi i të dhënave financiare në deklaratat financiare	Bën të mundur analizimin e informacionit

## BIBLIOGRAFIA

Aleanca Gjinore për Zhvillim, (Mars 2005) 'Manuali i politikave dhe procedurave financiare', i rinovuar dhe i aprovuar me vendim të bordit të drejtorëve.

Marshal, M., (2001) 'Legitimacy and Effectiveness: NGOs in Comparative Perspective'

Shea, C. (2000) 'Good Laws Can Mean a Better Image'

Shutker, A., Walkenhorst, P., Then, V., (2001) 'Transparency and accountability of organizations' – from the book 'Foundation's in Europe – International Reference book on Society, Management, and Law', Editors of Seal;

### Rreth autores...

**Mirela Arqimandriti** ka kryer studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Departamenti i Fizikës, në Universitetin e Tiranës. Kualifikimi i saj përfshin trajnime të ndryshme jashtë Shqipërisë dhe brenda vendit, mbi menaxhim financiar, ndërtim kapacitetesh për OJF-të, promovimin e sipërmarrjes së vogël e të mesme të grave në Shqipëri. Në vitin 2005 ajo është diplomuar në MBA, nga Universiteti i Shefildit, Angli.

Prej nëntë vitesh ajo merret me menaxhimin financiar të projekteve/ programeve pranë Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim. Gjatë punës në sektorin e shoqërisë civile, angazhimi i saj nuk është kufizuar vetëm në administrim dhe financë, por edhe në koordinim projektesh, planifikim veprimtarish dhe trajnime.

## ■ PJESA E TRETË – ANEKS

### PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E NIVELIT TË TRANSPARENCËS SË SHOQËRISË CIVILE

#### A. Të dhëna të përgjithshme për organizatën

1. Emri i organizatës:
2. Adresa e plotë:
3. Tel:
4. Faks:
5. E-mail:
6. Adresa e internetit:
7. Drejtuesi i organizatës:
8. Personi i kontaktit (nëse është i ndryshëm nga më sipër):
9. Viti i krijimit të organizatës:
10. Viti i regjistrimit të plotë ligjor:
11. Lloji i regjistrimit:

Shoqatë

Fondacion

Qendër

Nuk e di

Tjetër, ju lutem

specifikojeni: \_\_\_\_\_



**14. Çështjet kryesore ku organizata juaj është aktive:** (përshkruani fushën e veprimtarisë së organizatës tuaj)

---

---

---

---

**15. Aktivitetet** (klikoni gjithçka që ju bëni):

- |  |   |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> shërbime këshillimi                         | <input type="checkbox"/> monitorim/matje (teknike)              |
| <input type="checkbox"/> fushata ndërgjegjësimi                      | <input type="checkbox"/> negociime dhe bisedime                 |
| <input type="checkbox"/> fushata/protesta                            | <input type="checkbox"/> rrjetëzim                              |
| <input type="checkbox"/> organizim komuniteti dhe hartim strategjish | <input type="checkbox"/> zbatim politikash                      |
| <input type="checkbox"/> konferenca, takime                          | <input type="checkbox"/> takime publike                         |
| <input type="checkbox"/> edukim                                      | <input type="checkbox"/> pjesëmarrje publike                    |
| <input type="checkbox"/> punë në terren                              | <input type="checkbox"/> botime                                 |
| <input type="checkbox"/> përhapje informacioni                       | <input type="checkbox"/> kërkime                                |
| <input type="checkbox"/> advokaci ligjore                            | <input type="checkbox"/> marketing social                       |
| <input type="checkbox"/> lobim                                       | <input type="checkbox"/> trajnime/rritje kapacitetesh           |
| <input type="checkbox"/> shtypi/media                                | <input type="checkbox"/> vëzhgime (aktivitetet publike/private) |

**16. Niveli i aktivitetit** (klikoni të gjitha ato që përdorni):

- |  |                                       |
|--|---------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> lokal                   | <input type="checkbox"/> kombëtar     |
| <input type="checkbox"/> rajonal (brenda vendit) | <input type="checkbox"/> ndërkombëtar |

**17. Komente/përmbledhje e shkurtër** (veprime të suksesshme, projekte të përfunduara etj):

<maksimumi 50 fjalë>

A large empty rectangular box with a thin black border, intended for writing comments or a summary. A small grey square icon is located at the top left corner of the box.

**18. Botimet tuaja kryesore** (titulli, viti, shpeshtësia):

<maksimumi 50 fjalë>

A large empty rectangular box with a thin black border, intended for listing key publications. A small grey square icon is located at the top left corner of the box.

B: Procedurat e brendshme të organizatës tuaj

**19. A ekzistojnë politika të brendshme për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe sigurimin e transparencës së organizatës tuaj:**

- Po
- Jo
- Nuk e di

Nëse po, cilat janë ato:

- rregullore, udhëzues, manual procedurash, etj.

Jep shembuj:

---

- programe kualifikimi për drejtuesit dhe/ose anëtarët e organizatës

Jep shembuj:

---

- tjetër (specifikoni)
- 

**20. Si e vlerësoni komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit në organizatën tuaj:**

- Shumë të mirë  
 Të mirë  
 Mesatar  
 Të pamjaftueshëm  
 Shumë të dobët

**21. Çfarë mjeteesh përdoren për mundësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit në organizatën tuaj (Brenda dhe jashtë organizatës)**

- takime periodike  
 botime periodike  
 botime të veçanta  
 faqe interneti  
 mjete të komunikimit elektronik  
 të tjera (Specifikoni)
-

Transparenca e organizatave kushtëzohet në një nivel të lartë dhe nga kuadri ligjor në të cilin ato punojnë. Njohuritë për këtë kuadër ligjor janë një detyrim dhe kusht për mirëfunksionimin e organizatës, sidomos kundrejt përfituesve dhe publikut në përgjithësi.

**22. A i ndjek organizata juaj rregullisht ndryshimet në kuadrin ligjor?**

- |                             |  |
|-----------------------------|--|
| <input type="checkbox"/> Po | <input type="checkbox"/> Nuk ka rëndësi për ne |
| <input type="checkbox"/> Jo | <input type="checkbox"/> Nuk e di              |

**23. Cilat prej dokumenteve të mëposhtme përgatit organizata juaj? Ju lutem, përzgjidhni raportet që ju përgatisni dhe tregoni arsyet pse i përgatisni ato. (klikoni të gjitha ato që përdorni)**

<p><i>Lloji i raportit</i></p> <p><input type="checkbox"/> Raport aktiviteti (raport vjetor)</p>	<p><input type="checkbox"/> Përse e përgatisni?</p> <p><input type="checkbox"/> i kërkuar nga ligji</p> <p><input type="checkbox"/> i kërkuar nga rregullat e organizatës</p> <p><input type="checkbox"/> i kërkuar në bazë të kontratës (donatorët etj)</p> <p><input type="checkbox"/> lehtëson sigurimin e fondeve</p> <p><input type="checkbox"/> informacion për anëtarët</p> <p><input type="checkbox"/> informim publik dhe për shpërndarje</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk e di</p>
<p><input type="checkbox"/> Raport financiar (bilanci mbi llogaritë)</p>	<p><input type="checkbox"/> i kërkuar nga ligji i kërkuar nga rregullat e organizatës</p> <p><input type="checkbox"/> i kërkuar në bazë të kontratës (donatorët etj)</p> <p><input type="checkbox"/> lehtëson sigurimin e fondeve</p>



- informacion për anëtarët
- informim publik dhe për shpërndarje
- nuk e di

**24. A kryen organizata kontroll financiar të pavarur të veprimtarisë së saj?**

- Po                       Jo                       Nuk e di

Nëse po, për ç'arsye?

- i kërkuar nga ligji i kërkuar nga rregullat e organizatës
- i kërkuar në bazë të kontratës (donatorët etj)
- lehtëson sigurimin e fondeve
- informacion për anëtarët
- informim publik dhe për shpërndarje
- nuk e di

Nëse jo, për ç'arsye?

- ka kosto financiare që nuk justifikohen
- mjaftojnë raportet financiare të brendshme
- nuk na duhet
- Tjetër \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- nuk e di

**25. Efienca organizative: Brenda organizatës suaj, ju lutem vlerësoni rëndësinë e procedurave të mëposhtme administrative. (ju lutem, klikoni kutinë e duhur në çdo rresht)**

	Shumë e rëndësishme, ky mjet është kyç për planifikimin tonë organizativ dhe është shumë i përshtatshëm për sigurimin e informacionit	E rëndësishme, ky mjet përdoret rregullisht si një mekanizëm planifikues dhe ndiqet rregullisht për të sigurua informacionin bazë për transparencën	Disi e rëndësishme, ne e përdorim këtë mjet, por ai është pjesërisht përdorshëm për transparencën	Më pak i rëndësishëm, ne e përdorim me raste apo jo zyrtarisht i këtë mjet për planifikimet tona, por ai rrallë ndiqet për të mbështetur transparencën e organizatës	Jo i rëndësishëm, nuk përdorim një mjet të tillë planifikimi dhe sigurimi informacioni
Strategji komunikimi ose marrëdhënieve publike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Menaxhimi financiar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Menaxhimi i burimeve njerëzore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Manuali procedurave administrative	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sistemi i menaxhimit të projekteve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sistemi i raportimit të aktiviteteve dhe financave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**26. Si e vlerësoni shkallën e përdorimit të këtyre burimeve të informacionit për transparencën e organizatës tuaj?**

- |  |   |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> Të shkëlqyeshme | <input type="checkbox"/> Të pamjaftueshme |
| <input type="checkbox"/> Të kënaqshme    | <input type="checkbox"/> Shumë të dobët   |
| <input type="checkbox"/> Mesatare        |   |

**27. Ç'loj informacioni i organizatës tuaj është i hapur për të gjithë anëtarët e saj?**

- dokumentet themelore të OJF-së (statuti, rregullore , etj.)
- dokumentacioni i projekteve (projekti, raportime, fatura financiare, etj.)
- dokumente të mbledhjeve të organeve drejtuese
- Korrespondenca e organizatës
- Tjetër (specifikoni) \_\_\_\_\_

**28. Ç'loj informacioni i organizatës tuaj është i hapur për publikun?**

- dokumentet themelore të OJF-së (statuti, rregullore , etj.)
- dokumentacioni i projekteve (projekti, raportime, fatura financiare, etj.)
- dokumente të mbledhjeve të organeve drejtuese
- Korrespondenca e organizatës
- Tjetër (specifikoni) \_\_\_\_\_

**29. si mundësohet përdorimi i këtij informacioni nga anëtarët e organizatës dhe publiku:**

- nëpërmjet botimeve (periodike dhe specifike) të organizatës

- nëpërmjet medias elektronike (faqe interneti, postë elektronike, etj.)
- nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta
- nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme
- Tjetër (specifikoni) \_\_\_\_\_

**30. Jepni mendimin tuaj:**

A mendoni se organizata juaj është transparente?

- Po                       Jo                       Nuk e di

A mendoni se organizata juaj gëzon besimin e publikut?

- Po                       Jo                       Nuk e di

Cilat janë disa mënyra që rrisin transparencën e organizatave jofitimprurëse?

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

*Ju falënderojmë për bashkëpunimin!*